



GLOBAL ORGANIZATION OF PARLIAMENTARIANS AGAINST CORRUPTION
ORGANISATION MONDIALE DES PARLEMENTAIRES CONTRE LA CORRUPTION
ORGANIZACION MUNDIAL DE PARLAMENTARIOS CONTRA LA CORRUPCIÓN
المنظمة العالمية للبرلمانيين ضد الفساد



Empowered lives.
Resilient nations.

ROLI I PARLAMENTIT NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NJË DORACAK PARLAMENTAR



PARLIAMENTARY HANDBOOK





Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



*Empowered lives.
Resilient nations.*

ROLI I PARLAMENTIT NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

NJË DORACAK PARLAMENTAR

Përkthimi dhe printimi i këtij Doracaku është mundësuar nga Projekti i UNDP-së, në Mbështetje të Përpjekjeve Anti-Korruption (SAEK II), me mbështetjen e Qeverisë Zvicerane (SDC-Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Kosovë), dhe Qeverisë Daneze (DANIDA- Agjencia Daneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar).

Përmbytja e këtij Doracaku nuk paraqet medoemos qëndrimin e UNDP-së ose të donatorëve tanë SDC dhe DANIDA.







SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS

1 NO POVERTY



2 ZERO HUNGER



3 GOOD HEALTH AND WELL-BEING



4 QUALITY EDUCATION



5 GENDER EQUALITY



6 CLEAN WATER AND SANITATION



7 AFFORDABLE AND CLEAN ENERGY



8 DECENT WORK AND ECONOMIC GROWTH



9 INDUSTRY, INNOVATION AND INFRASTRUCTURE



10 REDUCED INEQUALITIES



11 SUSTAINABLE CITIES AND COMMUNITIES



12 RESPONSIBLE CONSUMPTION AND PRODUCTION



13 CLIMATE ACTION



14 LIFE BELOW WATER



15 LIFE ON LAND



16 PEACE, JUSTICE AND STRONG INSTITUTIONS



17 PARTNERSHIPS FOR THE GOALS



1. PA VARFËRI; 2. ZERO URI; 3. SHËNDET DHE JETË E MIRË; 4. ARSIM CILËSOR; 5. BARAZI GJINORE; 6. UJË DHE KANALIZIME TË PASTRA; 7. ENERGJI E PASTËR DHE E PËRBALLUESHME; 8. PUNË DHE RRITJE TË MIRË EKONOMIKE; 9. INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË; 10. PABARAZI TË ULURA; 11. QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME; 12 KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM; 13. VEPRIM PËR KLIMËN; 14. JETA NËNUJORE; 15. JETA NË TOKË; 16. PAQJA, DREJTËSIA DHE INSTITUCIONET E FORTA; 17. PARTNERITETE PËR OBJEKTIVAT

Organizata Globale e Parlamentarëve Kundër Korruptionit (GOPAC)

Që nga viti 2002 Organizata Globale e Parlamentarëve Kundër Korruptionit (GOPAC) ka krijuar një rrjet të parlamentarëve që janë në një mendje dhe duan të luftojnë korruptionin në vendet e tyre dhe në nivel global. Me degë në 57 parlamente në mbarë botën, GOPAC ofron mbështetje, njojuri dhe shkëmbim të ideve ndërmjet parlamentarëve në nivel rajonal dhe global. Përveç kësaj, në shumicën e vendeve, degët u ofrojnë mundësi parlamentarëve nga të gjitha partitë politike që të bashkëpunojnë dhe të rrëzojnë barrierat politike ndaj një çështjeje kyçe - korruptionit; një çështje me ndikim të madh në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

www.gopacnetwork.org

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) është agjencia primare zhvillimore e Kombeve të Bashkuara që nga viti 1965. UNDP-ja është gjithashtu zbatuesi më i madh i projekteve mbështetëse parlamentare në botë, duke punuar me më shumë se 60 parlamente kombëtarë. UNDP-ja është e përkushtuar për të ndihmuar parlamentet në nivel kombëtar dhe nën-kombëtar për të përmbushur mandatin e tyre për të zbatuar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm përmes ofrimit të ekspertizës teknike, shkëmbimit të njojurive nga kolegët, dhe botimeve dhe produkteve të dijes me cilësi të lartë.

www.undp.org

Banka Islamike për Zhvillim (IDB)

E themeluar në vitin 1973, Banka Islamike për Zhvillim (IDB) është një institucion financiar ndërkombëtar i krijuar për të mbështetur zhvillimin në vendet që kanë një popullsi të konsiderueshme islame. Ndryshe nga bankat e tjera të ngjashme, IDB-ja nuk është rajonale dhe anëtarësia e saj mbulon vendet në Evropë, Afrikë, Lindjen e Mesme dhe Azi. Qëllimi i IDB-së është të "nxisë zhvillimin ekonomik dhe progresin shoqëror të vendeve anëtare dhe të komuniteteve myslimane".

www.isdb.org

Mirënjohje

Organizata Globale e Parlamentarëve kundër Korrupsionit (GOPAC), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Banka Islamike për Zhvillim (IDB) shprehin vlerësimin e tyre për autorët kryesorë të këtij doracaku parlamentar, Kevin Deveaux dhe Charmaine Rodrigues.

Ky doracak u redaktua dhe prodhua nga Emilie Lemieux, Menaxher i Projektit, GOPAC, Olivier Pierre-Louveaux, Specialist i Programeve për Proceset Politike me Përfshirje, UNDP, dhe Abdihamid Mao, Specialist i Lartë i Integrititetit, Banka Islamike për Zhvillim. Redaktimi përfundimtar u ndërmor në emër të UNDP-së nga Julia Stewart dhe Charles Chauvel.

Qendra e UNDP-së për shtetet arabe luajti një rol udhëheqës në mbështetjen e prodhimit të doracakut. Qendra Rajonale e UNDP-së në Bangkok për Azinë dhe Paqësorin, përmes punës së Doina Ghimici, Specialiste Programi për Funksionet Themelore të Qeverisë, ndau përvoja relevante nga rajoni i saj.

Doracaku nuk do të ishte i plotë pa kontributin e paçmuar të marrë nga Dr. Gavin Woods, Kryesues i Task Forcës Globale të GOPAC për Mbikëqyrjen Parlamentare, Akaash Maharaj, Kryeshef Ekzekutiv i GOPAC-ut dhe anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të GOPAC-ut: Dr. Naser Al Sane, Paula Bertol, John Hyde, Romi Gauchan Thakali, Mary King dhe Inderuari Osei Kyei-Mensah-Bonsu; dhe Patrick Keuleers, Jos De La Haye, Arkan el-Seblani, Claire Cabrol, Jason Gluck, Julia Keutgen, Biljana Ledenican, Melissa Salyk-Virk, Natalia Shafi, Nancy Fashho, Nika Saeedi, Mads Hove, Sandra Lopez, Sébastien Vauzelle dhe Kawtar Zerouali (UNDP) dhe Jean-Noé Landry (Open North).

Së fundmi, kontribute të vlefshme dhanë edhe Dhoma e Përfaqësuesve të Asamblesë Konsultative Populllore të Republikës së Indonezisë, përmes Dr. Fadli Zon, Zëvendëskryetar dhe Kryesues i GOPAC-ut, si dhe anëtarët e personelit parlamentar Herinoyo Adi Aanggoro dhe Endah Retnoastuti, si dhe Fondacioni Westminster për Demokraci dhe parlamentarët dhe ekspertët që përfaqësojnë 12 vende që morën pjesë në një punëtori pilot nga 30 deri më 31 gusht 2016 në Xhakarta, Indonezi, dhe kontribuan me pikëpamjet dhe përvojat e tyre.

Parathenie

Paqja dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë thelbësore për të ardhmen e planetit dhe njerëzimit. Ky vizion është paraqitur në Agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm (Agjenda 2030), e cila ka për qëllim t'i japë fund varfërisë, të ndërtojë shoqëri paqësore dhe të promovojë prosperitetin dhe mirëqenien e qytetarëve, duke mbrojtur mjedisin për brezat e tashëm dhe të ardhshëm. Miratimi i saj me unanime nga Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork në vitin 2015 kërkon që këto shtete tash t'i përkthejnë Objektivat ambicioze dhe transformuese të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) në prioritete kombëtare dhe të sigurojnë burimet e duhura dhe të krijojnë partneritetet e nevojshme me shoqërinë civile dhe sektorin privat për zbatimin e suksesshëm.

Parlamentarët kanë një mundësi, si dhe një përgjegjësi kushtetuese, për të luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe monitorimin e zbatimit të OZHQ-ve. Deklarata e Agjendës pranon "rolin thelbësor të parlamenteve kombëtare përmes miratimit të legjislacionit dhe miratimit të buxheteve, dhe rolin e tyre në sigurimin e llogaridhënieve për zbatimin efektiv të angazhimeve tona." Deputetët janë të pozicionuar në mënyrë unlike për të vepruar si ndërsa që mes qytetarëve dhe institucioneve shtetërore dhe për të promovuar dhe adoptuar politikat dhe legjislacionin e përqendruar tek qytetarët për të siguruar që askush nuk mbetet prapa.

Zbatimi i suksesshëm i Agjendës 2030 kërkon një qasje të integruar, partneritet dhe pjesëmarrje përmes proceseve gjithëpërfshirëse politike, si dhe institucionale përgjegjëse, efektive dhe llogaridhënëse. Kjo do të kërkojë shkëmbime eksperiencash globale dhe rajonale mes vendave për të identifikuar zgjidhjet për planifikimin, buxhetimin, zbatimin dhe monitorimin e progresit drejt arritjes së OZHQ-ve, si dhe gjurmimin se ku dhe si shpenzohen fondet për të frenuar korruptionin dhe për të vlerësuar ndikimin e këtyre nismave në jetën e qytetarëve - sidomos grave dhe pjesëtarëve të grupeve të marginalizuara dhe të pafavorizuara.

Ky doracak, i prodhuar nga Organizata Globale e Parlamentarëve kundër Korruptionit, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara dhe Banka Islamike për Zhvillim, është hartuar të jetë një burim i lehtë për t'u përdorur që mund t'u ndihmojë parlamentarëve dhe anëtarëve të personelit të parlamentit të luajnë një rol efektiv në zbatimin e OZHQ-ve. Ai paraqet Agjendën 2030 dhe liston praktikat dhe mjetet e mira nga e gjithë bota, të cilat mund të përshtaten, sipas nevojës, varësisht nga konteksti kombëtar.

OZHQ-të ofrojnë një mundësi për shoqëritë që të angazhohen në dialog gjithëpërfshirës për të ardhmen tonë së bashku në këtë planet. Parlamentarët mund të luajnë një rol udhëheqës në lehtësimin e këtij debati. Andaj, ftojmë parlamentarët në mbarë globin që ta përdorin këtë doracak si një mjet praktik për të nxitur angazhimin për Agjendën 2030.

Sinqerisht

,

Dr. Fadli Zon
Kryesues, Organizata
Globale e Parlamentarëve
kundër Korruptionit
Nënkyetar, Dhoma e
Përfaqësuesve, Indonezi

Magdy Martínez-Solimán
Ndihmës Sekretar i
Përgjithshëm i Kombeve
të Bashkuara
Asistent Administrator dhe
Drejtor i Byrosë për
Mbështetje të Politikave dhe
Programeve, UNDP

Dr. Abdul Razzak
Khalil Lababidi
Drejtor,
Zyra e Integritetit të Grupit,
Banka Islamike për
Zhvillim

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	10
I. Puqja e parlamenteve dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm	12
A. Parlamentet dhe zhvillimi i qëndrueshëm.....	12
B. Përfshirja e parlamentarëve në agjendën 2030.....	14
C. Objktivi i parlamentarit: Objktivi 16 i Zhvillimit të Qëndrueshëm.....	16
Pjetje për reflektim	16
II. Roli i Parlamentit në efektivitetin e zhvillimit dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm	17
Pjetje për reflektim	20
III. Bashkërendimi i përpjekjeve për zbatim më të mirë.....	21
A. Kthimi në prioritet i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe koordinimi i zbatimit të tyre në të gjitha degët e qeverisjes	21
Pjetje për reflektim	22
B. Puna me institucionet e tjera të mbikëqyrjes	23
Pjetje për reflektim	24
C. Puna me organet kombëtare të statistikave	25
Pjetje për reflektim.....	25
D. Puna me organet ndërkombëtare dhe rajonale.....	26
Pjetje për reflektim	27
IV. Ligjvënia: Forcimi i mjedisit mundësues për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.28	28
A. Identifikimi i prioriteteve të reformës ligjore.....	28
B. Hartimi i legjislacionit të lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm	29
Pjetje për reflektim	31
V. Buxhetimi për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.....	32
A. Buxheti vjetor i shtetit	33
Pjetje për reflektim	35
B. Mbikëqyrja e buxheteve dhe shpenzimeve për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.....	36
Pjetje për reflektim	38

VI.	Monitorimi i zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.....	39
A.	Mbikëqyrja nga Komisionet e zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm..	39
	Pyetje për reflektim.....	42
B.	Hetimet parlamentare.....	42
	Pyetje për reflektim.....	44
C.	Pyetjet dhe interpelancat me shkrim dhe me gojë	44
	Pyetje për reflektim.....	45
<hr/>		
VII.	Përfaqësimi: Angazhimi i qytetarëve dhe lehtësimi i pjesëmarrjes së publikut.....	46
A.	Promovimi i ligjvënies pjesëmarrëse	48
	Pyetje për reflektim.....	49
B.	Lehtësimi i buxhetimit pjesëmarrës	50
	Pyetje për reflektim.....	50
C.	Kontributet e publikut në monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe politikave	51
	Pyetje për reflektim.....	52
D.	Lehtësimi i zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në nivel lokal	52
	Pyetje për reflektim.....	53
<hr/>		
VIII.	Roli i Parlamentit në lokalizimin e OZHQ-ve	54
	Pyetje për reflektim.....	55
<hr/>		
IX.	Roli i anëtarëve të personelit parlamentar	56
	Pyetje për reflektim	57
<hr/>		
X.	Roli i grupeve parlamentare të partive politike	58
A.	Grupet partiake.....	58
B.	Grupet ndërpartiake	59
	Pyetje për reflektim.....	59
<hr/>		
XI.	Ndërtimi i kapaciteteve të parlamentarëve dhe anëtarëve të personelit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.....	60
	Pyetje për reflektim.....	62

Përbledhje ekzekutive

Ky doracak është zhvilluar për parlamentarët si një mjet për të nxitur angazhimin parlamentar për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).

OZHQ-të u miratuan, si pjesë integrale e "Transformimi i botës sonë: Agjenda e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm", nga të 193 Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara më 25 shtator 2015. Duke u mbështetur në mësimet e nxerra nga Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (zbatuar nga viti 2000 deri në 2015), OZHQ-të përcaktojnë objektivat e zhvillimit global dhe afatgjatë për të krijuar mjete më të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik, mjedisor dhe social në të gjitha vendet. Këto objektiva të reja globale, të referuara kolektivisht si Agjenda 2030, hynë në fuqi më 1 janar 2016 dhe afati i synuar për arritjen e tyre është viti 2030.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Objktivi 1: Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj dhe kudo

Objktivi 2: Eliminimi i urisë, arrija e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi të ushqyerjes, si dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme

Objktivi 3: Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë, në të gjitha moshat

Objktivi 4: Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënët gjatë gjithë jetës për të gjithë

Objktivi 5: Arrija e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave

Objktivi 6: Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujësjellës-kanalizimeve

Objktivi 7: Sigurimi i qasjes në energji të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë

Objktivi 8: Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse e të qëndrueshme, e punësimit të plotë e produktiv dhe e punës së denjë për të gjithë

Objktivi 9: Ndërtimi i infrastrukturave të rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit

Objktivi 10: Ulja e pabarazisë së brendshme dhe mes vendeve

Objktivi 11: Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve gjithëpërfshirëse, të sigurta, të forta dhe të qëndrueshme

Objktivi 12: Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit

Objktivi 13: Marrja e masave urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe efektet e tyre¹

Objktivi 14: Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeaneve, deteve dhe burimeve detare për zhvillim të qëndrueshëm

Objktivi 15: Mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemave tokësore, administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër shkretimit, si dhe ndalimi dhe prapakthimi i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit

Objktivi 16: Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet

Objktivi 17: Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi i Partneritetit Global për Zhvillim të Qëndrueshëm

¹ Duke pranuar se Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike është forumi parësor ndërkombëtar ndërqeveritar forume për të negociuar përgjigjen globale ndaj ndryshimeve klimatike.

OZHQ-të u miratuan unanimisht nga Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe u mbështetën nga degët ekzekutive të qeverive të çdo vendi. Nëse kërkohet që objektivat të arrihen në çdo vend, parlamenti i vendit duhet të luajë një rol të rëndësishëm dhe të informuar. Ligjet e nevojshme për të krijuar kornizën ligjore për OZHQ-të do të duhet të shqyrtohen dhe të miratohen nga parlamenti. Buxheti vjetor i shtetit që ndan fondet për zbatimin e OZHQ-ve duhet të miratohet nga parlamenti. Parlamenti duhet gjithashtu të monitorojë zbatimin e OZHQ-ve nga qeveria, për të verifikuar nëse është i përshtatshëm në kontekstet kombëtare dhe lokale, si dhe parlamentarët duhet të përfaqësojnë zgjedhësit e tyre për të promovuar pjesëmarrjen e qytetarëve në zbatimin e OZHQ-ve.

Qëllimi i këtij doracaku është i trefishtë:

- të informohen më tej parlamentarët për-OZHQ të;
- të ndahen shembuj si parlamentet dhe parlamentarët mund t'i përbushin rolet e tyre në zbatimin e OZHQ-ve; dhe
- t'u ofrohet parlamenteve dhe parlamentarëve një mjet që mund të përdorin për të vlerësuar dhe përmirësuar kapacitetin e tyre aktual për angazhim në arritjen e-OZHQve.

Doracaku fillon me një pasqyrë të OZHQ-ve dhe pse ato janë relevante për parlamentarët, duke demonstruar se pothuajse të gjitha çështjet që shtrohen për shqyrtim në një parlament kanë të bëjnë me OZHQ-të. Doracaku tregon se angazhimi për OZHQ-të do të kuptohet si pjesë përbërëse e punës së përditshme të një parlamenti, anëtarëve të personelit dhe parlamentarëve të tij.

Bazuar në një shqyrtim të funksioneve kryesore të parlamentit - ligjvënie, mbikëqyrje dhe përfaqësim - doracaku diskuton metoda dhe mjete të veçanta që përdoren nga parlamentarët në pjesë të ndryshme të botës që në mënyrë aktive të sigurojnë rezultate për qytetarët që përfaqësojnë dhe që e mbështesin zbatimin e OZHQ-ve. Këtu theksohen qasjet inovative për këto funksione themelore.

Së fundi, doracaku shtjellon se cili është vendi që i takon parlamentit dhe parlamentarëve në zbatimin më të gjerë të OZHQ-ve në kuadër të sistemit politik. Këtu konsiderohet puna me institucione të tjera zbatuese, të tilla si auditori kombëtar dhe zyra kombëtare e statistikave. Meqenëse parlamenti funksionon si pjesë e një sistemi më të gjerë shoqëror, doracaku gjithashtu shqyrtion si mund të angazhohen aktorët e tjerë, si anëtarët e personelit parlamentar, shoqëria civile, partitë politike dhe mediat, për t'i arritur më mirë OZHQ-të.

Secili parlament dhe parlamentarët e tij e kuptojnë më mirë kontekstin politik dhe social në të cilin veprojnë dhe janë më të aftë të përcaktojnë se çfarë mund dhe duhet të bëhet për t'i lejuar parlamentit të luajë një rol aktiv në realizimin e OZHQ-ve. Duke ndarë praktikat e mira nga parlamentet e tjera dhe duke diskutuar zbatimin e standardeve ndërkombëtare në punën e parlamenteve, doracaku është një mundësi për të filluar një diskutim mes aktorëve kyç brenda dhe jashtë parlamentit mbi mënyrat si institucion mund të përbushë më së miri mandatin e tij.

Këtu prezantohen disa qasje inovative që parlamentet specifike kanë ndërmarrë për t'u angazhuar në mbikëqyrjen e veprimitarisë së qeverisë, duke përfshirë buxhetin dhe shpenzimet. Disa prej këtyre praktikave të mira kanë potencial të jenë 'faktorë ndryshimi' në aspektin e rolit të parlamentit në arritjen e illogaridhënieve dhe zhvillimit në vend. Shembujt shënojnë përvojat me OZHM-të (si përvojë e mëparshme relevante për OZHQ-të), mbikëqyrjen financiare dhe punën e hershme për angazhimin parlamentar për OZHQ-të.

Në fund të secilës pjesë paraqitet një seri pyetjesh të shkurtra për të stimuluar reflektimin mbi rolet dhe kapacitetet aktuale parlamentare në lidhje me zbatimin e OZHQ-ve, si dhe për të nxitur diskutimin si mund t'i përmirësojnë parlamentet aftësinë e tyre për t'u angazhuar në mënyrë proaktive në zbatimin e OZHQ-ve.

I. Pujja e parlamenteve dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

A. Parlamentet dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Si përfaqësues të zgjedhur të popullit të tyre, parlamentarët kanë rol kritik për avancimin e zhvillimit të përqendruar tek qytetarët, që reflekton dhe reagon ndaj nevojave të votuesve të tyre. Në dekadat e fundit, është pranuar gjithnjë e më shumë rëndësia e angazhimit të parlamentarëve në përpjekjet për të avancuar rritjen e njeshme ndaj mjedisit dhe gjithëpërfshirëse dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Përmes mandateve të tyre kushtetuese, për shembull, për hartimin e ligjeve dhe mbikëqyrjen e politikave dhe programeve të qeverisë - përfshirë miratimin dhe shqyrtimin e buxhetit të qeverisë - dhe për përfaqësimin e pikëpamjeve të zgjedhësve të tyre, parlamentarët janë partnerë të vlefshëm për sigurimin e qeverisjes llogaridhënëse, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe transparente që kërkohet për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm për të gjithë.


Njohja e kontributit të vlefshëm që mund të jepin parlamentarët për zhvillimin e qëndrueshëm është veçanërisht kritik teksa bota ecën drejt zbatimit të Agjendës së re 2030 dhe OZHQ-ve që e mbështesin. Deklarata e Agjendës 2030 është një dokument frysues, që shprehimisht është angazhuar që "të mos lërë askënd mbrapa" dhe bën thirrje që i gjithë zhvillimi duhet të jetë "i përqendruar tek qytetarët". Ky angazhim për përfshirjen shoqërore, ekonomike dhe politike të të gjithëve, pa marrë parasysh moshën, gjininë, aftësinë e kufizuar, racën, përkatësinë etnike, origjinën, fenë ose statusin ekonomik apo tjetër, mbështet si vetë Objektivat ashtu edhe mjetet për arritjen e tyre. Parlamentarët mund të janë proaktivë në mbështetjen e këtyre përpjekjeve.

Në shtator 2015, liderët botërorë u mblodhën në Samitin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork për të lansuar agjendën e re ambicioze të zhvillimit të qëndrueshëm që do të udhëheqë komunitetin e kombeve gjatë 15 viteve të ardhshme. Udhëheqësit miratuan Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, të mbështetur nga një grup i ri prej 17 Objektivash të ndërlidhura të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Agjenda 2030 mbështetet në progresin e arritur që nga shpallja e Deklaratës së Mijëvjeçarit në vitin 2000, dhe synon të vazhdojë aty ku e lanë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), duke u bazuar në sukseset dhe duke përcaktuar një kornizë të re të guximshme për zhvillim të qëndrueshëm për të adresuar nevojat ende të paplotësuara.

Agjenda 2030 hap territore të reja me vizionin e saj për një botë më gjithëpërfshirëse, të begatë dhe të barabartë. Ajo kërkon të adresojë spektron e plotë të sfidave zhvillimore me të cilat ballafaqohen vendet dhe komunitetet, duke kaluar nëpër tri dimensione kritike të zhvillimit të qëndrueshëm - sferat mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Gjithëpërfshirshmira e Agjendës 2030 plotësohet nga fakti se është deklarohet shprehimisht se është e zbatueshme në mënyrë universale. Në vend që të fokusohet vetëm në të ashtuquajturat vende në zhvillim,

Agjenda 2030 pranon se në një botë të ndërlidhur e të globalizuar, të gjitha vendet duhet të janë proaktive në adresimin e sfidave të zhvillimit të qëndrueshëm.



Secili vend ka për detyrë të zbatojë OZHQ-të dhe secilit vend do t'i kërkohet të monitorojet progresin e arritur dhe të raportojë rregullisht në komunitetin global për sukseset dhe sfidat e ndeshura.

Në mënyrë domethënëse, ndërkojë që kishte vetëm tetë OZHM, 21 targete dhe 48 tregues, OZHQ-të mbulojnë një gamë shumë më të gjerë të çështjeve, me 17 objektiva të mbështetura tashmë nga 169 targete. Progresi drejt arritjes së këtyre targeteve do të monitorohet përmes një sërë treguesish të rindërtuar. Këta tregues janë duke u zhvilluar dhe mbikëqyrur nga Grupi Ndérinstitucional i Ekspertëve për Treguesit e OZHQ-ve, i përbërë nga zyrat kombëtare të statistikave dhe me Divisionin e Statistikave të Kombeve të Bashkuara q[shërben si Sekretariat i tij.² Duke u mbështetur në mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të OZHM-ve, parashikohet që këta tregues globalë të përdoren si udhëzues përvendet për të hartuar treguesit e tyre kombëtarë. Secili vend synon të jetë në gjendje të identifikojë targetet e veta prioritare përvendet. Pastaj, vendi duhet të hartoje tregues të përshtatshëm në nivel kombëtar përvendet mundësuar monitorimin lokal - duke përfshirë edhe parlamentet - përvendet vlerësuar progresin kundrejt vlerave bazave kombëtare dhe targeteve kombëtare që duhen arritur.

Ajameda 2030 është projektuar përvendet zbatuar përvendet gjithë qytetarët, me përpjekje përvendet ta zbërthyer zbatimin përvendet garantuar që aktivitetet të synojnë ata që kanë më shumë nevojë. Ky theksim i "lacionalizimit" të Objektivave është një element kritik i ri i zbatimit të OZHQ-ve dhe, sërisht, bazohet në mësimet e nxjerra nga OZHM-të. Ashtu si me përshtatjen e treguesve përvendet çdo situatë kombëtare, qasjet e zbatimit dhe monitorimit do të përshtaten me situatën kombëtare dhe pastaj do të shërbejnë me kontributë në sistemet e monitorimit global. Zbatimi dhe monitorimi i OZHQ-ve do të jetë i lidhur edhe me planet dhe strategjitet kombëtare të zhvillimit përvendet pasqyruar nevojat specifike të qytetarëve në vend, duke marrë parasysh faktorët demografikë, gjeografikë, socialë dhe ekonomikë.



² <http://www.scidev.net/global/sdgs/news/un-sdg-mdg-indicators-consultation.html>.



UNDP Madagaskar
Té rejat tregojnë Objektivat Globale në Samitin e të Mirës Sociale në Madagaskar në shtator 2015

Agjenda 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Si u lehtësua gjithëpërfshirja dhe pronësia e gjerë

Duke iu përgjigjur kritikës nga disa palë të interesit se OZHM-të ishin një agjendë e e nxitur në nivel ndërkombëtar me qasje "nga lartë poshtë" ndaj zhvillimit, Agjenda 2030 u zhvillua përmes një procesi angazhimi qëllimisht të hapur dhe gjithëpërfshirës, me dhe mes Shteteve Anëtare të Kombeve të Bashkuara, shoqërisë civile, sektorit privat dhe publikut në përgjithësi. Teksa OZHM-të u zhvilluan nga një grup relativisht i vogël ekspertësh zhvillimorë, Agjenda 2030 u formulua përmes konsultimeve gjithëpërfshirëse me publikun dhe palët e interesit, të dizajnuara për të pasqyruar aspiratat dhe nevojat e qytetarëve në mbarë botën.

Gjatë më shumë se tre vjetëve, u bënë përpjekje për të arritur tek një gamë e gjerë e palëve të interesit anembanë globit, për të pasur qasje në inputet, idetë dhe mendimet e tyre mbi prioritetet për veprim. Për shembull, përmes platformës online MyWorld (www.myworld2015.org), pothuajse 10 milionë qytetarë në mbarë botën ndanë pikëpamjet e tyre me Kombet e Bashkuara mbi prioritetet e çështjeve që duhet adresuar përmes OZHQ-ve. Janë bërë përpjekje për të reflektuar në mënyrë sistematike mbi çka funksionoi gjatë zbatimit të OZHM-ve, çka mund të përmirësohet dhe çka duhet bërë gjatë 15 viteve të ardhshme. Ky proces gjithëpërfshirës dhe i hapur synonte të ndërtonte një ndjenjë më të fortë të pronësisë për Agjendën 2030.

B. Përfshirja e parlamentarëve në agjendën 2030

në formimin e Agjendës 2030 ndihmuani shumë zëra, duke përfshirë ato të parlamentarëve. Ndërkohë që parlamentarët u përfshinë relativisht vonë në procesin e zbatimit dhe mbikëqyrjes së OZHM-ve, këtë radhë ishte e qartë që nga fillimi se angazhimi i parlamentarëve - jo vetëm si ligjvënës, por edhe si përfaqësues të zgjedhur të popullit të tyre - ishte me rëndësi kritike për miratimin, zbatimin dhe arritjen e OZHQ-ve në mënyrë efektive. Parlamentarët u përfshinë në vlerësimin e mangësive, mundësive dhe prioriteteve për veprim gjatë formulimit të agjendës së re të zhvillimit përmes grupimeve globale, rajonale dhe kombëtare. Ky kontribut shërbeu për produktin përfundimtar të Agjendës 2030.

Kontribute globale parlamentare në Agjendën 2030

Parlamentarët në mbarë botën u angazhuan në mënyrë aktive në procesin e hartimit të Agjendës 2030. Shumë parlamentarë u përfshinë përmes grupimeve rajonale, përmes organizatave si Asociacioni Parlamentar e Commonwealth-it, Asociacioni i Parlamentarëve Evropianë me Afrikën dhe Komuniteti i Zhvillimit të Afrikës Jugore.

Globalisht, Unioni Ndërparlamentar mbështeti parlamentarët në përfshirjen e ideve të tyre në proceset zyrtare. Që në mars të vitit 2013, Asambleja e 128-të e Unionit Ndërparlamentar miratoi Komunikatën e Quito-s, duke deklaruar: "Parlamentet më të forta do të duhet të luajnë një rol qendor në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kjo do të përfshijë sigurimin që politikat dhe planet zhvillimore të hartohen përmes proceseve pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse dhe me raporte të rregullta të progresit të paraqitura në parlament për shqyrtim".

Po ashtu, parlamentarët nga 130 legjislatura mbështetën Deklaratën e Hanoit - Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Kthimi i fjalëve në Veprim, në Asamblenë e 132-të Ndërparlamentare në prill 2015. Parlamentarët u angazhuan në mënyrë eksplikite për një proces më gjithëpërfshirës dhe të hapur të zbatimit, duke deklaruar: "[Ne] angazhohemi të bëjmë çmos për të forcuar pronësinë kombëtare të objektivave, veçanërisht duke i bërë të njohura për zgjedhësit tanë. Njerëzit duhet të kuptojnë rëndësinë e objektivave për jetën e tyre. Si përfaqësues të popullit, ne jemi përgjegjës për të siguruar që të dëgjohet çdo zë në procesin politik, pa diskriminim dhe pa marrë parasysh statusin shoqëror".

Më pas, në fillim të shtatorit të vitit 2015, Konferanca e Katërt Botërore e Kryetarëve të Parlamenteve miratoi një deklaratë mbi "Vendosja e demokracisë në shërbim të paqes dhe zhvillimit të qëndrueshëm: Ndërtimi i botës që dëshirojnë qytetarët. Kjo deklaratë theksoi rëndësinë e sigurimit që Agjenda 2030 miratoi një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut për zbatimin dhe garanci për rezultate gjithëpërfshirëse dhe të barabarta për qytetarët.

Për më Detajet shih:


Komunikata e Quito-s www.ipu.org/conf-e/128/quito-comm.htm;

Deklarata e Hanoit: www.ipu.org/conf-e/132/rpt-gendebate.htm; and

Deklarata e Konferencës së Katërt Botërore e Kryetarëve të Parlamenteve: www.ipu.org/splz-e/speakers15/declaration.pdf.

Teksa vendet tashmë presin zbatimin e OZHQ-ve, do të jetë thelbësore për parlamentarët që të reflektojnë në mënyrë proaktive mbi rolin e tyre në zbatimin dhe monitorimin e OZHQ-ve. Ndërkohë që në disa vende legjislatura kombëtare u përfshi nga afér në zbatimin e OZHM-ve, niveli i angazhimit parlamentar ishte mjaft i ndryshueshëm në nivel global. Një mësim kyç i nxjerrë nga zbatimi i OZHM-ve ka të bëjë me rolin qendor që parlamentarët mund dhe duhet të luajnë për të siguruar që zbatimi i OZHQ-ve të pasqyrojë nevojat e ndryshme të zgjedhësve të cilët janë zgjedhur për të përfaqësuar, si dhe që të përfitojnë të gjitha grupet e qytetarëve, veçanërisht ata më të pafavorizuar. Më shumë se çdo zyrtar tjetër shtetëror, parlamentarët kanë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me publikun përmes rolit të tyre si përfaqësues të zgjedhur. Kjo siguron një mundësi të paçmueshme për të nxitur llogaridhëni e brendshme për arritjen e OZHQ-ve, e cila është "e përqendruar tek qytetarët", adreson në mënyrë domethënëse nevojat e ndryshme të popullsisë së vendit (nëse konsiderohen duke iu referuar kategorive gjeografike, sociale, seksuale, etnike, kulturore apo ekonomike) dhe sjell përfitime për të gjithë.

C. Objektivi i parlamentarit: Objektivi 16 i Zhvillimit të Qëndrueshëm



Ndërkojë që parlamentarët mbajnë përgjegjësinë për të mbështetur dhe monitoruar zbatimin e të 17 OZHQ-ve dhe për të mbrojtur integritetin e Agjendës 2030, objektivi 16, i njohur si "Objektivi i Mbështetjes së Paqes dhe Qeverisjes së Mirë", ka rëndësi të veçantë për parlamentarët. Objektivi 16 ka për qëllim të "nxisë shoqëritë paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet." Gjatë 15 viteve të ardhshme, parlamentarët do të kenë një rol udhëheqës në avancimin e të gjitha aspekteve të këtij Objektivi. Kjo do të bëhet përmes mandatit të parlamentit për të hartuar ligje, për të mbikëqyrur degën e ekzekutivit të qeverisjes dhe për të përfaqësuar interesat e qytetarëve, si dhe në mënyrë më të drejtpërdrejtë si një nga institucionet përgjegjëse përsigurimin e llogaridhënieve dhe gjithëpërfshirjes.

Ndërkojë që të gjitha targetet e Objektivit 16 kanë rëndësi për parlamentarët, targetet 16.6 dhe 16.7 mbulojnë drejtpërdrejt punën e tyre. Targeti 16.6 kërkon zhvillimin e "institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet". targeti 16.7 kërkon "vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet". Për të arritur këto targete, parlamentarët do të duhet të eksplorojnë mënyra të ndryshme për të përmirësuar proceset dhe sistemet e tyre të punës. Për shembull, duke i hapur komisionet parlamentare për publikun, duke shpalosur më shumë informata parlamentare, duke inkurajuar komunikim më të mirë nga ligjvénësit dhe duke zbatuar strategji specifike për të përmirësuar pozicionin e grave dhe pjesëtarëve të grupeve të cenueshme dhe të marginalizuara.

Aktualisht, dy tregues globalë do të përdoren për ta monitoruar këtë objektiv: Treguesi 16.7.1: përpjesëtimi i pozitave (sipas gjinisë, moshës, personave me aftesi të kufizuara dhe grupeve të popullsisë) në institucionet publike (legislatura kombëtare dhe lokale, shërbimi publik dhe gjyqësori) i krahasuar me përqindjet kombëtare; dhe treguesi 16.7.2: përqindja e popullsisë që beson se vendimmarrja është gjithëpërfshirëse dhe e përgjegjshme, sipas gjinisë, moshës, paaftësisë dhe grüpuit të popullsisë.

Pyetje për reflektim

- A është përgatitur një raport që vlerëson statusin përfundimtar të zbatimit të OZHM-ve, i cili mund të ndahet me parlamentarët për t'u mundësuar të vlerësojnë arritjet, mangësitë dhe nevojat dhe priorititet e vazhdueshme?
- A janë mbajtur sesione të ndërgjegjësimit apo informimit të parlamentarëve për Agjendën 2030?
- A i ka miratuar zyrtarisht Parlamenti juaj OZHQ-të, për shembull, duke i debatuar dhe duke miratuar një mocion ose rezolutë në seancë plenare?
- A ka nisur parlamenti juaj një diskutim si mund të punojë për të mbështetur zbatimin e OZHQ 16? Duke vënë në dukje se parlamenti është një "institucion kujdestar" për OZHQ 16, a ka zhvilluar parlamenti një plan specifik në mbështetje të OZHQ 16?

II. Rol i Parlamentit në efektivitetin e zhvillimit dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Gjatë 15 viteve të fundit, qeveritë janë inkurajuar që të përqendrohen më qartë në çka është quajtur "efektiviteti i zhvillimit". Efektiviteti i zhvillimit nënkupton se duhet siguruar që vendet t'i përdorin burimet e tyre në mënyrë sa më efektive - si burimet kombëtare të ofruara nga taksapaguesit, ashtu edhe Ndihmën Zyrtare për Zhvillim (NZZH) të ofruar nga partnerët e zhvillimit, më shpesh e referuar si "ndihmë", për të adresuar sfidat e zhvillimit. Duke reflektuar përfshirë efektivitetin e zhvillimit dhe kontributin e Agjendës në zbatimin e OZHM-ve, Agjenda 2030 inkorporon në mënyrë specifike deklaratat mbi rëndësinë e ndërtimit të partneriteteve përfshirë ndikim, duke pranuar rëndësinë kritike të sigurimit që financimi përfshirë OZHQ-të vihet në dispozicion dhe përdoret në mënyrën më efektive.

Agjenda 2030 në mënyrë eksplikite pranon rëndësinë e zhvillimit të proceseve që: "do të jenë vullnetare dhe të udhëhequr nga vendi, do të marrin parasysh realitetet e ndryshme kombëtare... do të ndihmojnë në mobilizimin e mjeteve të nevojshme të zbatimit dhe partneriteteve, do të mbështesin identifikimin e zgjidhjeve dhe praktikave më të mira dhe do të promovojnë koordinimin dhe efektivitetin e sistemit ndërkombe të zhvillimit...; do të jenë të hapura, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe transparente përfshirë qytetarët dhe do të mbështesin raportimin nga të gjithë palët relevante të interesit; ... do të jenë të përqendruara tek qytetarët, të ndjeshme ndaj gjinisë, do të respektojnë të drejtat e njeriut dhe do të kenë një fokus të veçantë tek më të varfrit, më të ceneshtëve atë që kanë mbetur pas."³

Ndërtimi i partneriteteve përfshirë zhvillim

Agjenda 2030 pranon qartë se identifikimi i proceseve dhe mjeteve të zbatimit do të jetë kritik përfshirë suksesin e të gjithë kornizës. Për këtë qëllim, i fundit prej OZHQ-ve - Objekti 17 - përcakton si duhet të avancohet Agjenda 2030, duke i dhënë përparrësi "rivitalizimit të partneriteteve globale përfshirë zhvillim". Objekti 17 pranon se zhvillimi nuk lidhet vetëm me NZZH-në, por duhet të ketë një qasje më të gjerë përfshirë që përpjekjet janë të qëndrueshme, dhe nën pronësi dhe nxitje lokale.


Në mënyrë të veçantë, Objekti 17 identifikon një sërë prioritetesh globale të nivelit të lartë, duke përfshirë progresin në reduktimin e borxhit përfshirë vendet me borxhe të larta, sigurimin e qasjes në tregtinë pa bariera, nxitjen e investimeve në sektorin privat dhe rritjen e stabilitetit makroekonomik global. Gjithashtu, Objekti thekson rëndësinë e ndërtimit të kapaciteteve përfshirë fuqizuar aktorët kombëtarë përfshirë shfrytëzuar me më shumë efektivitet kornizat ndërkombe.

NZZH-ja shpesh përbën një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të qeverive në vendet në zhvillim, duke përfshirë një numër të konsiderueshëm të vendeve më pak të zhvilluara dhe vendeve të vogla ishullore në zhvillim. Skepticizmi në rritje në shumë vende perëndimore përfshirë efektivitetin e ndihmës po rrit kërkësën përfshirë efektivitetin e një asistence të tillë. Në të njëjtën kohë, në vendet në zhvillim po ngriten pyetje përfshirë mbajtjen e fondeve të tillë "jashtë buxhetit" dhe përfshirë arsyesh larg nga kërkësat e transparencës, llogaridhënieve dhe auditimit që zbatohen përfshirë burimet e buxhetit të brendshëm. Si institucion kyç i llogaridhënieve, parlamentet kanë një rol vendimtar përfshirë nxitje efektivitetin e zhvillimit. Deri më sot, jo gjithmonë financimi i NZZH-

³ <http://www.oecd.org/development/effectiveness/busanpartnership.htm>.

së realizohet përmes buxhetit vjetor të shtetit, duke e bërë mbikëqyrjen e shpenzimeve të saj edhe më sfiduese për parlamentin.

Është e rëndësishme që parlamentarët të jenë të vetëdijshëm për të gjithë NZZH-në e ofruar për degën ekzekutive të qeverisjes dhe se si të monitorohet më mirë zbatimi i saj. Kjo mund të kërkojë që parlamentet të kërkojnë më menyrë më proaktive transparencë të buxhetit dhe të verifikojnë që ligjet dhe rregulloret e buxhetit zbatohen më menyrë eksplícite për burimet e jashtme dhe të brendshme. Deklarata e Parisit për Efektivitetin e Ndihmës (Pronësia, Harmonizimi, Përafrimi, Rezultatet dhe Llogaridhënia Reciproke), Agjenda vijuese e Accra-s për Veprim (AAV) dhe Forumi i Katërt i Busan-it i Nivelit të Lartë për Efektivitetin e Ndihmës (FNL 4 Busan) janë themelët e angazhimeve dhe detyrimeve të partneritetit brenda një kuadri të ndërsjellë të llogaridhënieve që pranon se ndihma efektive duhet të harmonizohet me strategjitet zhvillimore të udhëhequra nga vendi. Llogaridhënia e ndërsjellë synon të vendosë marrëdhënien e ndihmës në baza dypalëshe kontraktuale, në të cilat donatorët angazhohen për të siguruar ndihmë efektive dhe përfituesit angazhohen ta përdorin mirë ndihmën dhe më menyrë transparente. Ky rezultat i qeverisjes mund të arrihet vetëm përmes mekanizmave të rrënjosura në llogaridhëni publike, siç tregon edhe diagrami i mëposhtëm.⁴



⁴ <http://www.agora-parl.org/resources/aoe/parliamentsandaideffectiveness>.

Janë miratuar disa marrëveshje gjatë dekadës së fundit që kanë krijuar mekanizma dhe protokolle kyçë për një efektivitet më të madh të zhvillimit. Në kontekstin e Agjendës 2030, do të jetë e dobishme për parlamentarët që të njihen me proceset dhe kornizat e mëposhtme të efektivitetit të zhvillimit.

- **Forumi Politik i Nivelit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm:** Forumi Politik i Nivelit të Lartë për Zhvillimin e Qëndrueshëm (FPNL) është forumi primar i Kombeve të Bashkuara për përcjelljen dhe shqyrtimin e Agjendës 2030. Ky forum është i ngarkuar me ofrimin e udhëheqjes politike, udhëzimeve dhe rekomandimeve për të gjitha aspektet e zbatimit dhe përcjelljes së Agjendës 2030, duke përfshirë ndjekjen e progresit, inkurajimin e formulimit të politikave më koherente dhe të informuara nga dëshmitë dhe përvojat e vendeve dhe që trajtojnë çështjet në zhvillim, kur ato bëhen të dukshme. FPNL-ja e parë vjetore u zhvillua në vitin 2016 dhe përfshiu shqyrtimë vullnetare të 22 vendeve dhe shqyrtimë tematike të progresit për OZHQtë, duke përfshirë vlerësimin e efektivitetit të vendeve në zbatimin e partneriteteve për efektivitetin e zhvillimit. Çdo FPNL gjithashtu do të organizojë një sërë ngjarjesh anësore, duke përfshirë forume në të cilat duhet të përfshihen parlamentarët.

Mbretëria e Bashkuar: Sigurimi i vlerës për paratë përmes mbikëqyrjes parlamentare të asistencës për zhvillim jashtë shtetit

Mbretëria e Bashkuar, si një ofrues madhor i ndihmës zyrtare për zhvillim (NZZH), ndërmerr një qasje proaktive dhe inovative për të promovuar efektivitetin e zhvillimit, ku përfshihet një rol i qartë për parlamentin në mbikëqyrjen e ofrimit të NZZH-së dhe garantimin e vlerës për paratë.

Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar ka themeluar një Komitet të Zhvillimit Ndërkombëtar në Dhomën e Komunave, i cili është një komision parlamentar i përbërë nga njëmbëdhjetë deputetë. Komiteti ka mandat hetimor. Ai vendos programin e vet dhe zgjedh lëndët për hetime. Për secilën hetim lëshohet një njoftim për shtyp ku renditen termat e referencës dhe ftohen palët e interesit që të dërgojnë parashresa me shkrim. Për shumicën e hetimeve, Komiteti i Zhvillimit Ndërkombëtar mban edhe sesione të hapura për publikun me pyetje dhe përgjigje të "dëshmive gojore" të dëshmitarëve.

Në mbështetje të Komitetit të Zhvillimit Ndërkombëtar, Mbretëria e Bashkuar ka themeluar edhe Komisionin e Pavarur për Ndikimin e Ndihmës (ICAI). Edhe pse është një agjenci e degës ekzekutive, ky komision është funksionalisht i pavarur nga qeveria dhe raporton direkt tek Komiteti i Zhvillimit Ndërkombëtar. ICAI ndërmerr shqyrtimë të pavarura të shpenzimeve të ndihmës të Mbretërisë së Bashkuar dhe kontributit të saj në rezultatet e zhvillimit. Kur komisioni prodhon një raport, qeveria duhet të publikojë një përgjigje që shpjegon nëse i pranon dhe si do t'u përgjigjet rekomandimeve të raportit. Nën-Komiteti për ICAI-n i Komitetit të Zhvillimit Ndërkombëtar më pas mban një seancë për raportin dhe përgjigjen e qeverisë.

Mandati i ICAI-t mbulon të gjitha ndihmat për zhvillim të Mbretërisë së Bashkuar, cilid qoftë departamenti që shpenzon fondet. Përveç Departamentit për Zhvillim Ndërkombëtar, shqyrtimet e tij kanë përfshirë departamentet që shpenzojnë në NZZH, si Departamenti për Energjinë dhe Ndryshimet Klimatike, Forin Ofis (Foreign Office) dhe e Komonuelhit (Commonwealth) dhe fondet ndërinstitucionale, si Fondi i Konfliktit, Stabilitetit dhe Sigurisë dhe Fondi Ndërkombëtar i Klimës.

Për më shumë informata, shih: www.parliament.uk/business/committees/committees-a-z/commons-select/international-development-committee/role/ and <http://icai.independent.gov.uk/about-us/>.

- **Partneriteti i Busanit për Bashkëpunim Efektiv të Zhvillimit (2011):** Partneriteti i Busanit është një marrëveshje ndërkombëtare që përfaqëson një ndryshim kritik nga një marrëdhënie e

njëanshme donator-përfitues drejt partneriteteve të barabarta dhe të bazuara në përgjegjësitë reciproke për të garantuar ndikimin nga financimi i zhvillimit. Partneriteti i Busanit angazhoi vendet për katër parime kyçë: (i) pronësia e zhvillimit të prioriteteve nga vendet në zhvillim; (ii) një fokus mbi rezultatet dhe ndikimin e qëndrueshëm; (iii) partneritete për zhvillim që njojin diversitetin dhe komplementaritetin e funksioneve; dhe (iv) transparensa, llogaridhënia dhe përgjegjësia e përbashkët. Partneriteti i Busanit çoi në krijimin e Partneritetit Global për Zhvillimin e Efektivitetit të Zhvillimit (GPDEC), një forum për të siguruar llogaridhënie në zbatimin e angazhimeve të Busanit në nivel politik. GPDEC-ja drejtohet nga forumet e nivelit të lartë që mbahen çdo dy vjet, ku mblidhen udhëheqësit politikë, duke përfshirë edhe parlamentarët. Takimi i parë i nivelit të lartë u mbajt në Meksikë më 2014.⁵ Takimi ishte një forum i posaçëm parlamentar që mblodhi parlamentarë nga e gjithë bota për të artikuluar një perspektivë parlamentare mbi temat kryesore të takimit, duke përfshirë mobilizimin e burimeve vendore dhe identifikimin e mënyrave si pjesëmarrja parlamentare mund të çojë në rezultate më të mira zhvillimore.

- **Ajjeta e Veprimit e Addis Abebas⁶ (2015):** Ajjeta e Veprimit e Addis Abebas është dokumenti përfundimtar i Konferencës së Tretë Ndërkombëtare mbi Financimin për Zhvillim, të mbajtur në qershor 2015. Duke pranuar se NZZH-ja nuk është burimi i vetëm ndërkombëtar - dhe as më i madhi - i financimit për zhvillim, Ajjeta e Addis Abebas u përpoq të hapte një vlerësim më gjithëpërfshirës të mënyrave si mund të mobilizoheshin me më shumë efektivitet trilionët e dollarëve të paraparë si të nevojshme për të financuar Agjendën 2030. Kjo kornizë e re globale mbulon financimin nga burime të tilla si bashkëpunimi për zhvillim, taksimi ndërkombëtar dhe tregtia, si dhe një sërë rregullash dhe reformash institucionale. Ajjeta e Addis Abebas lidhet veçanërisht me mjetet më efektive të zbatimit të OZHQ-ve, sipas OZHQ 17.
- **Iniciativa për Transparencën e Ndihmës Ndërkombëtare:** Iniciativa për Transparencën e Ndihmës Ndërkombëtare (IATI) (www.aidtransparency.net) është një iniciativë vullnetare dhe me shumë palë të interesit, e cila synon të përmirësojë transparencën në lidhje me ndihmën, zhvillimin dhe burimet humanitare, për të rritur efektivitetin e tyre në luftën kundër varfërisë. Sekretariati i saj menaxhohet nga një konsorcium i udhëhequr nga UNDP-ja. IATI bashkon vendet donatore dhe përfituese, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët në informacionin e ndihmës, të cilët janë të angazhuar të punojnë së bashku për të rritur transparencën dhe hapjen e ndihmës dhe për të monitoruar rrjetin e ndihmës. Standardi IATI, një format dhe kornizë për publikimin e të dhënavëve për aktivitetet e bashkëpunimit zhvillimor, është në dispozicion për të gjitha organizatat zhvillimore, përfshirë donatorët e qeverisë, organizatat e sektorit privat dhe OJQ-të kombëtare dhe ndërkombëtare. Parlamentarët janë të inkurajuar të shqyrtojnë të dhënat e ofruara në portalin IATI për të mësuar më shumë rreth fondeve zhvillimore që shpenzohen nga qeveritë e tyre, si dhe për burimet e atyre fondeve. Ky informacion mund t'u ndihmojë parlamentarëve që ta monitorojnë më mirë buxhetin dhe ndikimin e tij.

Pyetje për reflektim

- Nëse vendi juaj është përfitues i Ndihmës Zyrtare për Zhvillim, a përfshihet NZZH-ja në buxhetin vjetor si një formë e të ardhurave të qeverisë?
- Si e monitoron parlamenti juaj shpërndarjen dhe përdorimin e NZZH-së, qoftë si donator apo si përfitues?
- A keni një komision parlamentar të ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të angazhimeve zhvillimore të qeverisë suaj, duke përfshirë vlerësimet e ndikimit të ndihmës së marrë apo ofruar?
- A ka Parlamenti juaj informata dhe kompetenca të nevojshme për të shqyrtaq siç duhet sa efektive është NZZH-ja?

⁵ Për më shumë informacion, shih: www.ipu.org/splz-e/mexico14.htm.

⁶ <https://sustainabledevelopment.un.org/frameworks/addisababaactionagenda>.

III Bashkërendimi i përpjekjeve për një zbatim më të mirë

A. Kthimi në prioritet i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe koordinimi i zbatimit të tyre në të gjitha degët e qeverisjes

Marrëdhënia mes parlamentit dhe degëve ekzekutive të qeverisjes është komplekse. Si fillim, në shumë vende ka një ndarje kushtetuese mes autoritetit dhe përgjegjësive të këtyre dy degëve, si dhe të gjyqësorit, dega e tretë e qeverisjes. Derisa dega ekzekutive është përgjegjëse për përdorimin dhe zbatimin e ligjeve dhe buxheteve, është roli i parlamentit që të miratojë ligje dhe të shqyrtojë planet fiskale. Përveç kësaj, parlamenti është përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së degës ekzekutive dhe sigurimin e llogaridhënieve për veprimet e saj.

Mund të ekzistojnë dallime politike në lidhje me mjetet më të mira për arritjen e zhvillimit afatgjatë të një vendi. Por është shumë e dëshirueshme që të bëhen përpjekje për një konsensus në të gjithë spektrin politik në lidhje me objektivat dhe objektivat e gjera për zhvillimin e një kombi, madje edhe përtej afatit të vitit 2030 të caktuar për OZHQ-të.

Angazhimi i një vendi për zbatimin e OZHQ-ve bëhet nga dega ekzekutive dhe të gjitha raportimet në lidhje me progresin bëhen zyrtarisht nga kjo degë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se parlamenti është i përjashtuar nga procesi. Që nga fillimi i zbatimit të OZHQ-ve, parlamenti duhet të angazhohet në të gjitha aspektet e planifikimit të zbatimit. Kjo nuk është vetëm nevojë politike, por bëhet për të nxitur pronësinë e thellë të OZHQ-ve nga parlamenti dhe parlamentarët. Kur miratohen ose ndryshohen ligjet dhe duhet të rregullohen buxhetet, parlamenti duhet të jetë në gjendje të debatojë ndryshimet me vetëdije të plotë për kontekstin.

Mënyra si do ta koordinojë një qeveri zbatimin e OZHQ-ve në të gjitha fushat e saj të veprimtarisë do të varet nga një sërë faktorësh, duke përfshirë sistemin politik të vendit të veçantë. Megjithatë, praktikat e mira specifike mund të identifikohen nga përvojat e kaluara të disa vendeve, siç përshkruhet më poshtë.

- **Task forca ose komiteti drejtues i zhvillimit kombëtar:** Nga qeveria mund të krijuhet një formë e grupit punues ose komitetit drejtues për të mbikëqyrur dhe udhëzuar zbatimin e OZHQ-ve. Teksa një organ i tillë zakonisht ngrihet nga dega ekzekutive, praktika e mirë kërkon që të sigurohet anëtarësim gjithëpërfshirës, jo vetëm duke përfshirë përfaqësuesit e parlamentit (si nga qeveria ashtu dhe nga opozita), por edhe nga sektori privat dhe shoqëria civile. Nëse parlamenti është i përfaqësuar në një komitet të tillë, është e rëndësishme të krijuhet një mekanizëm formal i raportimit nga përfaqësuesit e tij, në mënyrë ideale përmes një komisioni me mandat të caktuar në seancë plenare.
- **Hartimi i planit zhvillimor kombëtar:** Plani zhvillimor kombëtar është një udhërrëfyes shumëveçar dhe strategjik që përcakton mënyrat si një vend synon të arrijë zhvillim të qëndrueshëm njerëzor. Plani zhvillimor kombëtar përcakton përpërësitetë kryesore dhe treguesit përmes matjën e suksesit. Planet zhvillimore kombëtare duhet të shqyrtohen në mënyrë specifike dhe të përafrohen me OZHQ-të për të krijuar një plan të vetëm kombëtar për zhvillim që përfshin angazhimet globale të OZHQ-ve dhe i lokalizon ato përmes adresuar prioritetet kombëtare dhe nën-kombëtare. Parlamenti duhet të angazhohet në formulimin e planit zhvillimor kombëtar (ose ndonjë forme tjeter të planit të zbatimit të OZHQ-ve): duhet të parashistrohet - dhe të diskutohet dhe të miratohet - nga parlamenti para zbatimit.

Indonezi: Mbështetja e zbatimit gjithëpërfshirës të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm përmes një sekretariati të përbashkët

Indonezia përqafon plotësisht nevojën për të zbatuar objektivat globale të zhvillimit. Duke filluar me OZHM-të, dhe tanj duke zbatuar OZHQ-të, qeveria po punon për të vendosur një proces gjithëpërfshirës për arritjen e objektivave. Kjo do të përfshijë krijimin me Dekret Presidencial të një Sekretariati të Përbashkët që përbëhet nga zyrtarë të lartë nga dega ekzekutive, organizata kombëtare të shoqërisë civile, sektori privat dhe akademikë, duke ftuar edhe parlamentin. Mandati i Sekretariatit do të jetë formulimi dhe zbatimi i objektivave të zhvillimit në nivel strategjik. Ai është edhe vendi kyç për adresimin e ndonjë pengese politike apo organizative që ndal arritjen e objektivave.

- **Zbatimi i planit zhvillimor kombëtar:** Pas miratimit të planit zhvillimor kombëtar, dega ekzekutive duhet të raportojë rregullisht në parlament, normalisht në baza vjetore, mbi progresin e arritur dhe sfidat me të cilat ballafaqohet zbatimi i planit. Rregullorja e parlamentit duhet të lejojë që raporti i qeverisë t'i referohet një komisioni parlamentar me mandat të duhur për shqyrtim të detajuar, duke përfshirë pranimin e parashtresave nga publiku për përbajtjen e tij, si dhe për të raportuar në seancë plenare duke lejuar që raporti i komisionit të paraqitet dhe debatohet publikisht. Në nivel global, vendet gjithashtu mund të prodhojnë vullnetarisht raporte periodike të progresit që do të shqyrtohen nga Forumi Politik i Nivelit të Lartë i Kombeve të Bashkuara. Këto raporte duhet të parashtronë dhe të diskutohen në parlament.
- **Bashkërendimi me ministritë udhëheqëse:** Në disa vende, mbikëqyrja e planit zhvillimor kombëtar udhëhiqet nga një ministri, për shembull, ministria e planifikimit, e financave ose e zhvillimit. Rregullorja e parlamentit duhet të parashikojë një shqyrtim të rregullt (idealist vjetor) të performancës së këtyre ministrive nga një komision me mandatin e duhur, me një raport në seancë plenar për parashtrim dhe debat publik. Një mekanizëm i tillë siguron që parlamentarët dhe publiku të jenë të vetëdijshëm për çështjet dhe sfidat e zbatimit të zhvillimit.

Pyetje për reflektim

- A është angazhuar parlamenti në përgatitjen e planit zhvillimor kombëtar ose në ndonjë formë tjetër të planit të zbatimit të OZHQ-vë, për shembull, përmes një grupei drejtues me shumë palë të interesit?
- A janë angazhuar parlamentarët, duke përfshirë edhe opozitën, në zbatimin dhe mbikëqyrjen e planit zhvillimor kombëtar, përmes pjesëmarrjes në ndonjë formë të grupeve ndërsektoriale ose përmes proceseve parlamentare, siç është sistemi i komisioneve parlamentare?
- A duhet që plani zhvillimor kombëtar të parashtronet dhe debatohet në parlament para se të mund të zbatohet?
- A raporton dega ekzekutive rregullisht në parlament për zbatimin e planit zhvillimor kombëtar, duke përfshirë zbatimin e OZHQ-ve?

B. Puna me institucionet e tjera të mbikëqyrjes

Roli i parlamentit si institucion kyç për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe shpenzimeve nga qeveria do të diskutohet në hollësi më tutje në këtë doracak. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se ekzistojnë institucione të tjera mbikëqyrëse që gjithashtu kanë një rol në monitorimin e punës së qeverisë. Disa nga këto institucione mund t'i raportojnë degës ekzekutive, ndërsa të tjera raportojnë drejtësore në parlament. Pa marrë parasysh detajet specifike të mandatit dhe strukturës së raportimit, koordinimi i përpjekjeve me këto institucione është i domosdoshëm për të siguruar mbikëqyrje efektive të zbatimit të OZHQ-ve.

Më poshtë jepet një listë e institucioneve tipike të mbikëqyrjes së qeverisë.

- **Institucioni suprem i auditimit:** Institucioni suprem i auditimit i referohet agjencisë së qeverisë që kryen dhe publikon auditime të hollësishme financiare dhe të performancës të agjencive përbërëse të qeverisë. Në disa vende, kjo agjenci njihet si Auditori i Përgjithshëm, ndërsa në të tjera mund të quhet Gjykata e Llogarive (ose Cour de Comptes). Cilido qoftë emri, roli që luan institucioni në monitorimin e shpenzimeve qeveritare është kritik, dhe analizat e tij të hollësishme ndihmojnë parlamenti në punën e vet. Zakonisht, organeve të tillë u kërkohet t'i parashtojnë raportet e tyre çdo vit në parlament, i cili ngarkon një komision me ndërmarrjen e një shqyrtimi më të thelluar të gjetjeve dhe raportimin në seancë plenare për të lehtësuar debatin e raportit. Ky proces mund të përdoret për të vlerësuar më mirë nëse shpenzimet qeveritare janë përdorur për të arritur progres në zbatimin e planit zhvillimor kombëtar (përfshirë OZHQ-të).

Brazil: Promovimi i bashkëpunimit mes parlamentit dhe auditorit shtetëror

Neni 72 i Kushtetutës së Brazilit parashikon që Gjykata Federale e Auditimit dhe Komiteti i Përbashkët i Buxhetit i Kongresit kanë mandat të përbashkët për të hetuar parregullsitë në buxhetin vjetor të shtetit dhe zbatimin e tij. Komiteti i Përbashkët ka autoritetin të kërkojë dëshmi dhe dokumente nga ministritë dhe agjencitë e qeverisë. Nëse nuk jepen, Gjykata Federale e Auditimit duhet të japë një mendim brenda 30 ditëve nëse kërkesa e Komitetit të Përbashkët është e përshtatshme apo jo. Nëse Gjykata pajtohet me Komitetin, ministria ose agjencia duhet të pajtohet me kërkesën e Komitetit për t'iu nënshtuar hetimit të tij.

Shih: Kushtetuta e Brazilit në

<http://english.tse.jus.br/arquivos/federal-constitution>

- **Institucioni kombëtar për të drejtat e njeriut:** Shumica e vendave kanë një organ të pavarur që promovon të drejtat e njeriut - si dhe monitoron dhe heton shkeljet e tyre. Duke pasur parasysh se shumë OZHQ lidhen me barazinë dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe nevojave të grupeve të marginalizuara, parlamenti duhet të tregojë interesim të veçantë në punën e kësaj agjencie. Institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut shpesht u kërkohet të raportojnë çdo vit në parlament, çka ofron një mundësi që parlamenti të gërmojë më thellë - zakonisht përmes një komisioni parlamentar me mandat të duhur - në gjetjet e tyre dhe të shqyrtojë nëse dhe si është duke funksionuar qasja zhvillimore e bazuar në të drejta (përfshirë zbatimi i OZHQ-ve).
- **Komisioni Kombëtar kundër Korruptionit:** Në disa vende, një agjenci është përgjegjëse për të gjitha aspektet e luftës kundër korruptionit - edukimin qytetar, hetimin, ndjekjen penale - ndërsa në vende të tjera një numër organizatash mund të kenë mandate për këto komponentë të ndryshëm. Sido që të jetë, parlamenti, veçanërisht komisionet e mbikëqyrjes, siç janë Komisionet për Llogaritë Publike, Buxhet dhe Financa ose të Garancive Qeveritare, do të ushtrojnë kontroll mbi punën e agjencisë apo agjencive të interesuara. Në disa parlamente, si Hong Kong dhe New South Wales, komisionet specifike kundër korruptionit monitorojnë punën e agjencive të pavarura kundër korruptionit.

- **Agjenci të tjera të mbikëqyrjes:** Ekzistojnë agjenci të ndryshme që kryejnë aktivitete mbikëqyrëse, siç është Komisioneri i Mjedisit, Avokati i Popullit, Këshilli Konsultues për Statusin e Grave dhe Prokuroria Publike.

Tunizi: Organi i pavarur kushtetues për zhvillimin e qëndrueshëm

Kushtetuta e viti 2014 e Republikës së Tunizisë parashikoi krijimin e disa organeve kushtetuese të pavarura, duke përfshirë Komisionin për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe të Drejtat e Brezave të Ardhshëm. Anëtarët emërohen nga Asambleja e Përfaqësuesve të Popullit (dhoma e ulët e parlamentit) me mandatin e mëposhtëm, të parashikuar në nenin 129 të Kushtetutës:

Komisioni për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe të Drejtat e Brezave të Ardhshëm do të konsultohet për projektligjet që lidhen me çështjet ekonomike, sociale dhe mjedisore, si dhe për planet zhvillimore. Komisioni mund të japë mendimin e vet për çështjet që u përkasin fushave të veta të përgjegjësisë.

Komisioni përbëhet nga anëtarë me kompetencë dhe integritet, të cilët i kryejnë detyrat e tyre për një mandat të vetëm gjashtëvjeçar.

Shih: Kushtetuta e Republikës së Tunizisë në <http://tunisia-tn.com/constitution-of-the-republic-of-tunisia/constitution-of-tunisia-independent-constitutional-bodies-2/>.

Parlamenti duhet të inkurajojë, kur është e përshtatshme, ndarjen e dëshmive dhe analizave të kryera mes institucioneve mbikëqyrëse. Gjithashtu, mund të inkurajojë ndarjen e ekspertizës teknike, siç është delegimi ose dëshmia e ekspertëve të punësuar nga agjencitë e mbikëqyrjes në një komision parlamentar. Çështja kryesore është të pranohet se çdo institucion ka pikat e forta dhe dobësitë e veta dhe të inkurajohet bashkëpunimi në një mënyrë që maksimizon kapacitetin e secilit organ dhe shhang dyfishimin e funksioneve dhe burimeve.

Pyetje për reflektim

- Cilat janë institucionet e pavarura mbikëqyrëse në vendin tuaj?
- Cilat janë komisionet e mbikëqyrjes në parlamentin tuaj?
- A ekziston një marrëdhënie e qartë dhe që funksionon mirë ndërmjet parlamentit tuaj dhe institucioneve mbikëqyrëse të vendit tuaj?
- Cilat bariera parandalojnë një marrëdhënie të tillë dhe si mund të minimizohen apo eliminohen?

C. Puna me organet kombëtare të statistikave

Në shumë vende, një agjenci qeveritare ose ministri është përgjegjëse për mbledhjen, interpretimin dhe publikimin e statistikave kyçë, siç janë shkalla e papunësisë, shkalla vjetore e lindjeve dhe vdekjeve, kostoja e jetesës dhe treguesit e shëndetësisë. Për qëllime të këtij doracaku, do t'u referohemi si Zyra Kombëtare të Statistikave. Një Zyrë Kombëtare e Statistikave është kritike për zbatimin e OZHQ-ve, sepse është mbledhësi qendror i të dhënave që do të përcaktojë nëse, kur dhe deri në çfarë mase janë arritur treguesit dhe standartet për secilin OZHQ. Disa Zyrat Kombëtare të Statistikave janë ngarkuar me zhvillimin e treguesve globalë për OZHQ-të e ndryshme përmes Grupit të Ekspertëve për Treguesit e OZHQ-ve.

Mongoli: Zyra Kombëtare e Statistikave dhe objektivat zhvillimore

Në Mongoli, Zyra Kombëtare e Statistikave ka marrë rolin udhëheqës në përcaktimin e treguesve për OZHQ-të. Zyra Kombëtare e Statistikave është ngarkuar nga qeveria që:

- të dizajnojë metodologjitetë për treguesit kombëtarë të OZHQ-ve në lidhje me institucionet përkatëse;
- të përpilojë statistika të nivelit kombëtar duke përdorur të dhënat nga Zyra Kombëtare e Statistikave dhe nga institucionet relevante; dhe
- të parashtrojë treguesit kombëtarë bazë.

Zyra Kombëtare e Statistikave punon si pjesë e një ekipi të ministrive, duke përfshirë Ministrinë e Financave, për të monitoruar zbatimin e Objektivave.

Burimi:

http://www.unsiap.or.jp/programmes/ms_materials/ms12/T3_2_MNG_The%20case%20of%20SDGs%20%5bCompatibilityMode%5d.pdf

Mbledhja e të dhënave në lidhje me progresin në zbatimin e OZHQ-ve dhe planin zhvillimor kombëtar duhet t'i caktohet qartë Zyrës Kombëtare të Statistikave. Parlamenti duhet të verifikojë, përmes funksionit të mbikëqyrjes, se të dhënat e nevojshme janë mbledhur, përpunuar dhe ndarë dhe se Zyra Kombëtare e Statistikave ka burimet dhe kapacitetin për ta bërë këtë. Pasi të grumbullohen dhe të shpërndahen, të dhënat do të ofrojnë dëshmi që mund të përdoren nga parlamenti në mbikëqyrjen e vet të zbatimit të OZHQ-ve. Për shembull, nëse vdekjet nga malaria nuk kanë rënë, parlamentarët mund të duan të shtyjnë për më shumë fonde për parandalimin e malaries. Nëse përqindja e vajzave që ndjekin shkollën e mesme nuk është rritur, parlamenti duhet të marrë në konsideratë se çfarë duhet bërë për të siguruar rritjen e shkallës së frekuentimit, për shembull me legjislacion të ri, zbatim më të mirë ose më shumë fonde.

Pyetje për reflektim

- A ka një Zyrë Kombëtare të Statistikave në vendin tuaj?
- A ka parlamenti juaj një mekanizëm - një shqyrtim të rregullt nga një komision me mandatin e duhur - për të konfirmuar që Zyra Statistikore Kombëtare ka burime të mjaftueshme për të kryer punën e saj dhe se puna e saj teknike është e lirë nga ndërhyrjet politike?
- A ka parlamenti juaj qasje në të dhënat e mbledhura nga Zyra Kombëtare e Statistikave?
- Si duhet që parlamenti t'i përdorë më mirë të dhënat që merr nga Zyra Kombëtare e Statistikave?

D. Puna me organet ndërkombëtare dhe rajonale

Është e rëndësishme për parlamentet dhe parlamentarët të dinë se ata nuk janë të vetëm në përpjekjet e tyre për të monitoruar zbatimin e OZHQ-ve për të arritur objektivat kyçë të zhvillimit. Shumë organizata rajonale dhe globale punojnë për të promovuar arritjen e një ose më shumë prej OZHQ-ve. Disa prej këtyre grupeve mund të janë tashmë të angazhuar me parlamentin tuaj; nëse jo, ata mund të angazhohen për të mbështetur punën e parlamentarëve dhe parlamentit për të ndërtuar kapacitete dhe për të mbështetur përpjekjet tuaja për të qenë një partner i plotë dhe aktiv në zbatimin e OZHQ-ve në vendin tuaj.



Punëtoria Rajonale për Parlamentet dhe OZHQ-të, 30 deri më 31 gusht 2016, Xhakarta, Indonezi.

Më poshtë janë gjashtë kategori të gjera të organizatave që mbështesin parlamentet në ndërtimin e kapaciteteve dhe me të cilat parlamentet mund të punojnë për t'i përmbushur më mirë funksionet e tyre bazë në lidhje me OZHQ-të.

- Asambletë ndërparlamentare dhe rrjetet e parlamenteve:** Si institucion, parlamenti juaj ka gjasa të jetë anëtar i një rrjeti rajonal ose global të institucioneve të ngjashme (p.sh. Unioni Ndërparlamentar, Parlamenti Arab, Asociacioni Parlamentar i Commonwealth-it, Asambleja ndërparlamentare e ASEAN-it, Parlamenti Mbarë Afrikan, Forumi Parlamentar Afrikano Jugor i Komunitetit Zhvillimor, Konfederata Parlamentare e Amerikave). Këto grupe takohen rregullisht për të debatuar çështje me interes të përbashkët, për të zhvilluar punëtori dhe për të ofruar doracakë dhe materiale të tjera për të edukuar parlamentarët dhe anëtarët e personelit për çështjet kyçë të zhvillimit dhe rolin e parlamentit në lidhje me to.
- Rrjetet e parlamentarëve:** Edhe parlamentarët individualë kanë rrjete që punojnë përmes degëve kombëtarë, ndërpartiake dhe në nivel rajonal dhe global për të nxitur çështjet kyçë të zhvillimit, siç janë ndryshimet klimatike (GLOBE International), energjia e ripërtërishme (Parlamenti i Klimës) dhe kundër korruptionit (GOPAC). Këto organizata nuk mbështeten në miratimin institucional për punën e tyre, por ndërtojnë lidhje ndërkombëtare mes parlamentarëve individualë për të krijuar konsensus për ndryshim.
- Organizatat shumëpalëshe:** Organizata që shpesh janë të lidhura me Kombet e Bashkuara dhe kanë mandat për të mbështetur punën e parlamenteve (siç është UNDP, që është zbatuesi më i

madh në botë i programeve të forcimit parlamentar) ose kanë mandat specifik tematik (si UN Women, Fondi i Emergjencave të Fëmijëve dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë). Ky grup do të përfshinte edhe Bankën Botërore dhe bankat rajonale dhe tematike të zhvillimit (për shembull, Banka Islamiqe për Zhvillim). Këto organizata do të kenë plane afatgjata për mbështetje për zhvillimin e një vendi që mund të përfshijnë mbështetje për kapacitetin e parlamentit. Një mbështetje e tillë sjell me vete ekspertizën dhe njohuritë e klasit botëror.

- **Organet e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut:** Agjenda 2030 synon të realizojë të drejtat njerëzore të të gjithëve. Roli i deputetëve në mbikëqyrjen e zbatimit të OZHQ-së është përforcon reciprokisht rolin e tyre në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, edhe përmes traktateve dhe konventave ndërkombëtare, dhe duke siguruar pajtueshmërinë me konceptet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në ligj dhe në praktikë. Pjesëmarrja në raportimin ndaj organeve të traktateve të të drejtave të njeriut dhe në Shqyrtimin Periodik Universal ofron një mënyrë të mirë për angazhimin e parlamentarëve.⁷
- **OJQ-të ndërkombëtare:** Disa OJQ ndërkombëtare kanë një mandat specifik për të punuar me parlamentet për të ndërtuar kapacitetet e tyre, për shembull, Instituti Kombëtar Demokratik për Çështjet Ndërkombëtare, Instituti Ndërkombëtar Republikan, Fondacioni Westminster për Demokraci dhe disa fondacione politike dhe institute kombëtare të demokracisë shumëpartiake. Të tjerë kanë një mandat sektorial që përfshin punën me parlamentet për të arritur objektivat e tyre, siç është Transparency International, që përqendrohet në masat kundër korruptionit, dhe Nisma e Transparencës së Industrive Nxjerrëse që përqendrohet në promovimin e transparencës dhe mbikëqyrjen më të mirë të industrive nxjerrëse.
- **Partnerët zhvillimorë:** Disa vende ofrojnë fonde për parlamentet përmes projekteve dypalëshe për ndërtimin e kapaciteteve dhe në infrastrukturë. Këto përfshijnë Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Departamentin e Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID), Agjencinë Suedze për Zhvillim Ndërkombëtar për Bashkëpunim (SIDA) dhe Agjencinë Koreane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (KOICA). Vende të tjera, si Kuvajti, administrojnë fondet e pasurisë sovrane që përdoren për të mbështetur projekte specifike me parlamentet.

Pyetje për reflektim

- A janë iniciuar diskutime për zbatimin e OZHQ-ve në asambletë parlamentare, asociacione dhe rrjete të lidhura me parlamentin tuaj?
- Cilat projekte shumëpalëshe dhe dypalëshe po mbështesin punën e parlamentit tuaj?
- A duhet që përpjekjet e këtyre rrjeteve dhe projekteve të fokusohen në mënyrë më specifike në OZHQ-të?
- Si kontribuojnë parlamentarët në vardin tuaj për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut? Për shembull, a përfshihen ata në raportimin e vendit tuaj në Shqyrtimin Periodik Universal dhe organet e traktateve për të drejtat e njeriut?

⁷ Shih, për shembull, Këshilli i të Drejtave të Njeriut 26/29, Kontributi i parlamenteve në punën e Këshillit për të Drejtat e Njeriut dhe shqyrtimin e tij periodik universal.

IV. Ligjvënia: Forcimi i mjedisit mundësues për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

FUNKSIONET KYÇË TË PARLAMENTEVË	Zbatimi i OZHQ-ve do t'u kërkojë vendeve të përdorin një gamë të gjerë të qasjeve të politikave dhe programeve. Teksa legjislacioni rrallë është përgjigja e plotë e politikave të nevojshme për të trajtuar një problem, shpesh është një hap i parë kritik për të siguruar një mjesid të përshtatshëm për veprim. Përveç kësaj, duke pranuar se buxheti vjetor i shtetit është gjithashtu i miratuar si ligj i parlamentit, funksioni ligjvënës i parlamenteve merr tjetër rëndësi kritike në drejtim të sigurimit se fondet janë drejtar në mënyrë efektive drejt adresimit të prioriteteve më të rëndësishme kombëtare të OZHQ-ve.
LIGJVËNIA <p>Ky është procesi me të cilin parlamenti shqyrton projektligjet dhe në fund miraton formën e tyre përfundimtare. Pothuajse të gjitha parlamentet kanë një rol të rëndësishëm në shqyrtimin e projektligjeve para se të miratojen, duke përfshirë mundësinë për të rekomanduar ndryshime në projektligje. Disa parlamente janë më aktive në hartimin e projektligjeve para se të debatahen në seancë. Të tjerët mbështeten pothuajse ekskuluzivisht tek qeveria për të zhvilluar, hartuar dhe parashtruar lige për debat. Shpesh zbatohen rregulla të veçanta për legjislacionin që përban buxhetin vjetor të shtetit - që zakonisht konsiderohet si një nga ligjet</p>	<h2>A. Identifikimi i prioriteteve të reformës ligjore</h2> <p>Shumë nga targetet e OZHQ-ve do të kërkojnë reforma ligjore për të mundësuar arritjen e tyre. Një mësim i nxjerrë nga zbatimi i OZHM-ve është nevoja për një qasje sistematike për t'u mundësuar parlamentarëve që të ndërmarrin reforma gjithëpërfshirëse ligjore që sigurojnë zbatimin e prioriteteve kombëtare të zhvillimit.</p> <p>Tunizi: Mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e mjesidit</p> <p>Kushtetuta kombëtare ofron mbrojtjen më të fortë ligjore për një të drejtë dhe është një nga aktet më kritike ligjvënëse që ndërmerren nga një vend. Edhe pse reforma kushtetuese nuk është një aspekt i përditshëm i punës së parlamentarëve, në shumë sisteme ligjore ndryshimet kushtetuese miratojen nga parlamentarët dhe mund të jenë një mjet i dobishëm për forcimin e prioriteteve të zhvillimit në ligjin bazik të vendit.</p> <p>Për shembull, në janar 2014, në Tunizi, ligjvënësit miratuan një kushtetutë të re, në vazhdën e revolucionit të vitit 2011, dhe vendosën dispozita të forta në mbështetje të mjesidit dhe për adresimin e ndryshimeve klimatike, për të garantuar që këto çështje kritike të integrohen në priorititetet e çdo qeverie të mëvonshme.</p> <p>Kushtetuta e re e bëri Tunizinë vendin e parë arab - dhe vetëm vendin e tretë në botë - që përfshin një angazhim të quartë kushtetues për ruajtjen e mjesidit dhe një klime të sigurt. Kjo dispozitë u përfshi në kushtetutën e re pas një lobimi të konsiderueshëm nga një grup parlamentarësh - me mbështetjen e një OJQ-je të quajtur Parlamenti i Klimës, duke punuar në partneritet me UNDP-në - të cilët u angazhuan në lobim aktiv për reforma ligjore dhe të politikave në mbështetje të çështjeve mjesidore. Klauzola e re e klimës e detyron shtetin të garantojë "një klimë të shëndoshë dhe të drejtën për një mjesid të shëndoshë dhe të balancuar" dhe "të sigurojë mjetet e nevojshme për të eliminuar ndotjen e mjesidit".</p>

Më pas, i njëjtë grup parlamentarësh lobi me qeverinë për një ligj të ri të energjisë së ripërtërishme. Ky ligj përfundimisht u hartua nga Ministria e Energjetikës dhe përcaktoi targetet kombëtare për burimet e ripërtërishme, si dhe krijoj një Fondi të Tranzicionit Energjetik për të ndihmuar në financimin e projekteve të energjisë së ripërtërishme përmes rishpërndarjes së subvacioneve për lëndë djegëse fosile. Pas ndihmës për hartimin e ligjit të ri, grupei i parlamentarëve udhëhoqi fushatën për ta kaluar në parlament; ligji u miratua në prill 2015.

Në fillim të zbatimit të OZHQ-ve, mund të merret parasysh ndërmarrja e një Vlerësimi të Nevojave për Reformën Ligjore të OZHQ-ve, i cili mund të përdoret për të shqyrtuar të gjitha OZHQ-të dhe targetet e tyre. Kjo duhet të bëhet që: (i) të identifikohen cilat targete kërkojnë ligje ose amendamente të reja; (ii) t'u jepet përparësi atyre nevojave dhe ndryshimeve të reformës ligjore; dhe (iii) të krijohet një agjendë afatmesme deri afatgjatë e reformës legislative që do të udhëheqë hartimin dhe miratimin e ligjeve. Kjo gjithashtu mund të jetë e dobishme për nxitjen e koordinimit më të mirë të reformës ligjore në mbështetje të OZHQ-ve.

Për shembull, barazia gjinore mbulohet në mënyrë specifike nga OZHQ 5, por gjithashtu ndërthuret me zbatimin të çdo OZHQ-je tjetër. Andaj, do të jetë e dobishme të vlerësohet e gjithë gama e ligjeve ekzistuese në të njëjtën kohë për të identifikuar cilat çështje mund të mbulohen nga e njëja paketë e reformës ligjore, në vend që të trajtohet secili OZHQ veç e veç dhe pastaj të miratohen ndryshime dhe ligje të veçanta.

Një shembull tjetër është OZHQ 16, targeti 16.5, i cili u bën thirrje vendeve të "zvogëlojnë ndjeshëm korruptionin dhe ryshfetin në të gjitha format e tyre", me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korruptionit që siguron një kornizë udhëzuese për zbatimin e këtij caku. Thënë kjo, trajtimi i korruptionit dhe nxitja e llogaridhënie publike është themeli i arritjes së krejt Agjendës 2030. Në mënyrë domethënëse, një element kyç i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korruptionit dhe përpjekjes më të gjerë për të luftuar korruptionin është sigurimi i reformës legislative që mundëson parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale më të efektshme të korruptionit. Shqyrtimi i përbashkët i të gjitha mangësive legislative në lidhje me korruptionin mund të jetë shumë i dobishëm për të siguruar që reformat për adresimin e korruptionit dhe ryshfetit të trajtonë të gjitha aspektet e këtyre çështjeve në një paketë gjithëpërfshirëse legislative.

Nxitja e llogaridhënie publike dhe trajtimi i korruptionit janë themelore për të gjitha OZHQ-të, të cilat janë qartësish të fokusuara në sigurimin e ofrimit të shërbimeve llogaridhënëse dhe rezultateve të zhvillimit për publikun. Thënë kjo, OZHQ 16 posaçërisht bën thirrje për qeverisje më llogaridhënëse: targeti 16.5 synon të "reduktojë ndjeshëm korruptionin dhe ryshfetin në të gjitha format e tyre"; targeti 16.6 synon të "zhvillojë institucione efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet" dhe targeti 16.10 synon të "sigurojë qasjen e publikut në informata dhe mbrojtjen e lirive themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare". Është e qartë se ligjvënësit do të kenë një rol kritik për të siguruar që mjedisi i përshtatshëm t'i adresojë me efektivitet sjelljet korruptive

B. Hartimi i legjislacionit të lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Çdo legjislaturë ka procedura të ndryshme për hartimin, parashtrimin dhe miratimin e ligjeve. Megjithatë, përgjithësisht parlamentarëve mund t'u kërkohet të angazhohen në tri lloje të projektligjeve (të përshkruara më poshtë), të cilat mund të janë mësues efektive për promovimin e reformës ligjore të lidhur me OZHQ-të.

- Projektligjet e sponsorizuara nga qeveria:** Në shumicën e sistemeve parlamentare, qeveria është përgjegjëse për hartimin e një ligji të propozuar përpara se të dërgohet në parlament për shqyrtim. Teksa qeveria ecën përpara me zbatimin e planit të saj të lokalizuar të OZHQ-ve, sigurimi i një programi të koordinuar të reformës legislative në lidhje me OZHQ-në do të ketë rëndësi kritike. Për këtë qëllim, parlamentarët mund të janë proaktivë në nxitjen e qeverisë për të ndërmarrë veprime për hartimin e një ligji. Ekzistojnë shumë mekanizma, siç janë pyetjet, interpelancat, pyetjet me shkrim të ministraleve dhe propozimi i një rezolute ose një mocioni jo detyrues, i cili mund të tërheqë vëmendjen ndaj çështjeve me interes publik.

Hetimet e Komisionit mund të jenë gjithashtu të dobishme dhe mund të sjellin përfitimin e shtuar të integrimit të konsultimeve publike për çështjet dhe t'u mundësojnë parlamentarëve të jepin rekomandime konkrete për qeverinë për çështjet që kërkojnë reforma ligjore dhe mënyrat si duhen trajtuar.

- **Projektligjet e parashtruara nga deputetët:** Në shumë sisteme presidenciale me ndarje të pushteteve, dhe në sistemet parlamentare që janë gjysmë-presidenciale, anëtarët e një kongresi ose parlamenti shpesht mund të hartojnë dhe prezantojnë ligjet e propozuara. Në varësi të rregullores së punës, mund të jetë e vështirë që projektligje të tilla të pranohen për shqyrtim. Megjithatë, ato ende mund të jenë një mënyrë e dobishme për të ushtruar presion mbi qeverinë për të ndërmarrë veprime legjislativë përfshirë adresuar çështjet e OZHQ-ve, duke u dhënë mundësi parlamentarëve të tjerëqin vëmendjen në çështje të veçanta zhvillimore.
- **Iniciativa ligjore të nisura nga qytetarët:** Në disa raste, vetë qytetarët dhe/ose grupet e shoqërisë civile mund të marrin iniciativën për hartimin e legislacionit, e më pas u kërkojnë parlamentarëve individualë që të marrin dhe ta dorëzojnë përfshirë shqyrtim nga parlamenti (shih pjesën VII më poshtë).⁸ Edhe pse më rrallë, në disa sisteme mund të jetë e mundur madje që qytetarët të bëjnë thirrje për "referendumin e qytetarëve" përfshirë një çështje; nëse fitojnë, referendumët mund të përdoren përfshirë miratuar ose ndryshuar ligjet.

Liban dhe Marok: Ligjvenia përfshirë një kornizë ligjore më të fortë kundër korruptionit

Parlamenti libanez ka qenë aktiv në udhëheqjen e një shtytjeje përfshirë vendosur një kornizë më të fortë kombëtare kundër korruptionit që përputhet me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korruptionit. Në vitin 2012, parlamenti ngriu një nënkomision kundër korruptionit që kishte përdorë të punonë përfshirë projektligje të veçanta të lidhura me korruptionin. Nënkomisioni punoi në partneritet me Parlamentarët Libanezë kundër Korruptionit dhe me mbështetjen e UNDP-së. Nënkomisionet punuan në katër projektligje. I pari ishte amendamentimi i ligjeve që adresojnë pasurimin e paligjshëm dhe deklarimin e pasurive, zhvilluar nga nënkomisioni në bashkëpunim me një grup punues me shumë palë të interesit, të përbërë nga përfaqësues të Ministrive të Drejtësisë, Drejtësisë Administrative, të Brendshme dhe të Financave, Bankës Qendrore dhe organeve të tjera kritike rregullatore, si dhe të UNDP-së. Nënkomisioni ka punuar nga afër edhe me Rrjetin Kombëtar përfshirë Drejtësinë e Qasjes në Informata, një grup avokimi me shumë palë të interesit dhe i kryesuar nga një parlamentar libanez, përfshirë hartuar ligje përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve, të drejtë përfshirë qasje në informata dhe ngritjen e një Agjencie kundër Korruptionit.

Në Marok, vendi lansoi një strategji të re kombëtare kundër korruptionit në vitin 2015 dhe parlamenti tanë po punon përfshirë paraqitur ligje me rëndësi kritike përfshirë forcuar mjedisin mundësues përfshirë luftuar korruptionin. Një ligj i ri përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve, Ligji përfshirë Lirinë e Informacionit dhe Ligji përfshirë Konfliktin e Interesit janë të gjitha në proces legjislativ dhe do t'u jepin parlamentarëve mundësinë të arrijnë progres në OZHQ 16.5 duke miratuar ligje të fortë përfshirë llogaridhënieve dhe duke monitoruar zbatimin e tyre.

Shih: www.transparency-lebanon.org/En/WhatWeDoDetails/5/12/0.

⁸ Shih Iniciativën Qytetare të Finlandës:

<https://www.eduskunta.fi/EN/lakiensaataminen/kansalaistoite/Pages/default.aspx>.



UNDP në Tunizi
Debatet e Kushtetutës Tuniziane, 20 janar 2014. Foto: Olivier Pierre-Louveaux.

Idealisht, projektligjet e propozuara që kanë të bëjnë me çështjet që lidhen me zhvillimin do të identifikojnë në mënyrë eksplikite nëse si e mbështesin Agjendën 2030 dhe OZHQ-të specifike me targetet e tyre. Kjo mund të përfshihet në memorandumin shpjegues të projektligjit dhe në fjalimin e prezantimit të projektligjit. Sidoqoftë, aktualisht kjo nuk është praktikë e zakonshme. Për ta adresuar këtë, vetë parlamentet mund të dëshirojnë të bëjnë një Analizë të Ndigjimit të OZHQ-ve nga sekretariatet e tyre parlamentare për të identifikuar si ndikon projektligji i propozuar në arritjen e OZHQ-ve. Në mënyrë alternative, mund të ndryshohet rregullorja e punës për të kerkuar që sponsori i ligjit të parashtrojë një analizë të tillë kur të paraqitet projektligji. Disa vende tashmë kryejnë vlerësimë të ndikimeve socio-ekonomike, mjedisore dhe gjinore të projektligjeve. Mësimet e nxjerra tregojnë se një proces i tillë mund të sistematizohet përmes miratimit të një liste të thjeshtë kontrolluese, e cila pastaj mund të zbatohet nga sekretariati parlamentar për secilin projektligj të parashtruar për shqyrtim. Parlamentarët pastaj mund ta përdorin këtë informacion për të identifikuar fushat për ndryshime.

Pyetje për reflektim

- A kanë parlamentarët metoda të mjaftueshme ligjore dhe proceduriale dhe kapacitete legjislative për të iniciuar, konsideruar dhe ndryshuar legjislacionin për të mbështetur OZHQ-të?
- A ka ndërmarrë qeveria ose parlamenti (ose a planifikojnë të ndërmarrin) një shqyrtim të reformave ligjore që kërkohen për zbatimin e OZHQ-ve, të cilat mund të informojnë agjendën legjislative të parlamentit gjatë muajve dhe viteve të ardhshme?
- A duhet që memorandumi shpjegues i bashkëngjitur çdo projektligji të japë një shpjegim nëse dhe si kontribuon projektligji në arritjen e OZHQ-ve?
- A kërkon Rregullorja e Punës së parlamentit që komisionet parlamentare të konsiderojnë të gjitha projektligjet për të vlerësuar kontributin e tyre në arritjen e OZHQ-ve? A ndodh kjo në praktikë?

V. Buxhetimi për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

FUNKSIONET KYÇE TË PARLAMENTEVË

BUXHETIM

Mbikëqyrja e buxhetit është procesi me të cilin parlamenti përpjeket të sigurojë, përgjatë ciklit të buxhetit kombëtar, se qeveria i shpenzon paratë në mënyrë të ligjshme dhe të përshtatshme. Këtë mund ta bëjë duke dhënë rekomandime për formulimin e buxhetit; duke shqyrtuar, debatuar dhe miratuar buxhetin e shtetit; duke mbikëqyrur zbatimin e tij; dhe duke audituar llogaritë, të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisë

Që OZHQ-të të zbatohen në mënyrë efektive, do të jetë kritik e që zbatimi i tyre të financohet në mënyrë të duhur, dhe që financimi të jetë i shënjestruar, për të siguruar që përpjekjet të arrijnë më të marginalizuarit dhe të ceneseshmit. Forma të ndryshme të financimit do të paguajnë për zbatimin e OZHQ-ve. Kjo për fshin fondet e sektorit privat, fondet nga organizatat bamirëse, NZZH-në, investimet e huaja direkte dhe të ardhurat e krijuara nga shteti, siç janë tatimet dhe të ardhurat doganore. Parlamentarët duhet të jenë të vetëdijshëm për këto forma të financimit dhe duhet të formojnë një pikëpamje nëse burimet e ndryshme të të ardhurave janë të koordinuara mirë për të shhangur dyfishimet dhe mbivendosjet.

Ligji vjetor i buxhetit të shtetit është instrumenti i financimit primar që çdo vend duhet ta përdorë për të dërejta burimet drejt zbatimit të OZHQ-ve. Si e tillë, është thelbësore që përzierja e ligjvënieve dhe shqyrtimit që përbën proceset parlamentare të buxhetit të dizajnohet dhe zbatohet në mënyrën më efektive për t'u mundësuar parlamentarëve të angazhohen në procesin e formulimit dhe miratimit të buxhetit. Pyetja themelore që duhet marrë parasysh është nëse proceset buxhetore sigurojnë që buxheti të sjellë rezultate në kuadrin e OZHQ-ve, duke pasur parasysh objektivin kryesor të sigurimit se përpjekjet janë "të përqendruara tek qytetarët" dhe se askush - sidomos nga grupet e marginalizuara dhe të ceneseshme - nuk është lënë prapa.

QASJA E CIKLIT TË BUXHETIT

Parlamentet mund të mbledhin informata dhe opiniione nga grupet e interesit, duke i paraqitur dokumente rekomandimeshnë ndihmë të ekzekutivit gjatë hartimit të buxhetit



Empowered lives.
Resilient nations.

Ekzekutivi paraqet propozimin e vet të buxhetit në parlament, i cili ia referon konsiderimin e propozimit komisioneve të specializuara të legjislativit, shpesh me koordinimin e komisionit përfinanci. Pas shqyrtimit dhe ndryshimeve të mundshme, buxheti paraqitet në seancë plenare për miratim

Parlamenti, bashkë me Autoritetin Suprem të Auditimit, auditon të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisë përvit paraprak, duke identifikuar dobësitë dhe duke rekomanduar ndryshimet në praktikë. Nëse është e përshtatshme certifikon llogaritë e vitit paraprak, duke siguruar vlerat bazë për llogaritë e vitit pasardhës.

Auditimi i buxhetit

Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit

Mbikëqyrja e zbatimit të buxhetit

Changes in state it certifies year's account, providing base for the next year's accounts.

ex minis missions. does not exec this is the government

Parlamenti dhe komisionet e përhershme monitorojnë ekzekutimin e buxhetit, duke përfshirë edhe pyetjet përmirratat dhe misionet e vëzhgimit. Parlamenti nuk e ekzekuton buxhetin. Kjo është puna e qeverisë

A. Buxheti vjetor i shtetit

Procesi i miratimit të buxhetit kombëtar duhet të jetë një cikël i vazhdueshëm vjetor që përfshin degën ekzekutive dhe legjislativin në vlerësimin e shpenzimeve dhe të ardhurave, zbatimin e fondeve në dispozicion për programet prioritare dhe monitorimin e zbatimit dhe shpenzimeve. Siç tregon grafiku i ciklit buxhetor më lart, ndonëse dega ekzekutive është formalisht përgjegjëse për zhvillimin e buxhetit, parlamentarët megjithatë mund të luajnë një rol në avokimin e prioriteteve buxhetore përparrë (dhe nganjëherë edhe gjatë) procesit të përgatitjes së buxhetit. Në disa vende, ata madje mund të përdorin fuqinë e tyre ligjvénëse dhe të mbikëqyrjes për të propozuar ndryshime formale të buxhetit pasi të jetë paraqitur në parlament.

Shumica e parlamenteve kanë një formë të vlerësimeve buxhetore të de dikuara ose proceseve të shqyrtimit nga komisioni, të cilat kanë për qëllim lehtësimin e shqyrtimit të buxhetit të propozuar. Kjo përfshin mbajtjen e dëgjimeve publike me zyrtarë të qeverisë për të hyrë në detajet e propozimeve të buxhetit dhe për të kuptu ar më mirë se çfarë synon të ofrojë buxheti. Në disa vende, në këtë proces mund të përfshihet edhe shoqëria civile, duke marrë pjesë në seancat dëgjimore për të siguruar reagime mbi efektivitetin e ofrimit të programeve qeveritare dhe/ose mësimet e nxjerra në lidhje me rrjedhjet e shpenzimeve ose dështimin për të arritur tek përfituesit. Joformalisht, parlamentarët mund të mbështeten në analizën e buxhetit të shoqërisë civile ose të angazhohen më drejtpërdrejt me zgjedhësit e tyre për të identifikuar cilat programe të qeverisë kanë funksionuar dhe cilat nuk kanë arritur të japid përfitime për qytetarët në nevojë.

Përveç kësaj, përcjellja me agjencitë qeveritare dhe ministritë në lidhje me rekondimet e raporteve të auditimit shtetëror mund të informojë në mënyrë të dobishme kontributin e parlamentarëve gjatë gjithë ciklit të buxhetit. Në disa parlamente kjo bëhet në mënyrë sistematike përmes proceseve të komisioneve, nën drejtimin e komisionit të llogarive publike dhe me pjesëmarrjen e komisioneve sektoriale.

Bangladesh: Buxhetimi në mbështetje të energjisë së ripërtërishme

Në Bangladesh, rreth 72 për qind e popullsisë jeton në zonat rurale dhe më shumë se dy të tretat e familjeve nuk kanë qasje në energji elektrike. Qeveria e Bangladeshit është zotuar të sigurojë energji elektrike për të gjithë deri në vitin 2020, por aktualisht shumica e furnizimit energetik në Bangladesh buron nga importet e gazit natyror dhe karburantit, dhe shumica e kapacitetit të ri energetik të vendit është planifikuar me impiantet e thëngjillit. Megjithatë, Bangladeshi ka bërë hapa të mëdhenj me krijimin e një plani afatgjatë për financimin e energjisë së ripërtërishme. Në qershor 2014, qeveria e Bangladeshit njoftoi dy dispozita kyçe buxhetore për avancimin e energjisë së ripërtërishme në vend: (i) një ndarje buxhetore prej 15 milionë Taka (190,000 dollarë amerikanë) për të financuar një Autoritet të ri të Zhvillimit të Energjisë së Qëndrueshme dhe të Ripërtërishme (SREDA); dhe (ii) krijimin e një Fondi të Energjisë së Ripërtërishme prej 400 milion Taka (51.65 milion dollarë).

Këto rezultate konkrete buxhetore në mbështetje të OZHQ 7 (energjia e ripërtërishme) ishin rezultat i një fushatë gjatë nga parlamentarët. Në shtator 2012, parlamentarët e partive të ndryshme politike fo rruan një Grup lokal të Parlamentit të Klimës, me mbështetjen e OJQ-së Parlamenti i Klimës dhe në partneritet me UNDP -në. Këta parlamentarë u dakorduan për një sërë prioritetesh, duke përfshirë lobimin përritjen e kontributeve të energjisë së ripërtërishme për prodhimin e energjisë elektrike dhe krijimin e një mjedisit politik, financiar dhe teknologjik që nxit përdorimin e burimeve të ripërtërishme.

Në nëntor të vitit 2012, Grupi i deputetëve të Parlamentit të Klimës luajti një rol të rëndësishëm në miratimin e ligjit për SREDA-n, një iniciativë rrugë-hapëse që themeloi SREDA-n e re si pikë fokus kombëtare për promovimin dhe zhvillimin e energjisë së qëndrueshme.

Në nëntor 2013, grupi lokal i deputetëve të Parlamentit të Klimës filloj me përkushtim avokimin buxhetor. Parlamentarët u takuan dhe dorëzuan një memorandum shumëpalësh për ministrat kyç, duke kërkuar mbështetjen e duhur buxhetore dhe nga burime të tjera për SREDA-n, si dhe krijimin e një fondi të energjisë së pastër. Ky avokim zgjati gjashtë muajt e ardhshëm, deri në hartimin e buxhetit, me grupin e deputetëve të Parlamentit të Klimës që u takuan në mënyrë të përsëritur me Ministrat e Pushtetit dhe Financave. Përmes avokimit të tyre të qëndrueshëm, duke përfshirë ndërhyrjet e llogaritura mirë në kohë gjatë proceseve të përgatitjes së buxhetit, grupi i deputetëve të Parlamentit të Klimës siguroi rezultatet e përshkruara në paragrafin e parë, më lart.

Shih: "Deputetët e Parlamentit të Klimës janë të suksesshëm në krijimin e një fondi të posaçë më dëshmi i parlamentit për të bërë ndryshime të mëdha në buxhetin e propozuar. Në shumë vende, dëshimi i parlamentit për të miratuar ligjin e buxhetit siç është propozuar mund të çojë në rënien e qeverisë. Në të tjera, parlamenti mund të zvogëlojë ndarjen e buxhetit të propozuar përmes një ndryshimi në projektligjin e buxhetit, por nuk mund të votojë për të rritur shpenzimet. Në vendet e tjera, parlamenti ka më shumë hapësirë për të transferuar fonde nëpër vija buxhetore, pa kaluar tavanin e përgjithshëm të buxhetit; por edhe kjo zakonisht udhëhiqet nga rregulla të rrepta për ndryshimet.

Përtej përfshirjes së parlamentarëve në proceset e përsëritura të përgatitjes dhe aprovim it të buxhetit, parlamentarët mund të mbështesin - përmes avokimit dhe krijimit të mjedisi mundësues legjislativ - reforma buxhetore që lehtësojnë realizimin e OZHQ-ve. Zbatimi i OZHQ-ve kërkon qasje që përfshijnë të gjithë spektrin e qeverisjes. Andaj, pa parlamentarët mund të mbështesin mënyrat inovative që buxheti të mundësojë forma të ndryshme të punës së mbarë qeverisë.

Analizat e hollësishme financiare dhe të kostove e ofruar në mbështetje të një buxheti kombëtar ndryshojnë sipas juridiksioneve. Në disa vende, ofrohet vetëm informacion mjaft minimal për të shpjeguar ndikimin e masave të propozuara buxhetore. Në fillim të zbatimit të Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve, mund të merret parasysh shqyrtimi i dokumentacionit aktual buxhetor që i është dhënë parlamentit për të vlerësuar përshtatshmërinë e tij në drejtim të dhënies së udhëzimeve si është hartuar buxheti për të pasur progres në arritjen e OZHQ-ve. Parlamentarët, veçanërisht anëtarët e komisionit parlamentar për buxhet dhe financa, duhet të punojnë në mënyrë që përgatitjet së përfshirë me ministritë e financave për të rënë dakord për një format të lidhur me OZHQ-të për dokumentacionin e buxhetit.

Ruanda: Nxjita e mbikëqyrjes parlamentare të NZZH-së

Në Ruandë, gjatë dekadës së fundit parlamenti ka bërë ndryshime në procesi i buxhetit për të siguruar që ofrohen informata më kuptimplota të buxhetit kur qeveria e dorëzon projektligjin e saj të financimit në parlament. Ligji i financave tashmë ofron një tablo të integruar mbi shpenzimet e organzuara sipas programeve, dhe jo sipas institucioneve qeveritare.

Që nga viti 2008, Parlamenti i Ruandës ka kërkuar gjithashtu që të sigurohen më shumë informacione kontekstuale bashkë me buxhetin, veçanërisht mbi mënyrat e ndryshme në të cilat buxheti ndikon tek burrat dhe gratë, edhe pse ky informacion përfshihet vetëm në dokumentacionin plotësues. Qeveria gjithashtu ka përpiluar një listë të konsoliduar të llogarive kombëtare që përfshin të gjitha ndihmat që ka marrë sektori qeveritar në vitin 2007, qoftë të administruara nga qeveria, donatorët apo palët e treta; kjo eksposzoi nën -raportimin e ndihmës për buxhetin, si dhe mospërputhjet me bazat e të dhënave të ndihmës. Ushtrimi i mundësor qeverisë që ta shqyrtojë më nga afër integrimin e ndihmës në ciklin e buxhetit, përtë gjitha llojet e ndihmës për sektorin qeveritar, qoftë e administruar përmes sistemeve qeveritare apo jo.

Burimi: Balch, J. dhe Heim, K. (pa datë). Varfëria e mbikëqyrjes parlamentare të NZZH -së, f. 12-13, http://paperroom.ipso.org/papers/paper_2894.pdf.

Është gjithashtu e rëndësishme që dokumentet e buxhetit të përfshijnë jo vetëm të ardhurat e brendshme të mbledhura, por edhe kontributet e bëra përmes NZZH-së dhe huatë ndërkombëtare. Në disa vende që marrin NZZH, këto para mbahen 'jashtë buxhetit', ose në një buxhet të veçantë për zhvillim. Megjithatë, është me rëndësi që NZZH të integrohet në buxhetin kombëtar në mënyrë që parlamentarët të mund të vlerësojnë sít duhet buxhetin e përgjithshëm të ndarë për priorititetet e zhvillimit kombëtar dhe të shqyrtojnë llogaridhëni e duhur për të gjithë buxhetin, duke përfshirë NZZH -në. Përndryshe, ekziston rreziku që në disa se ktorë NZZH-ja të çojë në buxhete të paqëndrueshme, ndërkohë që sektorët e tjera mbeten të nën-financuar. Përveç kësaj, është më e vështirë që të vërtetohet llogaridhënia publike për shpenzimet e NZZH -së nëse ato nuk janë të përfshira në buxhet.

Roli i parlamenteve të vendeve partnere në përmirësimin e efektivitetit të flukseve të ndihmave u deklarua qartë në Deklaratën e Parisit të vitit 2005, e cila në mënyrë eksplikite rekomandon që: (i) vendet partnere angazhohen të forcojnë rolin e parlamenteve të tyre në zhvillimin e strategjive dhe buxheteve; dhe (ii) vendet donatore angazhohen të japid informacionin në kohë, transparent dhe gjithëpërfshirës për t'u mundësuar degëve të ekzekutivit të vendeve partnere që të sigurojnë raporte të plota buxhetore për qyteta rët dhe legjislaturat e tyre. Përkundër kësaj, përpjekjet për ta futur NZZH-në në buxhetin zyrtar kanë qenë të ndryshueshme, edhe pse ekzistojnë disa shembuj të mirë të mbikëqyrjes së buxhetit të NZZH-së.

Pyetje për reflektim

- A përfshin buxheti i par aqitur për shqyrtim dhe miratim në parlament një shpjegimi adekuat si synojnë masat buxhetore të bëjnë progres në arritjen e OZHQ-ve? Nëse jo, cilat informata mund të shtohen për të siguruar një panoramë më të mirë për parlamentarët?
- A kërkon Rregullorja e Punës që komisionet përgjegjëse për vlerësimin e buxhetit të propozuar: (i) të vlerësojnë nëse dhe si kontribuon buxheti i propozuar në arritjen e OZHQ-ve; dhe (ii) të japid rekomandime për forcimin e buxhetit për të kontribuar më efektivisht në arritjen e OZHQ-ve?
- A kërkojnë Rregullorja e Punës ose konventat ose praktikat e tjera që qeveria të shqyrtojë këshillat dhe rekomandimet e komisioneve parlamentare dhe të japë një shpjegim në parlament për përgjigjen e tyre ndaj këtyre rekomandimeve? A ka ndonjë proces në dispozicion për të kërkuar një përgjigje nga qeveria për këshillat dhe rekomandimet buxhetore të parlamentit?

B. Mbikëqyrja e buxheteve dhe shpenzimeve për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Një nga rolet më kritike për parlamentarët është që konfirmojnë se fondet e ndara përritjen e OZHQ-ve shpenzohen në mënyrë efektive dhe llogaridhënëse, çka prodhon rezultate të qëndrueshme dhe të efektshme. Kjo përpunhet me agjendën e efektivitetit të zhvillimit (siç është diskutuar në pjesën II), sepse objektivi i përgjithshëm është sigurohet që si paratë e brendshme ashtu edhe fondet ndërkombëtare të shpenzohen në mënyrën më efektive të mundshme. Efektiviteti i zhvillimit shqyrtion çështjet e vlerës së parave dhe të rezultateve aktuale për qytetarët, veçanërisht më të margjinalizuarit dhe të cenueshmit.⁹

Në shumicën e parlamenteve, mbikëqyrja e buxhetit ndërmerret nga komisione të specializuara parlamentare të mandatuara me shqyrtimin e shpenzimeve të qeverisë në fund të ciklit buxhetor. Megjithëse këto komisione luajnë një rol kritik si pjesë e kornizës së brendshme të llogaridhënieve të çdo vendi, ato shpesh kanë mungesë të burimeve, fonde të kufizuara për të kryer seanca dëgjimore dhe aktivitete të monitorimit në terren, si dhe kapacitete të kufizuara të anëtarëve të personelit për t'i ndihmuar në analizë dhe raportim.

Në disa vende, janë bërë përpjekje për të krijuar një formë të zyrës së pavarur buxhetore parlamentare, ose të paktën një njësie buxhetore brenda sekretariatit parlamentar, për të mundësuar një mbështetje më cilësore për këtë detyrë vitale. Njësitë e tillë duhet të jenë të pajisura me specialistë të buxhetit dhe financave, të cilët mund t'u ofrojnë parlamentarëve këshilla dhe analiza të ekspertëve ekonomikë dhe financiarë.

Marok dhe Jordani: Mbështetja e analizës parlamentare të buxhetit

Në rajonin arab ka disa praktika të mira të parlamentarëve që kanë qasje në përkrahje nga njësitë e dedikuara buxhetore.

Në Marok, Byroja e Analizës së Buxhetit mbështet të dyja dhomat e parlamentit të Marokut. Byroja ka zgjeruar rolin e legjislativit në vlerësimin dhe ekzekutimin e buxhetit kombëtar, duke prodhuar dokumente të analizës buxhetore që u jepin mundësi parlamentarëve ta kuptojnë më mirë buxhetin dhe sigurojnë analiza më efektive. Byroja raporton në organin vendimmarrës të Dhomës, ku përfaqësohen të gjitha grupet politike, dhe në komisionin e buxhetit. Byroja ka mandat të analizojë buxhetin kombëtar dhe të vlerësojë ekzekutimin e tij, të vlerësojë politikën e degës së ekzekutivit përmes menaxhimin e borxhit publik, të analizojë ndikimin financiar të legjisacionit dhe të ndërmarrë hulumtime rreth përfshirjes së parlamentit në procesin e buxhetit. Përfshirja e parlamentit në ciklin e buxhetit tit u zgjat kohët e fundit nga 70 ditë në gjashtë muaj. Byroja u përgjigjet kërkeseve të parlamentarëve dhe është pikë reference përmes ato që hartojnë legjisacionin, duke përfshirë ndryshimet në buxhetin kombëtar. Të dyja komisionet e buxhetit në parlamentin me dy dhoma përdorin produktet e Byrosë të Analizës së Buxhetit.

Në Jordani, Zyra Parlamentare e Buxhetit raporton kryesisht tek Komisioni për Financa dhe Ekonomi. Puna e saj përfshin raporte të analizës së buxhetit dhe lista të pyetjeve për secilin segment të buxhetit (të përdorura nga Komisioni për Financa dhe Ekonomi). Zyra Parlamentare e Buxhetit gjithashtu ofron raporte që analizojnë performancën e qeverisë bazuar në të dhënat e buxhetit, të cilat përdoren nga të gjithë parlamentarët e interesuar. Komisionet e tjera ende nuk e kanë shfrytëzuar plotësisht Zyrën Parlamentare të Buxhetit. Aktivitetet e përditshme përfshijnë analizimin e lajmeve ekonomike, zhvillimin e treguesve makroekonomikë, trajnimin e anëtarëve të personelit parlamentar, përgjigje ndaj pyetjeve të parlamentarëve dhe përgatitjen e raporteve mbi performancën fiskale dhe monetare të qeverisë.

⁹ [9 http://www.awepa.org/wp-content/uploads/2013/06/Safeguarding-the-Interests-of-the-People-Parliamentarians-and-Aid-Effectiveness.pdf](http://www.awepa.org/wp-content/uploads/2013/06/Safeguarding-the-Interests-of-the-People-Parliamentarians-and-Aid-Effectiveness.pdf).

Burimi: Këto shembuj janë marrë nga kursi online i McGill dhe i Bankës Botërore për zhvillimin parlamentar, Njësia 5: Shembuj të Njësive të Pavarura Buxhetore, në <http://parliamentarystrengthening.org/EAP/PBO/Unit%205.pdf>.

Kur parlamenti nuk është në gjendje t'i sigurojë këto shkathtësi nga anëtarët e vet të personelit, mund t'i kushtohet vëmendje anëtarëve të personelit në institucionet e tjera të llogaridhënes. Për shembull, në disa vende, zyra kombëtare e auditimit delegon anëtarë të personelit për të mbështetur komisionin parlamentar të llogarive publike gjatë seancave të tyre vjetore. Marrëveshje të tillë mund të jenë veçanërisht të dobishme në juridikione të vogla, ku një ekspertizë e tillë është e vështirë të sigurohet. Gjithashtu, mund të merret në konsideratë shfrytëzimi i shoqërisë civile për të o fruar një analizë të tillë, ose kontraktimi i ekspertizës ekonomike nga institucionet akademike.

Në kontekstin e monitorimit të buxhetit të OZHQ-ve në mënyrë specifike, një nga sfidat kyçë me të cilat do të përballen parlamentet është nevoja për të dhënat e zbërthyera për të vlerësuar ndikimin e shpenzimeve në drejtim të arritjes së objektivave themelore të OZHQ-ve, domethënë të jenë "të përqendruara tek qytetarët" dhe veçanërisht t'i shënjestrojnë përpjekjet drejt nevojave të të marginalizuarve dhe të pë rjashtuarve. Veçanërisht, siç u diskutua më herët, edhe lokalizimi i OZHQ-ve do të jetë kritik për suksesin, dhe është e nevojshme të sigurohet që fondet dhe programet të jenë shënjestruar siç duhet tek ata që kanë më shumë nevojë. Në këtë drejtim, parlamentarët duhet të luajnë një rol kritik për të ndihmuar në mbledhjen e të dhënave mbi nevojat e zonave të tyre zgjedhore, të cilat do të shërbejnë në një procesin më të madh të planifikimit dhe zhvillimit të buxhetit kombëtar. Lehtësimi i komunikimit kthyes të dyanshëm do të jetë thelbësor për të ndihmuar në mbledhjen e informacionit direkt nga qytetarët.

Kjo mund të jetë veçanërisht e vlefshme në shumë vende ku të dhënat e buxhetit mblidhen dhe përpunohen dobët. Në fillim të zbatimit të Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve, parlamentarët, veçanërisht anëtarët e komisionit për llogari publike ose për buxhet dhe financa, mund të dëshirojnë të punojnë në mënyrë proaktive me ministrinë e financave dhe zyrën kombëtare të statistikave për të identifikuar mangësitë në mbledhjen dhe raportimin aktual të të dhënave, si dhe të punojnë për të përmirësuar mënyrën si mblidhen, zbërthehen dhe ofrohen informatat në parlament. Gjithashtu, parlamentarët mund të punojnë për të pasur qasje në informata rreth zonave të tyre zgjedhore dhe n evojave të veçanta që mund të kenë, të cilat duhet të pasqyrohen në ndarjet dhe shpenzimet buxhetore. Një mbledhje e tillë proaktive e të dhënave mund të sjellë përfitime për raportet e përgjithshme të OZHQ-ve, të cilat do të kërkohen si për të ndjekur progresin ndaj planeve kombëtare të OZHQ-ve ashtu dhe për t'u përdorur në sisteme të monitorimit global.

Një nga pjesët më sfiduese të mbikëqyrjes së buxhetit është ndjekja se ku janë shpenzuar paratë dhe çfarë ndikimi ka pasur në jetën e qytetarëve, për të mirë apo për keq. Teksa institucionet e auditimit mund të ndihmojnë në vlerësimin nëse financimi është shpenzuar në përputhje me ligjet dhe rregulloret, auditimet e performancës janë më pak të zakonshme, edhe pse parlamentet mund të dëshirojnë të marrin në konsideratë dhënen e këtyre kompetencave institucionit të tyre të auditimit shtetëror përmes reformës ligjore. Teknologjite e informacionit dhe të komunikimit po përdoren gjithnjë e më shumë për të ndihmuar në mbikëqyrjen e buxhetit dhe llogaridhënen, duke përfshirë mbështetjen për mbikëqyrjen parlamentare. Duke mbledhur dhe publikuar të dhëna financiare dhe të shpenzimeve, mjetet e reja teknologjike tashmë lejojnë që të dhënat të zbërthehen më lehtë (p.sh., sipas gjinisë, demografisë, gjeografisë) dhe t'ë shqyrtohen nga parlamentarët dhe të tjerët të interesuar në vlerësimin se ku shkojnë fondet në të vërtetë.

**Serbi: Shfrytëzimi i mjeteve novatore të monitorimit të buxhetit
për të ndjekur
shpenzimet dhe ndikimet e Objektivave të Zhvillimit të
Qëndrueshëm**

Në Serbi, Asambleja Kombëtare po punon me GOPAC Serbia dhe UNDP -në për të krijuar një portal për buxhetin dhe shpenzimet, i cili do të mundësojë monitorim më të mirë të shpenzimeve buxhetore publike. Portali bazohet në praktikën e mirë nga portali SI GA i parlamentit brazilian, një nga sistemet më të mira të informacionit publik për buxhetin, i cili lejon qasje të lehtë në bazat e të dhënavë të qeverisë për planet dhe buxhetet publike përmes një mjeti të vetëm të pyetjeve online. Komisioni i Asamblesë Popullor të Serbisë për Financa, Buxhetin e Shtetit dhe Kontrollin e Shpenzimeve Publike ka punuar në bashkëpunim të ngushtë me Administratën e Thesarit të Ministrisë së Financave për t'u dakorduar për një memorandum mirëkuptimi dhe protokollet rreth ndarjes së të dhënavë.

Përveç mbledhjes së të dhënavë të papërpunuara nga Administrata e Thesarit, Portali Serb do të ndërlidhë të dhënat e siguruara nga Administrata e Thesarit me të Institucionit të Auditimit Shtetëror, Zyrës së Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Borxhit Publik, duke integruar bazat e tyre të të dhënavë. Kombinimi i shpenzimeve të buxhetit publik, gjetjeve të auditimit dhe të dhënavë të prokurimit publik është një inovacion global në mbikëqyrjen e buxhetit. Deri në prezantimin e portalit nuk ekzistonte asnje mekanizëm sistematik për Asamblenë Kombëtare të Serbisë për të shqyrtuar shpenzimet publike. Portali i ri lejon shqyrtime dhe analiza të cilat duhet të gjenerojnë kursime, si dhe të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve publike duke identifiku ar humbjet dhe keqmenaxhimin. Një version pilot i portalit filloi të funksionoja më 1 dhjetor 2015. Në fazën e parë portali do të testohet nga Komisioni për Financa, ndërsa në dy fazat e ardhshme do të hapet për të gjithë anëtarët e parlamentit dhe publikun.

Për më shumë informacion shih:

www.rs.undp.org/content-serbia/en/home/presscenter/articles/2015/12/07/portal-for-monitoring-public-finance-a-paradigm-shift-in-parliamentary-oversight-in-serbia.html.

Pyetje për reflektim

- A i kanë komisionet për llogaritë publike ose për buxhet burimet njerëzore dhe financiare për të ndërmarrë vlerësimet e tyre të ndikimit buxhetor (p.sh., përmes vizitave monitoruese për të vlerësuar zbatimin e programeve të lidhura me OZHQ-të)?
- A u mundëson Rregullorja e Punës komisioneve për llogari publike ose për buxhet që të marrin në pyetje zyrtarët e qeverisë për të vlerësuar siç duhet: (i) efektiviteti i shpenzimeve qeveritare për çështjet e lidhura me OZHQ-të; dhe (ii) llogaridhëni përfondet e shpenzuara?
- A siguron Rregullorja e Punës përgjigje efektive nga qeveria për raportet dhe rekomandimet e nxjerra nga komisionet për mbikëqyrjen e llogari publike dhe të buxhetit?
- Çfarë burimesh mund të përdorin parlamentarët për t'i ndihmuar të analizojnë shpenzimet buxhetore dhe të vlerësojnë ndikimin e tyre? A ka ndonjë institut / institucione akademike / organizata të shoqërisë civile që mund të ndihmojnë me një analizë të tillë?

VI. Monitorimi i zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

FUNKSIONET KYÇË TË
PARLAMENTEVE

MBIKËQYRJA

Mbikëqyrja është procesi me të cilin parlamenti monitoron cilësinë e punës së qeverisë në lidhje me zbatimin e ligjit, planet dhe buxhetet zhvillimore që janë miratuar më parë nga parlamenti. Metodat e ndryshme të mbikëqyrjes do të diskutohen në detaje më vonë në këtë doracak, por këto përfshijnë hetimet e komisionit, kohën e pyetjeve dhe interpelancat.

Një nga detyrat më të rëndësishme të parlamentarëve - qoftë si anëtarë të qeverisë, opozitës apo të pavarur - është mbikëqyrja e degës ekzekutive për të siguruar llogaridhënie për realizimin efikas dhe efektiv të shpenzimeve, ligjeve dhe programeve për popullatën. Për këtë qëllim, parlamenteve zakonisht u jepet fuqia e hetimit, marrjes në pyetje dhe mbikëqyrjes. Agjenda 2030 pranon në mënyrë eksplikite se sigurimi i llogaridhënieve gjatë zbatimit të OZHQ-ve është me rëndësi kritike për të garantuar që Agjenda të jetë efektive në sigurimin e rezultateve për qytetarët. Në këtë drejtim, parlamentet luajnë një rol kritik si një nga mekanizmat më të fuqishëm të llogaridhënieve vendore. Parlamentet krijojnë mjedisin që mundëson llogaridhëni përmes nxjerrjes së ligjeve, por gjithashtu kanë përgjegjësi të drejtpërdrejta për të siguruar llogaridhënie përmes përpjekjeve të tyre mbikëqyrëse.

A. Mbikëqyrja nga Komisionet e zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm Zbatimi i Objektivave

Mbikëqyrja nga Komisionet është një nga mekanizmat më të fuqishëm në dispozicion të parlamenteve për t'u angazhuar në zbatimin e OZHQ-ve.

Mbikëqyrja nga Komisionet u jep parlamentarëve një mundësi për të vlerësuar më në thellësi nëse politikat, ligjet dhe programet në mbështetje të OZHQ-ve zbatohen në mënyrë efektive dhe, nëse jo, të jepin rekomandime si të përmirësohet zbatimi. Komisionet parlamentare zakonish t'ka kompetenca për të kërkuar informacione dhe dokumente nga organet qeveritare, për të marrë në pyetje zyrtarët qeveritarë dhe për të mbajtur seanca dhe ekzaminime (duke përfshirë vizitat në terren) për të informuar të kuptuarit e tyre për mënyrat si është duke i përmbushur qeveria detyrat e saj ndaj popullatës. Komisionet u jepin parlamentarëve mundësinë për të ndërmarrë ekzaminime të detajuara për çështjet kritike, duke ndarë më shumë kohë për çështjet individuale dhe duke angazhuar një pjesëmarrje të gjerë të palëve të interesit në diskutimet e tyre. Në këtë drejtim, parlamentarët mund të luajnë një rol esencial si një lidhje mes shtetit dhe popullit, duke përfshirë edhe më të marginalizuarit dhe të cenueshmit. Idealisht, komisionet e konsiderojnë anët gazhimin publik si pjesë thelbësore të funksioneve të tyre. Kur komisionet angazhohen në mënyrë proaktive në monitorim dhe mbikëqyrje, ato mund të janë një nga mekanizmat më të fuqishëm të llogaridhënieve vendore që sigurojnë se zbatimi i OZHQ-ve mbetet në rrugën e duhur.

Ka pasur debate të konsiderueshme në lidhje me mënyrën më të mirë të përdorimit të sistemit të komisioneve për të mbikëqyrur efektivisht zbatimin, së pari të OZHM-ve dhe tanë të OZHQ-ve. Në fillim të zbatimit të OZHM-ve, kishte shumë entuziazëm për idenë e krijimit të një komisionit të vetëm të përkushtuar parlamentar të OZHM-ve, me përgjegjësinë e përgjithshme për mbikëqyrjen e zbatimit të OZHM-ve. Duke qenë se OZHM-të kanë ndikuar në kaq shumë aspekte të jetës së përditshme, kurse OZHQ-të janë edhe më të gjera në aplikimin e tyre, një shqetësim për qasjen me komision të vetëm është se mund të çojë në një dyfishim të punës ndërmjet tij dhe komisioneve të zakonshme parlamentare.

Fixhi dhe India: Zbatimi i barazisë gjinore përmes mekanizmave parlamentare të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore

Në Fixhi, Rregullorja e Punës së parlamentit e ka integruar barazinë gjinore në punën e komisioneve parlamentare, duke pranuar që të gjitha komisionet e përherershme kanë një rol të rëndësishëm në sigurimin e trajtimit të çështjeve gjinore. Rregulli 110(1) rendit autoritetin e secilit komision për shqyrtimin e projektligjeve, kryerjen e hetimeve mbikëqyrëse dhe funksioneve të tjera kyçe. Rregulli 110(2) ka paraparë që: "Kur një komision kryen një aktivitet të renditur në klauzolën (1), komisioni do të sigurojë që do t'i kushtohet vëmendje e plotë parimit të barazisë gjinore, në mënyrë që të sigurohet që të gjitha çështjet të konsiderohen në lidhje me ndikimin dhe përfitimin si përburrat ashtu edhe përgatitësi." Kjo klauzolë ka çuar tashmë në një ndryshim në mënyrën si funksionojnë komisionet parlamentare në Fixhi. Në vitin 2015, Komisioni për Burime Natyrore zhvilloi seanca dëgjimore dhe përgatiti një raport përkrijimin e një parkut të r. Për të qenë në pajtueshmëri me Regullin 110 (2), dhe në mënyrë që të dëgjohen zërat e grave, Komisioni ftoi disa organizata të shoqërisë civile që punojnë me gratë përfundimisht të bëjnë prezantime mbi këtë temë dhe përfundimisht e tyre mbi ndikimin e zhvillimit të parkut në grafi e prekura.

Në Indi, Komisioni për Fuqizimin e Grave është një komision i përkushtuar parlamentar me autoritet të gjerë, duke përfshirë: (1) shqyrtimin e raporteve nga Komisioni Kombëtar për Gratë dhe raportimin përmirësuar statusin e grave; (2) shqyrtimin e masave të ndërmarra nga qeveria përfundimisht të siguruar barazinë e grave në të gjitha çështjet; (3) shqyrtimin e masave të ndërmarra nga qeveria përfundimisht të arsimimin dhe përfaqësimin e grave në organet legjislative dhe fusha të tjera; dhe (4) shqyrtimin e çdo çështjeje tjetër të referuar nga Kryesuesi i secilës dhomë ose me vullnetin e vet. Në vitet 2015/16, Komisioni shqyrtoi çështje të tillë si: gratë në paraburgim dhe qasja në drejtësi; kujdesi shëndetësor përfundimisht; përgjegjësia sociale e korporatave ndaj grave; zbatimi i ligjeve përmirësuar qëndrohet në familje; ngacmimi seksual i grave në vendet e punës dhe në institucionet arsimore; skemat e sigurimit përfundimisht; fuqizimi i grave fisnore; dhe gjendja e grave në sektorin informal. Të gjitha këto hetime u ndërmorën në partneritet me komisione të tjera me terma të zbatueshme të referencës.

Për më shumë informacion mbi shembullin e Fixhit, shih: Unioni Ndërparlamentar, Parlamenti i Indisë, tet e Ndjeshme ndaj Çështjeve Gjinore: Një përbledhje globale e praktikës së mirë, 2011, www.ipu.org/pdf/publications/gsp11-e.pdf dhe Rregullorja e Punës së Parlamentit të Fixhit, www.parliament.gov.fj/getattachment/Parliament-Business/Rules-of-the-House/SO-210316.pdf.aspx. Për më shumë informacion mbi shembullin e Indisë, shih: http://parliamentofindia.nic.in/ls/intro/committee_on_empowerment.htm and http://164.100.47.192/Loksabha/Committee/CommitteeInformation.aspx?comm_code=8&tab=2.

Shumë komisione tashmë e do të angazhohen në aktivitete që kontribuojnë në mbikëqyrjen e OZHQ-ve, pasi mandatet e tyre sektoriale mund të mbulojnë një ose më shumë OZHQ. Sidoqoftë, përfundimisht, duhet të merret parasysh shqyrtimi i gjëresisë së mandatit dhe aspektet praktike të mbikëqyrjes të ndërmarra nga të gjitha komisionet ekzistuese. Për shembull, shumica e komisioneve parlamentare të sektorit të shëndetësisë do të shqyrtojnë disa çështje të mbuluara nga OZHQ3, që kanë të bëjnë me shëndetin dhe mirëqenien. Por shpesh, puna e këtyre komisioneve mund të përqendrohet në çështje të shqetësimit imediat, siç janë tarifat e mjekëve apo koha e pritisë përfundimisht, dhe jo aq shumë në çështje të tjera në kuadër të objektivit, siç janë promovimi i shëndetit, parandalimi i sëmundjeve dhe strategjitet kombëtare përmirësimi i shëndetit. Ngashëm, një komision parlamentar i sektorit të arsimit pothuajse me siguri do të jetë duke mbuluar tashmë disa aspekte të OZHQ4, që kanë të bëjnë me arsimin cilësor. Por mbikëqyrja mund të jetë më e theksuar ndaj pagave në sektorin e arsimit ose madhësisë së klasave, në vend të strategjive afatgjata përfundimisht pabarazitë gjinore në rezultatet arsimore. Fokusi dhe fushëveprimi duhet të adresohen. Nëse parlamenti vendos përfundimisht qëndrohet në çështje gjithashtu të jenë të qartë dhe me termat përkatëse të referencës.

Nëse një parlament angazhohet për krijimin e një Komisioni të posaçëm të OZHQ-ve për të vepruar si pikë fokusi dhe për të marrë drejtimin në sigurimin e monitorimit dhe mbikëqyrjes së OZHQ-ve, mund të merret parasysh mandati i një komisioni ekzistues. Për shembull, në është parlamenti tashmë ka një Komision të Çështjeve Sociale ose Komision për Uljen e Varférise me një mandat të gjerë për të marrë parasysh zhvillimin e qëndrueshëm ose çështjet e zbutjes së varférise, ky komision mund të jetë gjithashtu në pozicion të mirë për të vepruar si një pikë fokusi efektive për OZHQ-të në kuadër të parlamentit.

Një komision i tillë mund të ndihmojë edhe në koordinimin e përpjekjeve të komisioneve të tjera për të shqyrtuar çështjet e lidhura me OZHQ-të, si dhe mund të ketë një rol në shqyrtimin e çdo raporti kombëtar për OZHQ-të të prodhuar nga qeveria. Përndryshe, duke qenë se OZHQ-të kanë një element global, Komisioni për Punë të Jashtme mund të jetë i ngarkuar me këtë rol si pikë fokusi.

Në Rumani, Komisioni për Politikë të Jashtme ka ngritur një Nënkomision për Zhvillim të Qëndrueshëm, i cili ka filluar një sërë konsultimesh me institucionet përkatëse qeveritare, akademikët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, me qëllim krijimin e një udhërrëfyesi për rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim të Qëndrueshëm në harmoni me OZHQ-të e reja.

Çfarëdo vendimi të merret, idealisht duhet të realizohet një lloj analize kosto -përfitim dhe/ose një dokument i pozicionit, në mënyrë që të konsiderohen mundësitë e ndryshme përpëra se parlamenti të vendosë si do të donte të organizohej për t'u angazhuar në mbikëqyrjen e OZHQ-ve. Më poshtë jepen disa avantazhe të përdorimit nga parlamenti të komisioneve të dedikuara për OZHQ-të kundrejt atyre sektoriale.

Përdorimi i komisioneve ekzistuese

- Komisionet zakonisht janë tashmë të themeluara dhe do të kenë fonde dhe anëtarë të personelit.
- Ekspertiza lëndore tashmë do të ekzistojë në kuadër të anëtarësisë së Komisionit dhe anëtarëve të personelit.
- Nuk do të ketë nevojë për të ndryshuar rre gulloren e punës për të krijuar një Komision të ri (megjithëse rregullat mund të shqyrtohen për t'i referuar në mënyrë më eksplikite mbikëqyrjes së OZHQ-ve në termat e referencës për secilin komision), andaj parlamenti mund të fillojë menjëherë punën për çështjet e OZHQ-ve.
- Sigurohet më shumë kohë për të ndërmarrë një shqyrtim të hollësishëm të legjislacionit dhe për të siguruar mbikëqyrje në lidhje me secilin OZHQ dhe target (krahasuar me një Komision të vetëm për OZHQ-të nga i cili do të kërkohej të shqyrtonte të gjitha ligjet dhe politikat e lidhura me OZHQ-të).

Krijimi i një komisioni të ri për OZHQ-të

- Hapja e një komisioni të ri për OZHQ-të ofron një mundësi për parlamentin që të bëjë një deklaratë të qartë publike për rëndësinë që parlamenti u kushton OZHQ-ve.
- Komisioni mund të veprojë si një pikë qendrore e fokusit për OZHQ-të në kuadër të parlamentit, me të cilën qeveria mund të punojë dhe ku shoqëria civile dhe publiku mund të drejojnë përpjekjet e tyre të avokimit.
- Një komision i vetëm mund të lehtësojë ndjekjen e legjislacionit për OZHQ-të (edhe pse gjërsia e çështjeve të OZHQ-vë do të thotë se pothuajse të gjitha ligjet tani do të kenë një lloj rëndësie për OZHQ-të dhe duhet të konsiderohen në bashkëpunim me komisionin përkatës sektorial).

Natyrisht, është krejtësisht e mundur të përdoren të dyja qasjet: shqyrtimi dhe rishikimi i mandatit të komisioneve ekzistuese për t'i përshtatur më mirë Agjendës 2030 dhe krijimi i një komisioni të përgjithshëm për OZHQ-të për të shqyrtuar progresi i n dhe koordinimin në përgjithësi, ose përshtatja e një komisioni ekzistues për këtë detyrë të fundit.

Pyetje për reflektim

- A ka ndërmarrë parlamenti juaj një shqyrtim të Rregullores së Punës dhe mandateve të komisioneve ekzistuese parlamentar për t'u siguruar që OZHQ-të janë pjesë e kompetencave të secilit komision, si dhe për të vlerësuar nëse dhe si mund të forcohen komisionet për të mbështetur zbatimin dhe mbikëqyrjen e OZHQ-ve?
- Nëse parlamenti juaj po shqyrton ngritjen e një komisioni parlamentar dedikuar për OZHQ-të:
 - a është ndërmarrë një analizë kosto përfitim, në veçanti për të vlerësuar anëtarët shtesë të personelit dhe burimet e financimit që do të nevojiten për të mbështetur një komision të tillë?
 - a është konsideruar ideja për ngarkuar një komision tjetër për të vepruar si pikë fokusi për OZHQ të?
- A kanë komisionet sektoriale autoritetet ligjore dhe burimet (njerëzore dhe financiare) për të ndërmarrë vlerësimet e tyre të ndikimit të OZHQ-ve për projektligjet dhe programet e propozuara (duke përfshirë, kur kërkohet, përmes monitorimit në vend për të vlerësuar zbatimin e programeve të lidhura me OZHQ-të)? Nëse jo, cilat janë mangësitë në kapacitetet dhe çfarë mund të bëhet për t'i adresuar ato?
- A mundëson Rregullorja e Punës që komisionet sektoriale të intervistojnë dhe të angazhohen me efektivitet me zyrtarë qeveritarë për të vlerësuar siç duhet nëse dhe si kanë kontribuar politikat dhe programet e tyre në arritjen e OZHQ-ve?
- A kërkon Rregullorja e Punës përgjigje efektive nga qeveria për raportet dhe rekomandimet e dhëna nga komisionet? Nëse jo, si mund të përmirësohet për të mandatuar përgjigjet e qeverisë?

B. Hetimet parlamentare

Një nga pushtetet më të forta që përdor shumica e parlamenteve është aftësia për të nisur një hetim për çdo çështje me interes publik. Megjithëse rregullorja e punës mund të kërkojë ndjekjen e proceseve të ndryshme për t'i filluar këto hetime, këto janë një mjet i vlefshëm që parlamentarët mund të përdorin për të tërhequr vëmendjen ndaj çështjeve me rëndësi për OZHQ-të. Një hetim mund të bëhet përmes një komisioni ekzistues. Për shembull, termat e referencës së disa komisioneve u mundësojnë të iniciojnë seanca dëgjimore për "çdo çështje që lidhet me mandatin e komisionit".



Përndryshe, parlamenti mund të miratojë një rezolutë në një seancë plenare, duke ngarkuar një komision ekzistues për të ndërmarrë një hetim specifik për një çështje. Nëse nuk ka komision me juridiksion lëndor, ose kur një hetim mund të kërkojë më shumë burime të dedikuara, një parlament mund të zgjedhë gjithashtu krijimin e një komisioni ad hoc ose të posaçëm me një mandat specifik dhe vetëm për të ndërmarrë një hetim, duke u shpërbërë pas përfundimit të detyrës.

UNDP në Indi
Zgjedhjet në Indi 2014. Foto: Prashanth Vishwanathan.

Hetimet parlamentare mund të jenë mekanizma kritike të politikave dhe monitorimit në mbështetje të OZHQ-ve. Ato u lejojnë parlamentarëve të thërrasin dëshmitarë, të kërkojnë dhe të shqyrtojnë dokumentet e qeverisë, të organizojnë dëgjime publike dhe të debatojnë në thellësi për çështjet që kanë të bëjnë me adresimin e një problemi politik.

Është me rëndësi që procesi i angazhimit të publikut të jetë i dobishëm - shumica e parlamenteve lejojnë parashtrime publike me shkrim, me gojë dhe në internet, si dhe që ekspertë dhe të tjerë me njohuri të specializuara të shfaqen personalisht dhe të paraqesin dëshmi gojore. Në fund të një hetimi, komisioni do të prodhojë një raport që paraqet një mundësi kritike për parlamentarët që t'i paraqesin qeverisë dhe publikut rekomandime të politikave, ligjore dhe programore për veprim. Në vendet me politikë të ndarë, raporte të tillë mund të jenë shumë të dobishme për të paraqitur në mënyrë paqësore përgjigje të ndryshme ndaj sfidave të njëjta politike, me pikëpamjet e s humicës dhe të pakicës që u mundësojnë parlamentarëve të bindjeve të ndryshme politike që të kenë ende mundësi për të ndarë idetë dhe njohuritë e tyre.

Australi dhe Mbretëri e Bashkuar: Luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore

Është një realitet tragjik që trafikimi i qenieve njerëzore, veçanërisht i grave dhe fëmijëve, mbetet një problem i mprehtë. OZHQ-të kërkojnë posaçërisht prej qeverive që të veprojnë për ta luftuar trafikimin. targeti 5.2 bën thirrje për eliminimin e "të gjitha formave të dhunës kundër të gjitha grave dhe vajzave në sferat publike dhe private, duke përfshirë trafikimin dhe shfrytëzimin seksual dhe lloje të tjera të shfrytëzimit". targeti 16.2 synon "t'u jepet fund abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dëhe torturës kundër fëmijëve". Për të trajtuar këtë sfidë ndër –jurisdikSIONALE dhe me shumë aspekte, sigurimi që kornizat legislative dhe mekanizmat e tjerë mbështetës janë adekuatështë një hap vendimtar.

Në Australi, Komisioni i Përbashkët Parlamentar Federal për Zbatimin e Ligjit inicioi një hetim për trafikimin e qenieve njerëzore në dhjetor të vitit 2015. Hetimi shqyrttoi çështjet e kulturës, zbatimit të ligjit, krimit transnacional, migracionit dhe teknologjisë, si dhe masat praktike të identikuara për t'i adresuar këto sfida. Njëzet e një parashresa u bënë në hetim, kryesisht nga organizatat e shoqërisë civile dhe rrjetet e grave që punonin në këto çështje.

Në Mbretërinë e Bashkuar, Komisioni Parlamentar i Punëve të Brendshme filloi një hetim për trafikimin njerëzor në vitin 2008 dhe raportoi në vitin 2009. Ky është një shembull i dobishëm se si veprimi parlamentar mund të nxisë veprimin ekzekutiv. Në vitin 2013, duke ndjekur rekomandimet e hetimit fillestar, qeveria parashroi një projektligj për Skllavërinë Moderne. Në mars të vitit 2014, Komisioni i Përbashkët Parlamentar përfshirë Projektligjin përfshirë Skllavërinë Moderne mbajti diskutime të mëtejshme dhe të shënjestrurara publike në lidhje me këtë çështje. Ky komision kishte një mandat më të ngushtë përfshirë shënjestrurën nëse projektligji do të ishte efektiv në mbrojtjen e viktimate të skllavërisë dhe trafikimit dhe do të siguronte vërtet dënimin e autorëve. Në mënyrë domethënëse, projektligji i miratua në vitin 2015, kurse në vitin 2016 në Dhomën e Komunave u parashtrua një mocion që përgëzoi përfshirjen e targeteve specifike në OZHQ-të që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore.

Burimet

Australia:

www.aph.gov.au/Parliamentary_Business/Committees/Joint/Law_Enforcement/Human_trafficking; www.parliament.uk/business/committees/committees-archive/home-affairs-committee/hacpn080118no21/; and www.publications.parliament.uk/pa/cm200809/cmselect/cmhaff/cmhaff.htm.

Mbretëria e Bashkuar: www.parliament.uk/business/committees/committees-a-z/joint-select/draft-modern-slavery-bill/news/-evidence-session-draft-modern-slavery-bill-1/ and www.parliament.uk/edm/2015-16/1255.

Pyetje për reflektim

- A e lejon rregullorja e punës që parlamenti juaj të kryejë hetime që mund të përdoren për të shqyrtuar çështjet e lidhura me OZHQ-të?
- A mundëson rregullorja e punës hetime dhe pyetje efektive të zyrtarëve qeveritarë të zgjedhur dhe të emëruar për të vlerësuar siç duhet efektivitetin e veprimeve të qeverisë për çështjet që lidhen me OZHQ-të?
- Kur hapen hetimet, a janë të mjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare të disponueshme për komisionet për të realizuar mandatet e tyre në mënyrë efektive (p.sh. finan cimi për organizimin e dëgjimeve publike dhe shkathtësitë e anëtarëve të personelit për të ndërmarrë hulumtime, për të dhënë këshilla eksperte dhe për të prodhuar raporte cilësore të komisioneve)?

C. Pyetjet dhe interpelancat me shkrim dhe me gojë

Një nga metodat më të thjeshta por më efektive parlamentare për të kërkuar llogaridhënie nga qeveria është përmes mekanizmave që u jepin mundësi parlamentarëve të marrin në pyetje drejtëpërdrejt ministrat e qeverisë lidhur me çështjet që janë në kuadër të porto foleve të tyre. Këto mekanizma ndryshojnë varësisht nga forma e legjislaturës, por qëllimi i tyre është i njëjtë: të bëhen pyetje për ministrat, me shkrim dhe me gojë (Koha e Pyetjeve), dhe të kërkohet një përgjigje publike.

- **Pyetjet me shkrim dhe me gojë:** Ky është një proces i përdorur në sistemet parlamentare, ku një pjesë e caktuar e kohës së seancës u kushtohet pyetjeve për ministrat. Pyetjet mund të paraqiten nga deputetë të shumicës qeverisëse ose të opozitës. Në një sistem parlamentar, këta ministrat shpeshherë janë vetë deputetë. Mund të lejohen edhe pyetje përcjellëse nga deputetë të tjera. Shpesh, kërkesa për t'i përgjigjur pyetjeve me gojë është e përforcuar nga një sistem me të cilin deputetët mund të bëjnë pyetje me shkrim për ministrat dhe ku përgjigjet e ministrave publikohen si pjesë e procesverbalit parlamentar.
- **Interpelancat:** Interpelancat përdoren në sisteme me ndarje të fuqishme të pushteteve, ku ministrat zakonisht nuk janë deputetë dhe prandaj duhet të thirren në parlament për t'i përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Prandaj, interpelancat duhet të dorëzohen me njoftim për t'i dhënë kohë të mjaftueshme një ministri për të organizuar prezencën në parlament. Në disa parlemente, një interpelancë mund të lidhet me një motion mosbesimi për ministrin ose në qeverinë.

Sri Lanka: Ushtimi i presionit parlamentar mbi qeverinë për të vepruar për çështjet e OZHQ-ve

Në Sri Lanka, Koha e Pyetjeve përdoret si mundësi që parlamentarët që t'u bëjnë pyetje ministrave për progresin e zbatimit të çështjeve specifike të OZHQ-ve. Faqja e internetit e parlamentit të Sri Lankës përfaqëson praktikat e mira globale, pasi shërben si një mekanizëm për t'u mundësuar parlamentarëve të demonstrojnë publikisht përkushtimin e tyre për të mbikëqyrur në mënyrë proaktive zbatimin e OZHQ-ve, dhe u mundëson vetë qytetarëve qasje në informata nga qeveria për çka po bëhet (dhe çka nuk është bërë).

Për parlamentarët nga vende të tjera faqja e internetit e parlamentit të Sri Lanka mund të jetë e dobishme si një burim i pyetjeve të mundshme që mund të marrin në konsideratë në vendin e tyre. Për shembull, në vitin 2014 një parlamentar e përdori kohën e pyetjeve për t'i kërkuar Ministrisë për Financim dhe Planifikim informacion përvijat e varfërisë në distrikte. Pyetja iu drejtua Ministrit si vijon:

- A është ai i vetëdijshëm që Departamenti i Regjistrimit dhe Statistikave publikon çdo muaj Vijën e Varfërisë në Distrikt bazuar në shpenzimet minimale mujore për person për të përbushur nevojat themelore?
- A do ta informojë parlamentin për:
 - (i) vijën më të fundit të disponueshme zyrtare të varfërisë për distriktin Colombo; dhe
 - (ii) nevojat themelore që përfshihen në llogaritjen e vijës së varfërisë së lartpërmendur?
- Nëse jo, pse jo?

Shih: www.parliament.lk/en/business-of-parliament/parliamentary-questions.

Pa marrë parasysh se cila formë e pyetjes përdoret, këto mekanizma të pyetjeve mund të janë mënyra tejet të dobishme për një parlamentar individual për të ngritur një çështje të OZHQ-ve me interes publik në Dhomën e Përfaqësuesve dhe për të kërkuar një përgjigje nga qeveria në lidhje me çka po bën për ta trajtuar. Pjetjet mund të ekzaminojnë gjëresisht proceset e planifi kimit dhe zbatimit të OZHQ-ve (p.sh., cili është statusi i përgatitjes së planit kombëtar për OZHQ-të? Kur do të paraqitet në parlament?), ose a mund të jetë shumë më specifik dhe të hetojë në lidhje me zbatimin e një OZHQ-je ose targeti të caktuar (p.sh. Çfarë po bën qeveria për të adresuar çështjet e pabarazisë në përputhje me OZHQ 10?). Ato madje mund të bëjnë pyetje për aktivitete specifike në lidhje me një target (p.sh. Çfarë po bën qeveria për të forcuar ofrimin e shërbimeve nga institucioni i arsimit profesional në provincën XX në përputhje me OZHQ 4, targeti 4.4?).

Pyetje për reflektim

- A lejon rregullorja e punës e parlamentit që pyetjet, me shkrim ose me gojë, dhe interpelancat të përdoren efektivisht në praktikë për të kërkuar llogari nga ministrat e qeverisë? Nëse jo, cilat janë dobësítë e sistemit aktual dhe si mund të adresohen?
- A u jepet deputetëve joqeveritarë kohë dhe mundësi e mjaftueshme për t'i përdorur në mënyrë efektive pyetjet, me shkrim apo me gojë, dhe interpelancat? Nëse jo, çfarë mund të bëhet për të përmirësuar praktikën ekzistuese?
- A transmetohen dhe publikohen në faqen e internetit të parlamentit interpelancat dhe përgjigjet e tyre, dhe pyetjet dhe përgjigjet e tyre? A janë paraparë pyetjet dhe përgjigje me shkrim, dhe a duhet të botohen? Nëse jo, si mund të ndahet më efektivisht me publikun informacioni nga këto procedura?

VII. Përfaqësimi: Angazhimi i qytetarëve dhe lehtësimi i pjesëmarrjes së publikut

FUNKSIONET KYÇE TË
PARLAMENTEVË

PËRFQËSIMI

Në përmbushjen e funksioneve të ligjvënes dhe mbikëqyrjes, një parlament përfaqëson ata që i zgjodhën në parlament. Që një parlament ta mbajë legjitimitetin është kritike që llogaridhënia ndaj votuesve të zhvillohet në mënyrë sistematike gjatë gjithë mandatit parlamentar, dhe jo vetëm në kohën e zgjedhjeve. Është e rëndësishme që qytetarët të kenë mundësi të mjaftueshme për të ofruar reagime mbi punën e parlamentit dhe të parlamentarëve individualë.

Legjitimiteti i një parlamenti dhe anëtarëve të tij vjen nga fakti se ata janë zgjedhur për të përfaqësuar popullin e një vendi (ose shteti ose krahine). Deputetët mblidhen në asamble për të marrë vendime në emër të të gjithë qytetarëve. Kjo do të thotë se institucioni dhe anëtarët e tij individualë duhet të krijojnë dhe mbajnë mjete aktive për të angazhuar publikun në mënyrë rutinore për të konstatuar interesat, mendimet dhe shqetësimet e tyre. Dështimi për ta bërë këtë mund të rezultojë në një kërcënim për legjitimitetin e institucionit dhe mund të rezultojë në vështirësi përllogaridhënie në zgjedhjet e ardhshme për deputetë.

Përtej bazës kushtetuese që parlamentet të janë përfaqësues, ekzistojnë raporte praktike dhe ligjore për angazhimin efektiv të publikut. OZHQ-të kërkojnë posaçërisht përfshirjen e institucioneve qeveritare (duke përfshirë edhe parlamentet) përmes OZHQ 16, si dhe kërkojnë përfshirjen politike të të gjithëve pa marrë parasysh moshën, gjininë, aftësinë e kufizuar, racën, përkatësinë etnike, origjinën, fenë ose statusin ekonomik apo tjeter. Prandaj, vendet që janë të përkushtuara për zbatimin e OZHQ-ve angazhohen në formë implicate në ndërtimin e parlamenteve më gjithëpërfshirëse dhe efektive gjatë viteve të ardhshme.

Parlamentarët nuk mund të janë eksperët në të gjitha temat që do t'u kërkohet të marrin në shqyrtim.

Megjithatë, ata mbajnë përgjegjësi para atyre që punojnë dhe jetojnë sipas ligjeve që ata hartojnë dhe buxheteve që miratojnë për t'u siguruar që qytetarët konsultohen gjërësisht në procese që i prekin. Rritja e kontributeve nga zgjedhësit mund të krijojë ligje dhe buxhet të cilësisë më të lartë dhe ka më shumë gjasa të sigurojë pranimin dhe kënaqësinë e publikut. Kjo nuk do të thotë që parlamentarët duhet të pajtohen me shqetësimet e të gjithë zgjedhësve, por kjo do të thotë se ata janë më të pajisur për të kryer rolin e tyre kur dëgjojnë shtresa të gjera të publikut dhe pastaj përdorin atë që kanë mësuar nga konsultimet për t'u përgatitur përvotimet dhe ndërhyrjet që bëjnë në parlament.

Përfitimet e dialogut publik për punë e parlamentit lidhen njësoj edhe me zbatimin e OZHQ-ve. Është e rëndësishme që kornizat ligjore të vendosura dhe fondet e caktuara për të arritur OZHQ të ndryshme të bazohen në njohuritë dhe perspektivat e qytetarëve që do të preken nga këto ndryshime. OZHQ-të duhet të kuptohen nga qytetarët si një grup objektivash që mund të përmirësojnë jetën dhe komunitetet e tyre.

I kemi diskutuar aspektet specifike teknike të punës së një parlamentari si ligjvënës - puna parlamentare për të realizuar reformat e politikave në interesin kombëtar. Megjithatë, realiteti për shumicën e deputetëve është se atyre u kërkohet vazhdimit t'u përgjigjen nevojave dhe shqetësimeve të qytetarëve. Një parlamentar merr çdo ditë mesazhe të shumta, thirrje telefonike dhe kërkesa personale për ndihmë. Përgjigja ndaj këtyre kérkesave mund të jetë një punë me orar të plotë në vvetve.

Sfida për shumë parlamentarë është të iniciojnë dhe mbajnë një dialog me qytetarët që është i orientuar drejt politikave. Qëllimi është të kërkohet kontributi i zgjedhësve në baza të vazhdueshme në nivel lokal dhe kombëtar, për të fituar njohuri nga përvojat e tyre dhe për t'u siguruar që ligjet e miratuara dhe monitorimi i kryer nga parlamenti t'i pasqyrojnë këto interesa dhe shqetësime.

Afrika e Jugut: Korniza e pjesëmarrjes së publikut

Neni 59 i Kushtetutës së Afrikës së Jugut (1996) pohon se Asambleja Kombëtare duhet "të lehtësojë përfshirjen e publikut në proceset legislative dhe të tjera të Asamblesë dhe komisioneve të saj". Për t'i vënë këto fja lë në veprim, një Kornizë për Pjesëmarrjen e Publikut e viti 2013 njofton një hierarki të angazhimit publik bazuar në katër nivelet e listuara më poshtë.

Niveli 1: Informim i qytetarëve për punën e parlamentit dhe të qeverisë.

Niveli 2: Konsultimi me publikun dhe kërkimi i kontributit të tyre.

Niveli 3: Përfshirja e publikut përmes vendosjes së dialogut.

Niveli 4: Bashkëpunimi me publikun duke krijuar mundësi për partneritet.

Përkundër këtyre dispozitave kushtetuese, studimet e fundit akademike kanë vërejtur përdorimin e gjykatave për të zbatuar dispozitën kur qeveritë dhe legjislaturat kanë qenë të pakujdeshme dhe kur ka munguar përfshirja në procesin e pjesëmarrjes publike.

Burimet: http://www.parliament.gov.za/live/content.php?Item_ID=304 and

[http://www.krepublishers.com/02-Journals/JSS/JSS-39-0-000-14-Web/JSS-39-3-14-Abst-PDF/JSS-39-3-275-14-1620-Mubangizi-B-C/JSS-39-3-275-14-1620-Mubangizi-B-C-Tx\[4\].pdf](http://www.krepublishers.com/02-Journals/JSS/JSS-39-0-000-14-Web/JSS-39-3-14-Abst-PDF/JSS-39-3-275-14-1620-Mubangizi-B-C/JSS-39-3-275-14-1620-Mubangizi-B-C-Tx[4].pdf)

Më poshtë janë disa mjete të ndryshme me të cilat një parlamentar dhe një parlament mund të ndërtojnë dialog publik me qytetarët.

Forume publike lokale: Në kuadër të një zone elektorale ose një komuniteti lokal, një parlamentar mund të organizojë forume publike, qoftë formale apo joformale, në të cilat qytetarët kanë mundësi të japid reagime mbi një çështje specifike (p.sh. një projektligj në shqyrtim, gjendjen e arsimit në komunitet) ose të angazhohen në diskutim më të përgjithshëm për të shprehur një sërë shqetësimesh.

Konsultimet publike: Siç është vërejtur në Pjesën VI më lart, komisionet parlamentare duhet të angazhojnë shoqërinë civile dhe publikun gjatë shqyrtimit të projektligjeve dhe kryerjes së hetimeve. Këto konsultime mund të shkojnë nga informale (të tillë si forume publike dhe seancat e raportimit) në ato më formale (p.sh., dëgjimet publike); dhe nga teknike (p.sh., anketat) në të thjeshta (p.sh., kërkësat për parashtrime me SMS). Konsultimi mund të realizohet edhe në formën e angazhimit virtual, duke përfshirë reagimet dhe anketat online, si dhe mediat sociale.



UNAMA
Konferencia e tretë e raportimit vjetor të Dai Kundit në Afganistan në janar 2012. Foto: Aurora Verceles Alambra

Ganë: Lidhja e qytetarëve me parlamentin dhe shfrytëzimi i saj për OZHQ-të
Në vitin 2015, Komisioni për Garancitë Qeveritare i Parlamentit të Ganës, me përkrahjen e partnerëve të jashtëm, nisi një ueb portal i cili u mundëson qytetarëve të jepin reagime për punën e tyre të vazhdueshme dhe të ngrenë shqetësimë rreth aktivitetave qeveritare në komunitetet e tyre. Nëpërmjet mjeteve offline dhe online, qytetarët kanë përqafuar në mënyrë aktive formatin e ri dhe kjo ka rezultuar në një komision, puna e të cilit është më efektive dhe më efikase. Ky lloj "mekanizmi ndryshimi" u lejon komisioneve të lidhen drejtpërdrejt me shqetësimet lokale dhe të garantojnë se ato zëra dëgjohen gjatë diskutimeve.

Burimi: Ekow Essabra -Mensah, "Nisma e lidhjes së qytetarëve me parlamentin shënon sukses masiv", B&FT Online, 24 maj 2016, <http://thebftonline.com/business/economy/19095/connecting-citizens-to-parliament-initiative-records-massive-success->.

Konsultimet partiake: Shumica e deputetëve janë gjithashtu përfaqësues të një partie të caktuar politike. Partitë zakonisht kanë një strukturë me degë. Përmes degëve të tillë ose përmes konsultimeve të organizuara nga partitë, një parlamentar mund të fitojë njohuri për perspektivat e mbështetësve të tyre.

Partneritetet e shoqërisë civile: Në varësi të temës ose çështjes së shtruar para parlamentit përvendim, ekziston më shumë se një organizatë lokale ose ko mbëtare e shoqërisë civile që avokon ose punon në terren. Duke bashkëpunuar me një ose më shumë nga këto organizata, parlamenti (ose parlamentarët individualë) mund të zgjerojë shtrirjen e tyre dhe të sigurojnë që zërave, të cilët përndryshe nuk do të dëgjoheshin, t'u jepet mundësia për të dhënë kontribut në punën e tyre.

Mediat sociale dhe teknologja e re: Qasja më e gjerë në telefonat mobil dhe në internet nga ana e qytetarëve ka hapur mundësi për parlamentet dhe parlamentarët që t'i angazhojnë ata në një dialog mbi punën e parlamentit dhe për të kërkuar mendimet dhe idetë e tyre në mënyrë të vazhdueshme.

Anketat: Me përparimet në teknologji, kostoja e kryerjes së një studimi është zvogëluar në mënyrë drastike. Parlamentet dhe parlamentarët gjithnjë e më shumë po përdorin mjete online për të mbledhur reagime nga publiku përpara diskutimeve mbi një projektligj apo si pjesë e një hetimi mbikëqyrës.

Takimet individuale dhe me grupe të vogla: Parlamentarët individualë mund të organizojnë takime me persona që kanë shqetësimë ose çështje që ata dëshirojnë t'i paraqesin në baza individuale ose si grup i vogël.

A. Promovimi i ligjvënies pjesëmarrëse

Ligjvënia pjesëmarrëse është procesi përmes të cilit një parlament, grup parlamentar, komision ose deputet individual e angazhon publikun në mënyrë aktive në konsiderimin dhe shqyrtimin e projektligjeve që shqyrtohen para Dhomës.

Normalisht, një projekt-ligji kalon nëpër shumë fazë të shqyrtimit nga parlamenti. Këto përfshijnë lexime të ndryshme ose debate gjatë seancave plenare të Dhomës. Është në fazën e komisionit - para se parlamenti të ketë zhvilluar dhe konsideruar ndryshime të mundshme në projektligj - që publiku ka një mundësi të konsiderueshme për t'u angazhuar me parlamentin dhe për të ofruar të dhëna në kohën e duhur.

Mënyra më e zakonshme e angazhimit publik është përmes dëgjimit publik. Në një seancë dëgjimi publike, një komision mban një takim formal në të cilin të ftuarit e interesuar, palët e interesit, ekspertët e temës dhe shoqëria civile ofrojnë pa rashtresa me gojë dhe/ose me shkrim mbi aspekte specifike ose të gjithë përbajtjen e një projektligji.

Këto dëgjime zakonisht përfshijnë një mundësi për anëtarët e komisionit që të bëjnë pyetje për prezantuesit dhe të marrin përgjigje nga prezantuesit.

Por, përtej dëgjimeve publike, është konstatuar se një komision parlamentar mund të jetë më efektiv nëse del nga ndërtesa e parlamentit dhe zhvillon seanca dëgjimore në rajone të ndryshme, për t'u dhënë më shumë grupeve dhe qytetarëve mundësinë për të dhënë ë kontribut për projektit. Natyrisht, kjo kërkon burime dhe angazhim të anëtarëve të personelit për të organizuar vizita të tilla, por kur kjo mund të bëhet, komisioni mund të dëgjojë nga një gamë më të gjerë të palëve të interesit sesa zakonisht dhe mund të shohë drejtëpërdrejt si do të ndikojë një projektit tek njerëzit në terren. Takimet virtuale, të mundësuara nga teknologjia, gjithashtu mund të lejojnë pjesëmarrje më të gjerë në distancë.

Gjeorgji: Komisioni për Bujqësi angazhon fermerët për të përmirësuar kooperativat

Pasi u zhvillua një plan veprimi shumëvjeçar për të përmirësuar kapacitetin e tij (me mbështetjen e UNDP-së), Komisioni për Bujqësi i Parlamentit të Gjeorgjisë filloi të kryejë vizita në terren dhe dëgjime publike jashtë Parlamenti në vitin 2014. Me angazhimin e fermerëve lokalë dhe subjekteve të përfshira në industrinë bujqësore, Komisioni dëgjoi shumë sugjerime si mund të adresonte çështjet dhe shqetësimet që në dukje ishin injoruar nga qeveria. Të paktën 200 fermerë morën pjesë në se cilin dëgjim të organizuar në mbarë vendin. Shumë fermerë ngritën shqetësimë rrëth kooperativave, një formë kyçe e zhvillimit bujqësor në Gjeorgji. Bazuar në reagimet e marra, Komisioni inicioi dhe miratoi ndryshime në Ligjin për kooperativat, në dobi të fermerëve.

Shqyrtimi afatmesëm i projektit të UNDP-së Forcimi i Sistemit të Demokracisë Parlamentare në Gjeorgji (janar 2016).

Përveç kësaj, një komision ose një parlament mund të jetë proaktiv në sigurimin e informatave për publikun në lidhje me punën e tij për shqyrtimin e projektit. Kjo mund të përfshijë botimin (p.sh. përmes gazetës ose online) të projektit, planifikimin e mbledhjeve për të shqyrtuar projektit dhe thirrjen për parashtrime nga individë dhe grupe të ndryshme.

Pyetje për reflektim

- A i publikon parlamenti juaj projektit për të inkurajuar kontributin e publikut, për shembull, duke i ngarkuar projektit në faqen e internetit të parlamentit apo duke reklamuar përbajtjen e tyre në media?
- A e lejon rregullorja juaj e punës që shoqëria civile dhe publikun të bëjnë parashresa për projektit, qoftë me shkrim apo personalisht?
- Si e avancon parlamenti juaj përfshirjen e grupeve të ceneshe dhe të marginalizuara në rrezik për t'u përashtuar (në bazë të gjinisë, moshës, statusit të aftësisë së kufizuar dhe anëtarësisë në një grup të caktuar të popullsisë) nga angazhimi me parlamentin, dhe cilat masa janë marrë për të siguruar që zërat e tyre dëgjohen nga parlamenti dhe parlamentarët?
- Si çështje e praktikës së mirë, a angazhohen dhe konsultohen parlamentarët me publikun në lidhje me përbajtjen e projektit para se të shqyrtohen në parlament?
- A mban sekretariati juaj parlamentar një listë kontaktesh për organizatat e shoqërisë civile, akademikë dhe ekspertë teknikë, nga të cilët mund t'u kërkohet të jalin pikëpamjet e tyre për çështjet e reformës ligjore të OZHQ-ve kur këto çështje shtrohen në parlament apo në komisionet e tij?

B. Lehtësimi i buxhetimit pjesëmarrës

Parlamenti mund dhe duhet ta angaz hojë publikun në hartimin e buxhetit vjetor të shtetit. Edhe pse hartimi dhe prezantimi i buxhetit është tradicionalisht një kompetencë e degës ekzekutive, parlamenti në disa vende angazhon publikun gjatë gjithë ciklit të buxhetit, duke përfshirë konsultimet para-buxhetore për të dëgjuar perspektivat e qytetarëve para se të merret buxheti nga Ministria e Financave. Konsultimet e tillë para-buxhetore mund të kryhen përmes një komisioni për buxhet ose financa, i cili do të jetë komisioni parësor ose kryesor për të shqyrtuar projekt-buxhetin para miratimit nga ana e Dhomës. Por, mund të përfshijë edhe konsultime më të gjera nga të gjitha komisionet sektoriale.

Duke pasur parasysh teknologjinë e re, ekzistojnë mundësi për angazhimin e qytetarëve në "kohë reale", teksha buxheti debatohet në parlament. Deri më sot, këto mjete janë zbatuar kryesisht për buxhetet e qeverisjes lokale (shih kutinë më poshtë), por nuk ka asnë arsy që mjetet e tillë të mos përshtaten në një parlament kombëtar për t'u lejuar qytetarëve të jepin reagime mbi aspekte të ndryshme të një buxheti dhe ndikimet e tij.

Ukrainë: Buxhetimi qytetar

Që nga viti 2014, Open North, së bashku me partnerët e Institutit Demokratik Kombëtar për Çështje Ndërkombëtare dhe Ngritje Sociale, kanë punuar me Zyrën e Mençur të Kievit për të siguruar mjete të reja për mbledhjen e kontributeve të qytetarëve në përgatitjen dhe miratimin e buxhetit vjetor të qytetit. Është ndërtuar një portal interneti i posaçëm që u lejon banorëve të Kievit të shohin draftet e buxhetit vjetor dhe u jep atyre mundësinë për të dhënë reagime të detajuara për vijat e veçanta, titujt dhe nëntitujt e buxhetit. Ky kontribut mblidhet dhe u ofrohet zyrtarëve të zgjedhur lokalë gjatë marrjes së vendimeve për ndarjet e buxhetit.

Portali u hap vetëm dy muaj para miratimit të buxhetit vjetor dhe u vizitua nga më shumë se 8,000 individë, me mbi 1,000 komente të paraqitura.

Edhe pse aktualisht përdoret vetëm nga qeverisja lokale, ky mjet mund të përshtatet për përdorim nga komisionet parlamentare kur marrin parasysh buxhetet sektoriale. Për shembull, një komision mund të ngarkojë draft buxhetin vjetor të shtetit në shqyrtim dhe të kërkojë kontribut nga qytetarët dhe organizatat relevante të shoqërisë civile përpara diskutimeve të detajuara të komisionit dhe para se të japë rekomandime zyrtare.

Së fundmi, pasi të jetë miratuar buxheti, komisionet përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të buxhetit, siç janë komisioni për llogaritë publike ose për buxhet dhe financa, duhet të konsulohen me publikun, me palët e interesit dhe me shoqërinë civile, duke kërkuar kontribute për të ditur nëse dhe si shpenzohen vijat e ndryshme buxhetore. Meqenëse janë këta individë dhe grupe që do të shohin ndikimin e çdo shpenzimi buxhetor, ata janë më të përshtatshmit për të informuar komisionin dhe parlamentin nëse buxheti po zbatohet siç duhet.

Pyetje për reflektim

- A ka parlamenti juaj një proces me të cilin grumbullohet kontributi publik para dorëzimit të buxhetit në parlament?
- A është parlamenti juaj i pajisur, teknologjikisht, për të përdorur mjete inovative për të kërkuar reagime dhe ide nga publiku gjatë debatit për buxhetin në parlament?
- Si e angazhon publikun komisioni i mbikëqyrjes së buxhetit i parlamentit tuaj gjatë mbikëqyrjes së shpenzimeve?

C. Kontributet e publikut në monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe politikave

Ashtu si me buxhetet dhe ligjvënien, parlamenti luan rol kyç në monitorimin e zbatimit të ligjeve që miraton, për të siguruar që dega ekzekutive i zbaton në përputhje me qëllimin e parlamentit. Ashtu si me funksionet e tjera të parlamentit, mund të përdoren një sërë mjetesh për të angazhuar publikun dhe shoqërinë civile në këtë proces. Siç është përmendur në fillim të kësaj pjese, duhet të përdoren forume publike, mesazhe SMS, part neritete me organizatat vendore, anketa dhe mjete të tjera për të kuptuar ndikimin ose sfidat e konstatuara në një ligj që është miratuar nga parlamenti dhe që tani po zbatohet në terren.

Përveç formave të konsultimit publik, parlamentarët individualë i a ngazhojnë çdo ditë qytetarët, zgjedhësit dhe votuesit, duke kërkuar mbështetje dhe avokim për ndërveprimet e tyre me qeverinë. Ndhima për qytetarët me aplikimet e tyre për ndihmë sociale ose bursa, për shembull, i jep një parlamentari një mundësi për të vë zhguar sfidat që mund të dalin nga ligjet aktuale në fuqi dhe si ndikon zbatimi i tyre tek ato që punojnë rregullisht sipas një ligji. Kjo i lejon një parlamentari të shohë si funksionon një ligj de facto.

Jordani: Gratë deputete angazhojnë zgjedhësit

Gratë përfaqësojnë vetëm një përqindje të vogël të parlamentarëve të zgjedhur në parlamentin e Jordanisë në vitin 2014, me një mandat për t'u lejuar deputetëve nga të gjitha partitë dhe grupeve të punojnë së bashku për të promovuar çështjet që prekin gratë dhe vajzat. Grupi ka marrë përkrahje për të inkurajuar një ndërveprim më të fuqishëm mes deputetëve dhe votuesve në Jordani. Kjo përfshiu një seri forumesh publike të mbajtura në të gjithë vendin. Çdo gruaje parlamentare, e mbështetur nga të tjerët, iu caktua një rajon dhe një seri forumesh publike në rajon për të dëgjuar nga qytetarët në atë zonë. Gratë u angazhuan në mënyrë specifike për të siguruar perspektivën e tyre dhe shqetësimet u grumbulluan dhe u përdorën nga Grupi i Grave për të nxitur çështjet kyçe në parlament.

Burimi: DFID, Raporti Përfundimtar i Vlerësimit të Programit të Fondacionit Westminster për Demokraci, 2015, f. 36.

Parlamenti, komisionet e tij dhe anëtarët individualë duhet të ndërtojnë linja rutinë të reagimeve që do të sigurojnë se reagimet dhe pikëpamjet e publikut kërkohen në baza të rregullta. Ka mjete të ndryshme për arritjen e këtij objektivi. Për shembull, disa komisione parlamentare kanë zhvilluar plane specifike strategjike (ose veprime) që identifikojnë mjetet dhe metodat kyçe të angazhimit dhe pastaj punojnë drejt zbatimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të tilla.¹⁰ Parlamentet më solide mund të kenë plane pune vjetore ose kalendarë legjislativë¹¹ që përcaktojnë si do t'i përdorin mjetet e tilla parlamenti dhe komisionet e tij për çdo projektligj të shqyrtuar ose hetim të kryer. Të tjerë kanë krijuar qendra informimi parlamentare që lehtësojnë reagimet e votuesve për punën e parlamentit.¹²

¹⁰ Shih: Plani i Veprimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Integrumin Civil në <http://www.parliament.ge/en/saparlamento-saqmia-noba/komitetebi/adamianis-uflebata-dacvisa-da-samoqalaqointegraciis-komiteti/komitetis-samoqmedo-gegma>.

¹¹ Shih: Asambleja Legjislativë e Kolumbisë Britanike (Kanada) në <https://www.leg.bc.ca/parliamentary-business/committees-calendar>.

¹² Shih: Qendra për Informim Parlamentar në Letoni në <http://www.saeima.lv/en/public-participation/receiving-visitors-and-arranging-guided-tours-1/saeima-visitor-and-information-centre>.

Deputetët do të zbulojnë se çfarë funksionon më së miri në kontekstin e rrethana ve të tyre. Varësisht nga madhësia e zonës zgjedhore të parlamentarit (që shkojnë nga grupet e vogla lokale në një zonë elektorale kombëtare), mjetet e përdorura shkojnë nga kontaktet personale dhe tubimet e vogla në anketat e opinionit publik dhe anketime online. Ajo që është e rëndësishme është që një parlamentar të krijojë dhe të realizojë një plan që e bën konsultimin përbërës rutinë dhe me ndikim, kështu që votuesit të kenë një mundësi konkrete për të dhënë kontribut në punën e parlamentarëve të tyre.

Pyetje për reflektim

- A ka Parlamenti juaj një proces me të cilin në mënyrë rutinore i jepen parlamentit reagime për zbatimin e ligjeve?
- Cilat metoda përdoren nga parlamentarët, individualisht, për të angazhuar rregullisht qytetarët dhe zgjedhësit, për të dëgjuar shqetësimet dhe idetë e tyre të lidhura me zbatimin e ligjeve?
- Si e angazhojnë publikun komisionet e parlamentit gjatë monitorimit të zbatimit të ligjeve?

D. Lehtësimi i zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në nivel lokal

Zbatimi i OZHQ-ve nuk është diçka që duhet t'u imponohet qytetarëve nga institucionet kombëtare, por duhet të jetë një mundësi për të krijuar një përgjigje lokale që reflekton kontekstin e komuniteteve lokale. Prandaj, objektiivi kryesor është të vëndoset një dialog për OZHQ-të me autoritetet lokale dhe qytetarët që u lejon atyre të shprehin si duan të jetë zbatimi i OZHQ-ve në komunitetin e tyre. Një dialog i tillë duhet të jetë një pjesë e natyrshme e bashkëveprimit mes qeverisë, parlamentit, parlamentarëve dhe publikut.

Disa parlamentarë marrin fonde për zhvillim të zonave zgjedhore me liri të plotë ose të pjesshme si shpenzohen fondet në zonën e tyre zgjedhore. Këto fonde janë të debatueshme, sepse ato krijojnë shqetësimë rreth mbikëqyrjes së tyre dhe për shkak se mund të dëmtojnë qeverisjen e zgjedhur lokale. Megjithatë, këto janë përhapur gjatë dhjetë viteve të kaluara, pasi parlamentarët njihen si burim njohurish në lidhje me vendet ku duhet të realizohet zhvillimi në rajonet e tyre.

Ka apo nu k ka deputeti një fond për zhvillimin e zonës zgjedhore, është me vlerë që të punohet me përfaqësuesit e qeverisjes vendore dhe komunitetet, nga të gjitha përkatësítë politike, për të ndërtuar një plan zhvillimor lokal. Në shumë raste, autoriteti ose qeveri isja lokale do të marrë drejtimin në përgatitjen e planit, por në raste të tjera parlamenti mund të duhet të luajë një rol më aktiv në promovimin e produktit të tij. Kjo do të përfshijë një sërë takimesh gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe identifikimin e nevojave dhe dëshirave të qytetarëve dhe shoqërisë civile, çka do të çojë në identifikimin e objektivave kyçe, strategjisë/udhërrëfyesit dhe afatit kohor për arritjen e seçilit prej tyre. Kjo mund të bëhet çdo vit ose, nëse përhapet gjatë më shumë viteve, duhet të përfshijë plane vjetore për realizimin e arritjeve në rrugën drejt objektivave përfundimtarë.

Nëse deputeti ka një fond për zhvillimin e zonave zgjedhore, fondet mund të alokohen për të mbuluar të gjithë planin ose një pjesë të tij. Nëse nuk k ka fond, plani kthehet në udhërrëfyes për të kërkuar fonde qeveritare dhe nga burime të tjera për të adresuar nevojat prioritare të zonës dhe komuniteteve të saj.

Në vendet me qeverisje lokale funksionale (dhe organe të zgjedhura të qeverisjes lokale) , plani zhvillimor lokal zakonisht formulohet nën udhëheqjen e qeverisjes vendore. Megjithatë, parlamentarët mund të përdorin kompetencat dhe burimet e tyre (duke përfshirë Fondet e Zhvillimit të Zonave Zgjedhore) për të kontribuar në planet lokale. Gjitha shtu, parlamentarët mund të kërkojnë të verifikojnë nëse ekziston koherenca mes planeve zhvillimore kombëtare dhe lokale dhe nëse OZHQ-të janë plotësisht të integruara në të dyja.

Sidoqoftë, roli kryesor i një parlamentari është miratimi i legjisacionit (duke përfshirë ligjin e buxhetit) dhe monitorimi i zbatimit të tij përmes ofrimit të shërbimeve qeveritare. Planet zhvillimore duhet të bazohen në angazhimin me publikun dhe qeverinë, për të siguruar përfshirjen e të gjitha palëve, si për planin ashtu edhe për objektivat e tij afatgjata.

Pyetje për reflektim

- A siguron parlamenti juaj fonde për zhvillim të zonave zgjedhore për deputetët? Nëse po, a ekziston një kërkesë që fondet të shpenzohen në përputhje me një plan zhvillimor?
- Cilat mjete dhe bu rime do t'ju duhesin si parlamentar për t'ju lejuar të përgatitni (ose të kontribuoni) në një plan zhvillimor të zonave zgjedhore?
- Cilat komunitete, grupe dhe individë duhet të konsultohen për të prodhuar një plan zhvillimor të zonave zgjedhore në rajonin tuaj?

VIII. Rol i Parlamentit në lokalizimin e OZHQ-ve

Përvoja e zbatimit të OZHM-ve tregon se suksesi ishte më i madh kur zbatimi u lokalizua përmes qeverive nën -kombëtare dhe lokale me mandatin dhe kapacitetet e duhura, dhe kur këto institucionë lokale u angazhuan nga fazat e hershme të procesit.

Gjatë OZHM-ve pati përvoja në të cilat llogaridhënia nuk ishte e zhvilluar mirë dhe OZHM-të ishin "të hiper -centralizuara". Kjo rezultoi në një mungesë të gjithëpërfshirjes dhe lejoi vazhdimin e pabarazive të vazhdueshme sociale dhe rajonale brenda një vendi. Një lidhje e qartë mes llogaridhënieve dhe përfaqësimit (në nivel kombëtar dhe lokal) mund të krijojë një efekt të rëndësishëm që nxit një shpërndarje më të drejtë të burimeve publike dhe përfshirje më të madhe të grave, të rinjve dhe grupeve të marginizuara dhe të ceneshme. Prandaj, mekanizmi që mund të nxisë komunikimin e dyanshëm mes parlamentit kombëtar dhe autoritatave lokale - - dhe një që lidhet me shoqërinë civile dhe qytetarët - - është i rëndësishëm dhe duhet të ndërtohet në kuadër të planeve të zbatimit të OZHQ-ve për një vend.

Prandaj, parlamenti duhet të përpinqet të sigurojë që zbatimi i OZHQ-ve, që nga formulimi i hershëm i planeve zhvillimore kombëtare deri në monitorimin e rregullit të zbatimit të tij, të përfshijë drejtpërsëdrejti qeverisjet dhe këshillat provinciale dhe lokale. Parlamenti duhet gjithashtu të jetë i kënaqur me mekanizmat e vendosur për të marrë kontribut të vazhdueshëm nga organizatat me bazë në komunitet dhe organiza - tat e shoqërisë civile, në mënyrë që perspektivat e tyre të vlerësuara të pasqyrohen në mënyrën se si OZHQ-të e ndryshme shpërndahen në zonat e tyre dhe në mënyrë që të zhvillohet pronësia lokale e procesit.

Më poshtë jepen disa mënyra si një parlament mu - nd të ndërmarrë veprime specifike për të siguruar që zbatimi i OZHQ-ve të bëhet në koordinim me qeverisjet nën-kombëtare dhe lokale dhe me kontributin e qytetarëve në të gjithë vendin.



UNDP në Pakistan
Takimi i organizatës së femrave "Shamatanzeem", fshati "Padhana", dhe këshillit të sindikatës "Dheenda" të Haripurit. Diskutimi i çështjeve të përgji thshme.

- Kur shqyrtohet plani zhvillimor kombëtar, të kërkohen dhe konsiderohen në mënyrë aktive inputet nga qytetarët dhe qeverisjet lokale në të gjithë vendin.
- Në legjislacionin që rregullon autoritetet lokale, të vendoset kërkesa që autoritetet lokale dhe organet qeverisëse të angazhohen në konsultime publike rutinore në proceset e tyre të vendimmarjes.
- Të shqyrtohet buxheti vjetor i shtetit për të verifikuar që përfshin fonde adekuate për aktivitetet lokale të angazhimit të publikut dhe edukimin qytetar për OZHQ-të.
- Kur autoritetet kombëtare zbatojnë programe në nivel lokal, të monitorohet procesi i realizimit të programeve për të përcaktuar nëse është konsideruar konteksti lokal dhe janë angazhuar qytetarët në nivel lokal.
- Të sigurohen burime për t'u mundësuar komisioneve parlamentare që të mbajnë dëgjime publike dhe konsultime jashtë parlamentit, duke përfshirë vizitat në terren dhe forumet publike lokale. Përndryshe, ose në mënyrë plotësuese, të investohet në teknologji që lejon pjesëmarrjen virtuale dhe në distancë në veprimtarinë e komisionit.

Pyetje për reflektim

- A luajnë qeverisjet nën-kombëtare dhe lokale në vendin tuaj një rol të qartë gjatë formulimit të planeve zhvillimore kombëtare?
- Cilat metoda të dialogut ekzistojnë mes parlamentit dhe asambleve provinciale dhe lokale për të garantuar një dialog të rregullt dhe të hapur mbi çështjet ky çë që ndikojnë në zhvillim, dhe në veçanti që kanë të bëjnë me çështjet e adresuara në kuadër të OZHQ-ve?
- A siguron plani zhvillimor kombëtar që kontekstet lokale, specifike, do të pasqyrohen sa duhet gjatë zbatimit? Nëse jo, cilat mekanizma mund të shtohen që do ta garantonin këtë?

IX. Rol i anëtarëve të personelit parlamentar

Nga natyra e punës së tyre, parlamentarët duhet të janë gjeneralistë. Shumëlojshmëria dhe kompleksiteti i çështjeve me të cilat deputeti përballet çdo ditë - nga adresimi i s qjetësimave të zgjedhësve tek shqyrtimi i projektligjeve - kërkon që ata të fitojnë shpejt njohuri mbi tema të ndryshme. Pa marrë parasysh eksperiencën apo ekspertizën e tyre profesionale, ata do të përballen me shumë çështje që janë përtej zonave të tyre të rehatisë. Kështu, parlamentarët mbështeten tek anëtarët e personelit parlamentar për t'u ofruar mbështetjen dhe analiza që kerkohen për të bërë punën e hollësishme të një ligjvënesi.

Pothuajse të gjitha parlamentet dhe anëtarët e tyre përballen me sfidën e angazhimit me një degë ekzekutive që ka më shumë burime dhe ekspertizë sesa ata. Ata duhet të punojnë brenda këtyre kufizimeve për të luajtur një rol konstruktiv në miratimin dhe monitorimin e legjislacionit dhe buxheteve, dhe natyrisht, do të përballët me të njëjtat kufizime në punën për zbatimin e OZHQ. Kjo do të thotë se parlamenti do të ketë nevojë për anëtarët e personelit të me kapacitete e duhura, të cilët kanë qasje në informata, dëshmi dhe të dhëna të qarta dhe të forta, për të ofruar këshilla kritike dhe në kohë për parlamentarët individualë dhe komisionet. Pa një kontigjent solid të anëtarëve të personelit, një parlament nuk do të jetë në gjendje të përmbrushë rolin e tij në zbatimin e Objektivave.

Mënyrat specifike si u ndihmojnë anëtarët e personelit parlamentarëve të marrin njohuri, informacion dhe të dhëna të nevojshme për të vlerësuar në mënyrë substanciale çdo çështje të caktuar, përfshijnë informime, seanca dëgjimore, identifikimin e palëve të interesit, hulumtime dhe mbështetjen e përgjithshme për përgatitjen e amendamenteve dhe raporteve nga komisionet. Anëtarët e personelit sigurojnë mbështetje për parlamentin, komisionet dhe anëtarët e tyre gjatë shqyrtimit të legjislacionit përkatës, buxhetit vjetor të shtetit dhe monitorimit të iniciativave.

Përveç personelit të përgjithshëm të sekretariatit parlamentar, më poshtë jepen tre strukturat kryesore sipas të cilave shpesh organizohen anëtarët e personelit në kuadër të një parlamenti.

- Personeli mbështetës i Komisioneve:** Secilit komision i caktohet një kuadër i anëtarëve të personelit profesional të përkushtuar, duke përfshirë anëtarët e personelit mbështetës ligjor, sektorial dhe procedural për të ofruar ndihmë të drejtpërdrejtë për kryetarin dhe anëtarët e komisionit kur ata zhvillojnë takime, seanca dëgjimore dhe diskutime.
- Njësitë profesionale të dedikuara:** Në disa parlamente, anëtarët profesionalë të personelit janë të organizuar në njësi të bazuara në fushën e ekspertizës. Kjo mund të përfshijë Njësinë e Çështjeve Ligjore, Njësinë e Hulumtimit, Divizionin e Këshillimit Procedural dhe Njësinë e Informimit Publik/Komunikimit. Këto njësi janë përgjegjëse për ofrimin e këshillave dhe mbështetjes për të gjitha komisionet dhe deputetët, kryesisht në bazë të kërkesës.
- Njësitë e specializuara:** Ekziston një trend në rritje drejt krijimit në kuadër të një parlamenti të njësive që kanë burime të mjaftueshme dhe rol specifik në lidhje me një funksion thelbësor të institucionit. Më të zakonshmet nga këto janë Zyra Parlamentare e Buxhetit, e pajisur me profesionistë me kualifikime të larta, që ofron analiza të pavarura për komisionet përkatëse në lidhje me miratimin dhe monitorimin e buxhetit vjetor të shtetit. Disa parlamente kanë krijuar edhe institute parlamentare, një lloj instituti kërkim or të rendshëm që kryen hulumtime dhe analiza të detajuara dhe shkencore për parlamentin.

Pavarësisht nga mënyra si organizohet personeli, anëtarët e personelit duhet të janë jo vetëm të vetëdijshëm për OZHQ-të, por edhe si po zbatohen dhe të njohin aktorët kyç për zbatimin. OZHQ-të duhet të mbahen "gjithmonë parasysh" nga anëtarët e personelit gjatë punës së përditshme në sektorin në të cilin komisioni ka juridikcion.

Duhet thënë se burimet që u sigurohen parlamenteve për angazhimin e anëtarëve të perso profesional shpesh janë të kufizuara. Teksa OZHQ-të mbulojnë pothuajse të gjitha aspektet e zhvillimit në një vend të caktuar, sfida qëndron në shkallërritjen e kapacitetit të anëtarëve të personelit në mënyrë që ata t'i kuptojnë, t'i vlerësojnë dhe të bëhen plotësisht të vetëdijshëm për OZHQ-të dhe objektivat e tyre. Personeli dhe parlamentarët e aftë dhe të ditur janë thelbësorë për zbatimin e OZHQ-ve. Kjo ka të ngjarë të kërkojë që parlamenti të kryejë një auditim apo vlerësim të personelit të tij për të kuptuar nëse ka kapacitete dhe burime për të përbushur nevojat e realizimit të OZHQ-ve. Një vlerësim i tillë do t'i mundësojë udhëheqjes së institucionit të identifikojë mangësitë që kërkojnë investim për të siguruar që parlamenti të ketë kapacitet e të mjaftueshme për të siguruar materialet dhe analizat e sfondit, në mënyrë që efektivisht të jetë aktor i plotë në zbatimin kombëtar të OZHQ-ve.

Tanzani: Mbikëqyrja e buxhetit

Tanzania është demokraci shumëpartiale që nga viti 1995. Asambleja Kombëtare e Tanzanisë fillimi ishte një Komision për Financa që shqyrtonte buxhetin vjetor të shtetit të paraqitur nga qeveria. Megjithatë, autoriteti i Komisionit për Financa për të bërë rregullime ose për të refuzuar buxhetet specifike sektorale ishte i kufizuar.

Në vitin 2012, me mbështetjen e UNDP-së dhe degës lokal të Rrjetit Parlamentar Afrikan kundër Korruptionit (një degë rajonale e GOPAC), Kryetari i Asamblesë Kombëtare identifikoi nevojën për një proces të ri buxhetor. Kjo filloj me zëvendësimin e Komisionit për Financa me Komisionin për Buxhet në vitin 2013.

Një vit më pas, Asambleja Kombëtare krijojë dëshmi financiare për Buxhetin me 20 anëtarë profesionalë të personelit, me shkathtësi specifike në lidhje me analizën ekonomike dhe financiare. Mandati i departamentit është të mbështesë punën e Komisionit për Buxhet për të shqyrtuar buxhetin vjetor të shtetit para miratimit nga Kuvendi. Gjithashtu, duhet të ofrojë dokumente analitike dhe hulumtime sipas kërkësave nga parlamentarët dhe komisionet e tjera.

Në vitin 2015, si pjesë e fundit e reformës, Asambleja Kombëtare miratoi Ligjin për Buxhetin. Ky ligji i ri siguroi kompetencat dhe autoritetin e zgjeruar që Komisioni për Buxhet të refuzojë pjesët ose të gjithë buxhetin vjetor të shtetit.

Duke shkuar edhe më tej, shumë parlamente kanë formuluar dhe miratuar plane strategjike shumëvjeçare që bazohen në një vlerësim të nevojave dhe që identifikojnë një udhërrëfyes përe reformat dhe burimet e nevojshme për rritjen e kapaciteteve dhe për të përbushur funksionet e veta themelore. Një plan i tillë është një bazë e mirë për sigurimin e dëshmive të kërkua të përvaret përdarjen e burimeve nga buxheti vjetor i shtetit dhe nga donatorët që do të mbështesin parlamentin në përpjekjet e veta për të krijuar kapacitetet për zbatimin e OZHQ-ve.

Pyetje për reflektim

- A ka parlamenti juaj anëtarë profesionalë të personelit të cilët janë të ngarkuar me sigurimin e analizave të buxhetit dhe projektligjeve për komisionet përkatëse gjatë shqyrtimit të iniciativave të lidhura me OZHQ-të?
- A ka realizuar parlamenti juaj një vlerësim të nevojave për të përcaktuar se çfarë mbështetjeje dhe burimesh janë të nevojshme në mënyrë që anëtarët e personelit të kenë kapacitetin për të ofruar analiza për komisionet dhe parlamentarët individualë?
- A ka zhvilluar dhe miratuar parlamenti juaj një plan strategjik zhvillimor për të identifikuar se ku dhe si duhet të rriten kapacitetet për të miratuar legjispcionin dhe për të monitoruar shpenzimet dhe zbatimin në mënyrë konsistente me OZHQ-të?

X. Rol i grupeve parlamentare të partive politike

Nuk mund të flitet për punën e parlamentarëve pa pranuar se shumica e parlamentarëve janë anëtarë dhe përfaqësues të një partie politike. Të punosh me dhe përmes kësaj përkatësie partiake është një aspekt i rëndësishëm i punës parlamentare që lejon promovimin dhe avokimin e pozicioneve dhe ideve të partisë në kuadër të parlamentit.

Debatet dhe diskutimet janë aspekt qendror i jetës parlamentare. Secila palë do të ketë prioritetet e veta për politikat, legjislacionin dhe ndarjet e buxhetit për të adresuar nevojat e zgjedhësve të tyre. Por, ndërsa partitë mund të ndryshojnë edhe në mënyrën si duhet të arrihen OZHQ-të, pavarësisht nga partia apo ndryshimi i mundshëm në qeveri, vendi do të duhet të raportojë nëse i ka arritur objektivat. Kështu, në një moment të gjitha partitë politike duhet të përcaktojnë si dëshirojnë t'i arrijnë objektivat dhe të paraqesin një plan të tillë para publikut në çdo proces zgjedhor.

A. Grupet partiake

Në pothuajse të gjitha parlamentet në botë, deputetët e zgjedhur në emër të një partie politike ulen si grup partiak.¹³ Këto grupe takohen rregullisht për të rënë dakord për strategjitet legjislative dhe qëndrimet mbi projektligjet, ndryshimet në projektligjet dhe vendimet e tjera të rëndësishme që duhet të merren në parlament. Grupet partiake parlamentare gjithashtu luajnë një rol në debatin politik jashtë parlamentit, përmes partive të tyre përkatëse politike.

Nëse një grup partiak përbën shumicën në parlament (në varësi të sistemit parlamentar), ai është i pozicionuar mirë për t'u organizuar në mbështetje të ministrave dhe degës ekzekutive që do të jetë përgjegjëse për të sigruar zbatimin e OZHQ-ve në vend, si dhe për raportimin ndërkombëtar për angazhimet e marra. Një mënyrë për ta bërë këtë është krijimi i një Grupi Punues për OZHQ-të. Objektiivi kryesor i grupit punues do të jetë të punojë me ministra dhe ministri të ndryshme që do të mbikëqyrin zbatimin e OZHQ-ve, për të sigruar që perspektivat e anëta rëve të partisë dhe të zgjedhësve të pasqyrohen në projektligjin dhe buxhetin përrpara parashtrimit në parlament.

Përmes grupit punues, partia ka një shans për të diskutuar çështjet që ka të ngjarë të ngrihen nga grupet e opozitës dhe partive pakicë, dhe për ta akorduar pozicionin e tyre para se të dorëzohet projektligji apo buxheti. Gjithashtu, mund të jetë një vend për të diskutuar ndryshimet e mundshme në këto dokumente pasi publiku të ketë dhënë kontributin e vet përmes procedurave parlamentare, siç janë dëgjimet publike në komision.

Për deputetët e opozitës, është gjithashtu e rëndësishme që OZHQ-të të integrohen në punën e partisë së tyre. Në disa sisteme parlamentare, ekziston një Kabinet në Hije - një formë e qeverisë alternative që përbëhet nga parlamentarë nga opozita ose nga partitë e pakicës, të cilët shërbejnë si zëdhënës të partisë ose pika fokusi për ministritë e linjës në kuadër të qeverisë. Secili nga këta ministra në hije duhet të jetë i pajisur mirë, me njoħuri dhe të dhëna, në mënyrë që OZHQ-të të jenë në zemër të analizës së tyre të punës së realizuar nga ministritë nén juridikcionin e tyre. Në llojet e tjera të strukturave parlamentare, ndarja e punës mund të bazohet në faktorë gjeografikë ose faktorë të tjera. Pa marrë parasysh mjetet e organizimit, opozita duhet të ketë një kuptim të qartë të OZHQ-ve dhe një ide solide si mendojnë se mund të zbatohen më së miri për të sigruar që të jenë sa më të aftë për të monitoruar veprimet e qeverisë në lidhje me OZHQ-të.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se gjatë jetëgjatësisë së zbatimit të OZHQ-ve (2015-2030), grupet partiake mund të lëvizin shumë mirë nga opozita në qeveri (dhe anasjelltas). Secili grup partiak duhet të jetë i informuar mirë për OZHQ-të dhe të angazhohet për zbatimin e tyre, për të sigruar që një ndryshim në qeveri nuk do të rezultojë në vonesa të panevojshme në zbatim.

¹³ Në vende të ndryshme, këto grupe njihen me emra të ndryshëm, duke përfshirë grup parlamentar, seksion apo parti parlamentare.

B. Grupet ndërpartiake

Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, ka pasur një përhapje të grupeve të parlamentarëve me mendime të ngjashme nga grupe të ndryshme partiake. Këto grupe ndërpartiake ofrojnë një mundësi për deputetët me interesa të përbashkëta për të diskutuar për promovimin e legjislacionit dhe politikave që i pasqyrojnë këto interesa. Këto grupe lejojnë thyerjen e barrierave partiake dhe nxisin dialog mes deputetëve, i cili më pas mund të përdoret për të kriuar konsensus që mund të avokohet në kuadër të grupeve të ndryshme partiake dhe në parlament në përgjithësi.

Disa grupe të përbashkëta ndërpartiake përfshijnë grupet e grave, grupet e bas parlamentar dypalësh dhe grupet e lidhura me rrjetet rajonale dhe globale të parlamentarëve (siç është theksuar në Pjesën D të Seksionit III).

Duke pasur parasysh se OZHQ-të mbulojnë pothuajse të gjitha fushat e zhvillimit, ka të ngjarë që të krijohen grupe që do të avokojnë për çështje specifike që janë shqetësuese për deputetët. Për shembull, një grup i grave do të avokojë për OZHQ 5 (barazia gjinore), një degë e GOPAC -ut do të avokojë për OZHQ 16 (ilogaridhënia) dhe një degë e Parlamentit të Klimës do të avokojë për OZHQ 7 (energjia e pastër).

Por ka edhe hapësirë për punë të përgjithshme ndërpartiake për OZHQ-të. Disa parlamente krijuan grupe punuese për OZHM-të (dhe disa e kanë bërë tashmë edhe për OZHQ-të). Një grup i tillë mund të kthehet një vend për edukim, promovim dhe avokim për OZHQ-të në përgjithësi. Gjithashtu mund të jetë një grup kyç për promovimin e institucionalizimit të sistemeve të kërkuara (dhe të theksuara në këtë doracak) që parlamenti të jetë pjesëmarrës aktiv dhe kyç në zbatimin e Objektivave.

Pakistan: Grupi punues i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Me miratimin e OZHQ-ve në shtator të vitit 2015, Asambleja Kombëtare e Pakistanit krijoj një grup punues ndërpartiak të parlamentarëve nga të gjitha grupet kryesore partiake. Objekti i grupit punues është i dyfishtë: (i) të sigurojë informacion në lidhje me OZHQ-të dhe rolin e parlamentit në zbatimin e tyre; dhe (ii) të krijoj një vend ku parlamentarët, partitë e tyre dhe parlamenti mund të bashkërendojnë punën e tyre për zbatimin e OZHQ-ve.

Shih: "Kryetari i Asamblesë Kombëtare Sardar Ayaz Sadiq inauguron Sekretariatin e OZHQ-ve", 16 shkurt 2016, <http://www.na.gov.pk/en/pressrelease.php?Content=101>.

Një grup i të gjitha partive mund të jetë gjithashtu një vend për konsensus politik dhe avokim në kuadër të partive të ndryshme politike të përfaqësuara në parlament. Grupi duhet të sigurojë që jo vetëm parlamentarët që janë anëtarë të grupit të jenë të informuar dhe të angazhuar për OZHQ-të, por që ata të lidhen me partitë e tyre përkatëse për të ndarë njojuritë e lidhura me OZHQ-të, në mënyrë që ato parti të informohen dhe të angazhohen për Objektivat.

Pyetje për reflektim

- A e kanë organizuar grupet partiake në kuadër të parlamentit tuaj punën e tyre në një mënyrë që në përgjithësi promovon OZHQ-të, dhe a konsiderohen objektiva specifike gjatë organizimit të punës së tyre?
- A ka Parlamenti juaj një grup punues për OZHQ-të? Nëse po, me çfarë mandati? Nëse jo, çfarë mandati do të parashikonit për një grup të tillë?
- Çfarë grupesh ndërpartiake mund të themelohen në parlamentin tuaj për të promovuar OZHQ specifike? A përputhen me priorititet zhvillimore të planifikimit zhvillimor kombëtar të qeverisë suaj?
- Çfarë mekanizmash ka partia juaj për të mësuar më shumë për OZHQ-të përmes parlamentarëve të vet?

XI. Ndërtimi i kapaciteteve të parlamentarëve dhe anëtarëve të personelit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Zbatimi i OZHQ-ve do të jetë një sfidë për disa breza. Si parlamentar, ju mund ose mund të mos jeni i zgjedhur në vitin 2030 kur do të vlerësohet nëse vendi juaj i ka arritur plotësisht ose pjesërisht Objektivat. Por, duhet të mendoni për rolin tuaj dhe të krejt parlamentit në vendosjen e sistemeve dhe praktikave që do t'i jasin vendit tuaj shanset më të mëdha për sukses. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me matjen e të dhënave dhe numrave abstraktë, por me ofrimin e një mundësie për të përdorur OZHQ-të për ta zhvilluar vendin tuaj dhe për të hequr barrierat që kanë penguar qytetarët dhe vendet që të çlironen nga varfëria dhe të arrijnë zhvillim të qëndrueshëm.

Për ta arritur këtë, siç u përmend më lart, të gjitha parlamentet do të duhet të ndërtojnë kapacitete të reja. Edhe nëse parlamenti juaj është duke e angazhuar publikun në mënyrë aktive dhe duke kërkuar reagimet e tyre përmes punës së deputetëve dhe komisioneve; edhe nëse parlamenti juaj ka kapacitet për të kryer hulumtime të thelluara dhe sisteme që lejojnë që zërat e qytetarëve të shprehen në mën yrë aktive përmes parlamentarëve; sërisht do të ketë nevojë për të reflektuar si duhet të rishikohen sistemet tuaja për të siguruar që do t'i avancojnë të 17 OZHQ-të.



UNDP në Moldavi

Sekretariati i Parlamentit zotohet të promovojë një menaxhim të burimeve nëntor 2016.

ve njerëzore me përgjegjësi gjinore më 23

Shumica e parlamenteve nuk i përbushin standarde e kërkova të arritjen e plotë të OZHQ-ve. Të gjitha parlamentet do të duhet të edukojnë më tej parlamentarët dhe anëtarët e personelit për OZHQ-të dhe si t'i integrojnë Objektivat në punën e tyre të përditshme. Ky dokument duhet të jetë një pikënisje për të diskutuar si angazhohet parlamenti juaj në zbatimin e Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve të saj në vendin tuaj. Pyetjet në fund të se cilës pjesë janë menduar si një mundësi për të vetë-ekzaminuar punën që po kryhet aktualisht në parlamentin tuaj dhe çfarë mund të bëni ju për ta bërë institucionin më efektiv.

Disa parlamente e kanë kuptuar rëndësinë e OZHQ-ve (dhe paraardhësve të tyre, OZHM-ve) prej kohësh. Ata kanë zhvilluar tashmë produkte të njojurive dhe udhëzime që parlamentarët mund t'i përdorin për t'i ndihmuar t'i marrin në konsideratë objektivat gjatë ndërveprimit të tyre të vazhdueshëm me publikun dhe qeverinë.

Indonezi: Udhëzuesi i parlamentarëve për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

Në vitin 2003, Dhoma e Përfaqësuesve të Indonezisë krijoj një Task Forcë Parlamentare për OZHM-të. Kjo Task Forcë prodhoi një udhëzues për parlamentarët për OZHM-të. Udhëzuesi ofroi një seri pyetjesh kyçë në lidhje me OZHM-të që duhen marrë në shqyrtim nga të gjithë parlamentarët gjatë hartimit të ligjeve dhe monitorimit të aktiviteteve të qeverisë. Udhërrëfyesi përfshiu një model për angazhimin e qytetarëve dhe theksoi atë që parlamentarët, si në nivel kombëtar ashtu edhe nën-kombëtar, duhej të vëzhgonin dhe të kishin parasysh gjatë zhvillimit të vizitave në terren dhe angazhimit të komuniteteve.

Disa parlamente mund të pranojnë se ka kufizime në atë që mund të arrijnë vetë, për shkak të mungesës së anëtarëve të personelit ose të vetë deputetëve. Për të kapërcyer kufizimet, herë pas here, parlamentet krijojnë projekte dhe programe me organizata, të tilla si UNDP, për t'i ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve, përgatitjen e kornizave llojore dhe kriimin e mjeteve dhe mekanizmave për të nxitur arritjen e OZHQ-ve. Mjetet për ta bërë këtë mund të përfshijnë punëtori, seminare, bashkëngjitje dhe stërvitje të kolegëve për anëtarët e personelit dhe parlamentarët.

Kur integrohen me planifikimin afatgjatë të referuar diku tjetër në këtë dokument, një mbështetje e tillë e përditshme dhe e posaçme e projektit mund të ketë ndikim të rëndësishëm në kapacitetin e parlamentit gjatë punës së tij për t'u kthyer në partner të plotë dhe aktiv në zbatimin e OZHQ-ve.

Samoa: Informimi i parlamentarëve të rinj për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Pas zgjedhjeve të përgjithshme të marsit 2016 në Samoa, agjencitë e ndryshme të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë Organizatën Ndërkombëtare të Punës dhe UNDP -në, në bashkëpunim me Zyrën e Sekretarit dhe Asamblesë Legjislative dhe ministritë e qeverisë, organizuan një program informimi për OZHQ-të për parlamentarët e sapozgjedhur. Programi ishte pjesë e një orientimi më të gjerë për deputetët e rinj. Ai u dha parlamentarëve një mundësi për të kuptuar më mirë rolin e tyre në zbatimin e OZHQ-ve dhe çfarë lloj mbështetje mund të marrin nga Kombet e Bashkuara dhe organizatat e tjera gjatë rrugëtimit të tyre.

Burimi: www.samoaobserver.ws/en/18_03_2016/local/3791/Making-global-goals-Samoa's-own.htm.

Parlamentet që duan të jenë aktive në zbatimin e OZHQ-ve në vendin e tyre duhet të paraqesin arsyet për të kërkuar mbështetje nga organizatat ndërkombëtare dhe rajonale që ofrojnë fonde, këshilla teknike dhe burime të tjera për të mbështetur ndërtimin e kapaciteteve të parlamentit dhe angazhimin në realizimin e Objektivave të ndryshme.

Përveç organizatave mbështetëse tashmë të referu ara, parlamenti mund të kërkojë fonde nga institucionet financiare ndërkombëtare, siç është Banka Islamike për Zhvillim¹⁴ dhe banka të tjera të zhvillimit rajonal. Këto institucione janë krijuar që, ndër të tjera, të ndërtohen institucione shtetërore që garantojnë se vendet anëtare i përmbushin objektivat e tyre afatgjata të zhvillimit, duke përfshirë edhe OZHQ-të.

Çelësi për një parlament që është i gatshëm të angazhohet për OZHQ-të është të mbështetet në përbajtjen e këtij doracaku. Bazuar në informacion in e paraqitur në këtë dokument, shembujt e ofruar nga vende të ndryshme dhe përgjigjet ndaj pyetjeve reflektuese, një parlament mund të prodhojë një studim të fizibilitetit të bazuar në dëshmi, ose një vlerësim të nevojave që mund të jetë baza e një kërkesë se përmes mbështetje dhe burime për të të realizuar ndryshimet e kërkua të pasur një parlament që vepron si partner aktiv në arritjen e OZHQ-ve.

Pyetje për reflektim

- Çfarë plani ka parlamenti juaj për ndërtimin e kapaciteteve të anëtarëve të personelit dhe të parlamentarëve?
- Çfarë planesh ka parlamenti juaj për krijimin dhe shpërndarjen e produkteve të njojurive për OZHQ-të, specifike për vendin tuaj?
- A është i disponueshëm një buxhet i brendshëm adekuat për anëtarët e personelit dhe trajnimin parlamentar dhe zhvillimin e produkteve të njojurive?
- Çfarë mbështetje është në dispozicion nga organizatat e jashtme për të ndihmuar në ndërtimin e kapaciteteve të anëtarëve të personelit dhe parlamentarëve në parlamentin tuaj?
- Cilat institucionet financiare ndërkombëtare janë të përgatitura për të ofruar burime për të ndihmuar në ndërtimin dhe trajnimin e kapaciteteve parlamentare?

¹⁴ Banka Botërore - Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD) - Banka Evropiane e Investimeve (EIB) - Banka Aziatike për Zhvillim (ADB) - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) - Banka Zhvillimore e Amerikës Latine (CAF) - Grupi i Bankës Ndër-Amerikane për Zhvillim (IDB, IADB) - Banka Afrikane për Zhvillim (AfDB) - Banka Aziatike për Investime në Infrastrukturë (AIIB) - Banka për Zhvillim e Karaibeve (CDB) - Banka Qendrore Amerikane për Integrim Ekonomik (CABEI) - Banka për Zhvillim e Afrikës Lindore (EABD) - Banka për Zhvillim e Afrikës Perëndimore (BOAD) - Banka e Tregtisë dhe Zhvillimit të Detit të Zi (BSTDB) - Banka e Tregtisë dhe Zhvillimit e Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik (ETDB) - Banka e Zhvillimit Euroaziatik (EDB) - Banka e Re për Zhvillim (NDB) (ish Banka për Zhvillim e BRICS)

